

Maj 2013
Numri: 62
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den


ETIKA



KUMTI ISLAM
OSMAN NUR TOPIBASH



NËSE DËSHIRON TË JESH
I LUMTUR, BËHU!
EJUP HAZIRI



SHTATË ARSYET
PSE NJË SHKENCËTAR
BESON ZOTIN
A. CRESSY MORRISON



SI FITOHEN
ZEMRAT?
ALI RIZA TEMEL



TË DASHURUAR
PAS PARAJSËS
ALTIN TORBA



HASAN KAMIL JËLLMAZ
STREHA E BESIMTARIT



TË QËNDROSH me Besnikët



ISSN 2227-3611

0 5

9 772227 361004

Maj 2013

VITI: VII
NUMRI: 62

BOTUESI
Shtëpia botuese Progresi

DREJTOR & KRYERADAKTOR
Alban Kali

REDAKTOR
Zija Vukaj

LEKTOR
Albri Brahusha

KORREKTORE
Dr. Irida Hoti

PËRKTHYES
Albert Halili
Arjan Ymeraj
Artur Tagani
Fatmir Sulaj
Ilir Hoxha

DIZAJN
Bledar Xama

ADRESA
Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"
Shkodër; Shqipëri

MOBILE
+355 67 208 6767

E-MAIL
revistaetika@progresibotime.com

WEBSITE
www.revistaetika.com

KOSOVË
Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin
Prizren; Kosovë
Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI
Drvarska 28; Stara Carsija
Skopje; Makedonija
Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR
Shqipëri: 2000 lekë
Kosovë: 15 Euro
Maqedoni: 900 Denar

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese Progresi ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Në Kuranin Famëlartë, përmendet fjala besnik-besnikëri në lidhje me mbajtjen e besës, premtimit, që i ishte dhënë Pejgamberit (a.s.), për ta mbrojtur në çdo hap të jetës.

"O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe qëndroni me besnikët!" (Teube, 119) Konteksti i shpalljes së këtij ajeti ishin ata që nguruan të luftonin në betejën e Tebukut dhe nxorën arsyetime për të mos shkuar në luftë. Ky është një qortim prej Allahut, i Cili i urdhëroi të kishin frikë prej Allahut dhe të bëheshin si ata që treguan besnikëri ndaj Pejgamberit.

Besnikëria është edhe çështja e marrëveshjes së bërë ndërmjet njerëzve dhe Allahut në botën shpirtërore...

Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i pyeti:

"A nuk jam Unë Zoti juaj?"

Shpirtrat u përgjigjën:

"Po, dëshmojmë se Ti Je."

Kjo pra është prova e jetës së kësaj bote...

Dhe për këtë sprovë të besnikërisë, njeriut i duhet një rreth me të cilin të ndajë luftën e tij.

Një rreth të cilit i intereson kjo çështje.

Një rreth që përpiket pareshtur.

Një rreth që e ka bërë besnikërinë boshtin e jetës...

Një rreth që ka dhënë në këtë rru-gë gjithçka.

Siç thotë edhe Kurani:

"Midis besimtarëve ka të atillë,

- Që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun.

- Disa prej tyre kanë dhënë jetën,

- Kurse të tjerët presin

- Ata nuk kanë ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre."

Pra, ajo që duhet të bëjmë, është kjo:

Të bëhemi ose të gjejmë një bashkësi besnikësh... Por kurrësi të mos bashkohemi me ata që shkëputen prej besnikëve dhe besnikërisë.

Të pyesim veten:

A jemi prej atyre burrave që i kanë qëndruar besnikë Allahut? A jemi gati të kalojmë një sprovë të tillë besnikërie?

Përmbajtja

Nuredin Jellëz
Kush është më me fat?

22



8

A. Cressy Morrison
7 arsye pse një shkencëtar beson Zotin



Osman Nuri Topbash
Kumti Islam

34




18



24

Altin Torba
Të dashuruar pas Parajsës

- 5 Të qëndrosh me besnikët
Ahmet Tashgetiren
- 11 Si fitohen Zemrat?
Ali Riza Temel
- 14 Mbi natyrën e edukimit komunist
Nuredin Nazarko
- 16 Streha e besimtarit
Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz
- 18 Nëse dëshiron të jesh i lumtur, bëhu!
Ma. Ejup Haziri
- 20 Jeruzalemi mysliman, shembull
i bashkëjetesës së feve qiellore
Nexhat Ibrahim
- 27 Dynjaja që i shërben së vërtetës,
është fe
Muhamed El-Gazali



46

Muhamedi (a.s.), mësues i përhershëm 28
Ma. Orhan Bislimaj
Një Ajet - Një Hadith 31

Dispozitat e subjektit të së drejtës
në Sheriatin Islam 40
Ma. sci. Flamur Sofiu
Raportet brenda familjes 44
Ma. Zymer Ramadani
Armiku i vërtetë i Islamit 46
dhe myslimanëve është injoranca
Ma. Muhidin Ahmeti
"Gjithçka që prish unitetin shoqëror, 48
është e pavlerë"
Zaim Lakti
Shoqëria e mirë 55
Ferid Piku
Çka është besimi Islam? 58
Zani i s'kaluemes

52

Imam Muhamed Sytari
Meditim dhe mall



Mustafa Erish
Ebu Rejane El-Ezdi

50



Të qëndrosh me **Besnikët**

Ahmet Tashgetlren

Në fjalor, fjalën “besnik” e gjejmë në këto kuptime: njeri që e mban deri në fund zotimin; që nuk i shmanget asnjëherë detyrës së marrë përsipër; që ndjek dikë pa u lëkundur, me të cilin ndan të njëjtin vizion a qëllim të përbashkët; që nuk tradhton, etj.

Në këto dy ajete të Kuranit famëlartë, përmendet fjala besnik-besnikëri dhe pikërisht në to bëhet fjalë për mbajtjen e besës, premtimit, që i ishte dhënë Pejgamberit (a.s.), për ta mbrojtur gjatë betejës, duke rrezikuar qoftë edhe jetët.

“O besimtarë! Frikësojuni Allahut dhe qëndroni me besnikët!” (et-Teube, 119.) Konteksti i shpalljes së këtij ajeti ishin ata që nguruan të luftonin në betejën e Tebukut dhe nxorën arsye time për të mos shkuar në luftë. Ky është një qortim prej Allahut, i Cili i urdhëron: “Kini frikë prej Allahut dhe bëhuni si ata që treguan besnikëri ndaj Pejgamberit”.

Ndërsa në ajetin tjetër, i cili ndodhet në suren el-Ahzab, urdhërohet:

“Midis besimtarëve ka të atillë, që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun. Disa prej tyre kanë vdekur, kurse të tjerët presin pa ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.” (el-Ahzab, 23.)

Siç shihet, edhe ky ajet është një vlerësim i besnikërisë në situatë lufte. Lufta është një gjendje e vështirë, në të cilën besnikëria vihet në një sprovë shumë të madhe. Atje nuk është e lehtë të mbash fjalën e dhënë: *do të të mbrojmë me jetët tona*. Në epokën e lumturisë, në lidhje me këtë çështje kanë ndodhur shumë sprova. Në shumë beteja, si në Bedër, Uhud, Hendek, Hunejn, Tebuk, etj., shumë prej atyre që dhanë besën, dhanë edhe jetën, duke rënë dëshmorë. Pra, me anë të këtyre ajeteve, Allahu Teala i përlëvdon dhe i ngre lart ata.

Një tjetër pikëpamje në lidhje me “besnikërinë”, është edhe çështja e marrëveshjes së bërë ndërmjet njerëzve dhe Allahut në botën shpirtërore:

Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasari-



dhësit e tyre dhe i pyeti:

“A nuk jam Unë Zoti juaj?”

Shpirtrat u përgjigjën:

“Po, dëshmojmë se Ti Je.” (el-Araf, 172.)

Ja pra, edhe jeta e kësaj bote është bërë një vend lufte, ku në çdo hap e në çdo veprim njerëzit sprovohen në lidhje me besnikërinë në ruajtjen e marrëveshjes që kanë bërë atje.

“Sprova e besnikërisë” është një sprovë, e cila gjithmonë përjetohet në një lloj atmosfere “lufte”, pra, qoftë “në luftë me vështirësitë e kësaj bote”, qoftë “duke dhënë jetën në luftën kundër armikut”.

Në Kuran shejtani është cilësuar si “armiku i njeriut”. Ai ka ngritur pusi në rrugët që shkojnë për tek Allahu dhe përpiqet ta largojë njeriun nga ato rrugë, duke e penguar të shkojë tek Zoti i vet. (shih. el-Araf, 16-17.) Lufta me këtë armik kërkon një përpjekje të madhe nga ana jonë. Ne duhet të qëndrojmë të palëkundur në rrugën e drejtë, duke mos devijuar prej saj dhe duke qëndruar besnikë ndaj marrëveshjes që kemi bërë, kur thamë: *Po, Ti je Zoti ynë*.

Shejtani, me kryeneçësinë e vet, i thotë Allahut Teala: “Do të shohësh që shumë prej tyre nuk do të vijnë tek Ti...” Ndërsa Allahu Teala urdhëron, duke i thënë: “Ti s’ke aspak pushtet mbi robërit e Mi besnikë.” (shih. el-Hixhr, 42.) Pra, në këtë luftë do të ketë shumë prej atyre që do të bëhen kurban të shejtanit, por do të ketë shumë edhe prej atyre që do të vërtetojnë besnikërinë e tyre dhe do të shpëtojnë prej kurtheve të tij.

Në ajetin, “qëndroni me besnikët”, ka edhe një ftesë të veçantë. Në ajet nuk thuhet “bëhuni besnikë”. Padyshim që edhe ajo bën pjesë në kuptimin e ajetit,

por ka edhe diçka tjetër: ftesa për “të qëndruar me besnikët”.

Kjo pjesë e ajetit na thërret të formojmë një bashkësi besnikësh dhe, nëse ajo ekziston, të bëhemi pjesë e asaj bashkësie. Ftesa që na bën ky ajet, ka një rëndësi jetësore për sa i përket sprovës në jetën e kësaj bote.

Po, është e vërtetë që lufta në front, është shumë e vështirë. Ajo nuk është një zgjedhje e lehtë për njeriun, natyra e të cilit është e lidhur fort me dëshirën për të jetuar dhe me frikën nga vdekja. Megjithatë, lufta është kalimtare dhe të qenit së bashku me njerëzit besnikë, duke ndarë me ta të njëjtat ndjenja dhe emocione, mund ta lehtësojë shumë këtë sprovë.

Jeta e kësaj bote është si një maratonë dhe në çdo çast të saj, ecën në formë të llogarisë, përpjekjes, zgjedhjes, vendimit, shpërblimit ose shpagimit.

Nëse shejtani ka vendosur kurthe në rrugë, njeriu duhet të jetë gjithmonë vigilent.

Ai e godet njeriun në zemër, në tru, në sy, në vesh e në gjuhë.

Vetë personalisht godet nefsin (egon) e njeriut.

Prandaj, ne si myslimanë, duhet të zhvillojmë sensorë të jashtëzakonshëm dhe një mbrojtje të fortë ndaj kurtheve të tij.

Fjala që njeriu i dha Allahut, “Po, Ti je Zoti ynë”, e sprovon atë vazhdimisht.

Ndërsa Kurani Kerim, i parashtroi njeriut pyetjen, **“A e ke parë ti atë që dëshirën (e egos) e vet e ka marrë për zot?..”** (el-Furkan, 43.)

Ç’ËSHTË DËSHIRA E EGOS?

Dëshira e egos, është pasioni ose ndjenja e fuqishme që shfaqet furishëm... ajo pothuajse është vetë njeriu. Pra, një pasion i fortë që gjendet brenda njeriut dhe që një ditë do të përpiqet ta detyrojë atë të kalojë kufijtë e vënë prej Zotit të tij... ta bëjë të harrojë Zotin e vet... dhe përkundër kënaqësisë dhe dëshirës së Zotit, mund ta tërheqë njeriun në një veprim që cenon marrëdhënien e tij me veten dhe Zotin.

Kjo pra është sprova e jetës së kësaj bote...

Dhe për këtë sprovë të besnikërisë, njeriu i duhet një rreth me të cilin të ndajë luftën e tij.

Një rreth të cilit i intereson kjo luftë.

Një rreth që lufton pareshtur.

Një rreth që e ka bërë këtë luftë boshtin e jetës...

Një rreth që ka pasur një farë suksesi në këtë luftë.

Siç thotë edhe Kurani:

“Midis besimtarëve ka të atillë,

- Që e kanë mbajtur besëlidhjen me Allahun.

- Disa prej tyre kanë dhënë jetën,

- Kurse të tjerët presin.

- Ata nuk kanë ndryshuar asgjë nga besnikëria e tyre.” (shih. el-Ahzab, 23.)

Kurani Kerim na këshillon të jemi gjithmonë besnikë dhe të mos e shkelim kurrë marrëveshjen me Allahun, qoftë edhe nëse rrezikojmë me jetë. Dhe ai që qëndron besnik duke rrezikuar jetën e vet, ka marrë parasysh *premtimin e madh*, i cili eklipson lehtësisht qëllimet e përkohshme të kësaj jete.

Ajo që i takon besimtarit, është “të gjejë bashkësinë apo rrethin besnik” dhe të qëndrojë së bashku me ta.

Koha në të cilën jetojmë, është shumë më e ashpër dhe shejtani ka më shumë mjete në dispozicion. Kjo është një kohë, në të cilën njeriu po përballet me kurthe shumë më tinëzare.

Bashkësia e besnikëve është si një bazë ushtarake, ku njeriu mund të mbështetet në këtë luftë, të strehohet, të furnizohet dhe të stërvisë veten. Njeriu, përsëri vetë ka për ta jetuar jetën e tij, por plagët e marra mund t’i kurojë brenda kësaj bashkësie besnikësh.

Në periudhën e Medinës, Mesxhidi Nebevi dhe veçanërisht Resulallahu (a.s.), ishin një burim paqeje dhe furnizimi shpirtëror për sahabët. Aty kuroheshin plagët, ndërsa shikimi, fjala dhe dora e Rasulallahut (a.s.), kishin një efekt rigjallërues.

ÇFARË DUHET BËRË NË KËTË KOHË?

Sot duhet të kërkohen dhe të gjenden vende, si Daru’l-Erkam, Mesxhidi Nebevi etj., që bartin atmosferën e Resulallahut (a.s.) dhe që ushqehen nga fryma shpirtërore e sahabëve fisnikë.

Vetëdija e bashkësisë dhe ruajtja e unitetit duhet të jetë botëkuptimi i domosdoshëm i Islamit për çdo mysliman. Kësaj mund t’i themi ndjeshmëri ndaj rrethit shoqëror.

Resulallahu (a.s.), thotë, se “ekziston një lidhje nga zemra në zemër”. Në çfarëdo ambienti të jeni, jepni dhe merrni diçka prej aty. Prandaj, për të dhënë të mirën dhe për të marrë të pastrën, duhet të gjendemi gjithmonë në vende të pastra prej haramit.

Shkëputja prej bashkësisë së myslimanëve dhe frekuentimi i vendeve të gabuara, bëhen shkak që njeriu të përballet me gjithfarë kurthesh të shej-

tanit.

Në kohën tonë duhet t’i shohim dhe të jemi më të vetëdijshëm ndaj këtyre kurtheve globale të shejtanit dhe të kemi shumë kujdes ndaj ambienteve dhe vendeve që frekuentojmë.

Sistemi i edukimit të tasavufit i jep njeriut një ushqim të veçantë shpirtëror dhe ia përgatit atij terrenin për ta marrë veten në llogari. Lidhja shpirtërore me të dashurit e Allahut, që shkon deri te vetë Resulallahu (a.s.), i jep myslimanit mundësinë të takohet me një “bashkësi besnikësh”, që e kanë kaluar me sukses sprovën e besnikërisë... Bart tek ata ndjeshmërinë dhe kujdesin e mbajtjes së lidhjes shpirtërore edhe me të dashurit e Allahut që ende jetojnë.


Të gjitha këto, e bëjnë myslimanin të llogarisë pozicionin e vet brenda kësaj bashkësie besnikësh, e cila e orienton atë drejt pyetjes: “Kush jam unë dhe a e meritoj të jem pranë tyre?”. E bëjnë të vrasë mendjen, se “Nëse ata do të jetonin në këtë kohë, çfarë do të bënin?”. E nxisin të marrë vendimin: “Sot duhet të bëhem si ata”.

Pra, ajo që duhet të bëjmë, është kjo:

Të bëhemi ose të gjejmë një bashkësi besnikësh... Por kurrresi të mos bashkohemi me ata që shkëputen prej besnikëve dhe besnikërisë.

Të pyesim veten:

A jemi prej atyre burrave që i kanë qëndruar besnikë Allahut? A jemi gati të kalojmë një provë të tillë besnikërie?



7 ARSYET PSE NJË SHKENCËTAR beson Zotin

Ky artikull i autorit A. Cressy Morrison, ish-kryetarit të New York Academy of Sciences, për herë të parë u paraqit në "Reader's Digest" në janar të vitit 1938, e pastaj me rekomandim të C. A. Cirilsonit, F.R.S., profesorit të matematikës në Universitetin Oxford, përsëri u botua në "Reader's Digest" në nëntor të vitit 1960.

Artikulli zbulon se si dituria e bën shkencëtarin ta kuptojë nevojën për të pranuar Krijuesin e Përsosur.

A. Cressy Morrison

Ne jemi ende në agimin e epokës shkencore, por drita gjithnjë e më fuqishëm, shpalos ndritshëm mjeshhtërinë e një Krijuesi inteligjent. Kemi bërë zbulime të jashtëzakonshme; me frymën e humanizmit shkencor dhe me besimin e bazuar te dija, ne po i afrohemi më shumë se kurrë vetëdijes për Zotin.

Personalisht mund të numëroj shtatë arsye për besimin tim në Zot.

E para: Në përputhshmëri me rregullat e pakontestueshme matematikore, jemi në gjendje të argumentojmë se kozmosi ynë është projektuar dhe zbatuar prej një inteligjence inxhinierike madhështore.

Supozoni se në xhepin tuaj keni futur dhjetë monedha, të shënuara nga njëshi deri te dhjeta, dhe i përzieni mirë ato! Tani përpikuni t'i nxirrni ato me radhë nga njëshi deri te dhjeta, çdo herë duke e kthyer mbrapsht monedhën në xhep dhe përsëri përziejini të gjitha. Matematikisht e dimë se shanset që herën e parë numri i tërhequr të jetë njëshi janë, një me dhjetë; për tërheqjen e njëshit dhe dyshit njëri pas tjetrit, mundësia është një me njëqind, për tërheqjen rrjesht të njëshit, dyshit dhe treshit mundësia është një me njëmijë dhe kështu me radhë. Shanset që t'i nxirrni të gjitha monedhat, prej njëshit deri te dhjeta në varg, do të arrinin shifrën e pabesueshme: një mundësi në 10.000.000.000 prova.

Për të njëjtën arsye, po kaq shumë kushte të përcaktuara saktësisht janë të nevojshme për jetën në tokë, sa nuk është dot e mundshme që ato të ekzistojnë rastësisht, në kombinimet e duhura. Toka rrotullohet rreth boshtit të saj, njëmijë milje në orë në ekuator; sikur të rrotullohej njëqind milje në orë, ditët dhe netët tona do të ishin dhjetë herë më të gjata se tani, ndërsa vapa e diellit do ta digjte vegjetacionin përgjatë çdo dite, ndërsa përnatë çdo filiz i mbijetuar do të ngrinte nga të ftohtit.

Më tej, dielli, burim i jetës sonë, e ka temperaturën e sipërfaqes 5500 °C, ndërsa Toka jonë është larg aq sa duhet, kështu që kjo "vatër jete" na ngroh mjaftueshëm e jo tejmasë! Nëse dielli do të rrezatonte vetëm gjysmën e rrezatimit të tanishëm, ne do të ngriheshim së ftohti, e nëse do të rrezatonte sa gjysma e tij më tepër, ne do të piqeshim!

Pjerrësia e Tokës, e cila është në një kënd prej 23 gradësh, na jep stinët e vitit, e nëse nuk do të ishte kështu e pjerrët, avujt nga oqeanet do të lëviznin sa në veri e sa në jug, duke krijuar kontinente me akull. Nëse hëna për shembull, do të ishte vetëm 50 mijë kilometra larg, e jo sa ç'është aktualisht, batica do të ishte aq e stërmadhe sa kontinentet do të përmyteshin plotësisht dy herë në ditë, dhe biles edhe malet shpejt do të gërryeshin. Nëse korja

e Tokës do të ishte vetëm disa metra më e trashë, nuk do të kishte oksigjen, pa të cilin bota shtazore do të zhdukej. Sikur oqeani do të ishte disa metra më i thellë, dioksidi i karbonit dhe oksigjeni do të ishin absorbuar dhe bota bimore nuk do të mund të ekzistonte. Ose, nëse shtresa jonë e atmosferës do të ishte më e hollë, meteorët, të cilët me miliona ndizen në kozmos çdo ditë, do të godisnin çdo pjesë të rruzullit tokësor, duke përhapur zjarre çdokund.

Për shkak të këtyre arsyeve dhe të një sërë shembujsh të tjerë, nuk ekziston asnjë në një milion mundësi që jeta në planetin tonë të jetë fryt i rastësisë.

E dyta: Aftësia e jetës për të përmbushur qëllimin e saj është manifestim i Mendjes Gjithëpërfshirëse.

Se çfarë është jeta, asnjë njeri nuk e ka kuptuar dot.

Pema mbi shkëmb nuk zotëron as peshën e as përmasën, por ka fuqinë, rrënja që rritet do të bëjë që shkëmbi të çahet. Jeta ngadhënjën ujin, tokën dhe ajrin, duke zotëruar elementet e tyre, duke detyruar ndarjen dhe riformulimin e kombinimeve të tyre.

Jeta, është skulptori që formëson të gjitha qeniet e gjalla, si artist, pikturon çdo gjethe të çdo peme dhe ngjyros çdo lule. Jeta është kompozitor dhe bën që çdo zog të këndojë këngën e tij të dashurisë, që insektet të thërrasin njëri-tjetrin, në korin e toneve të tyre të shumtë. Jeta është kimisti madhështor, i cili u jep shije frutave dhe erëzave, ndërsa trëndafilit aromë, ajo shndërron ujin dhe acidin karbonik në sheqer dhe dru, dhe duke bërë këtë, çliron oksigjenin në mënyrë që kafshët të mund të marrin frymë.

Shihni një copëz të vogël protoplazme, e padukshme dhe e tejdukshme gati si pelte, që është e aftë të lëvizë duke thithur energji nga dielli. Kjo qelizë e thjeshtë, kjo pikë e tejdukshme si mjegull, përmban në vete bërthamën e jetës dhe ka fuqi ta përhapë këtë jetë, te të gjitha krijesat e gjalla, të mëdha apo të vogla.

Ndikimi i kësaj pike është më i fuqishëm dhe më përfshirës se vegjetacioni jonë, i kafshëve dhe njerëzve, për arsye se tërë jeta vjen prej saj. Natyra nuk e ka krijuar jetën. Flluskat e zjarra të shkëmbinjeve dhe

detet pa kripë nuk mund t'i bashkonin elementet.

Kush, pra, atëherë e solli atë këtu?

E treta: Urtësia e kafshëve pareshtur flet për Krijuesin e Mirë, që frymëzoi me instinkt krijesat e vogla e të pafuqishme. Salmoni i vogël kalon vite në det, pastaj udhëton deri te bregu i lumit në të cilin derdhet rrjedha ku ka lindur. Kush bën që ai të kthehet me kaq saktësi aty? Nëse e sillni në rrjedhën tjetër, ai në moment do ta kuptojë se ka devijuar në udhëtimin e tij, dhe do të kthehet rrugës prapa e të shkojë te rrjedha e saktë, e pastaj duke notuar kundër rrymës përfundon fatin e tij ashtu si duhet.


Edhe më vështirë është të zgjidhësh misterin e ngjalës. Kjo krijesë e jashtëzakonshme, kur zhvillohet plotësisht, migron në të gjitha anët e gjithë liqeneve dhe lumenjve, ato nga Evropa me mijëra

milje në anët tjera të oqeanit, të gjitha në rrugë kah thellësitë e pafundme në afërsi të Bermudeve. Aty shumëzohen dhe vdesin. Të vegjlit, qartazi, pa mundësi njohje të asgjëje, pos që gjenden në hapësirat e gjera të oqeanit, prapëseprapë, gjejnë rrugën për kthim, jo vetëm te brigjet e njëjta, por shkojnë te lumenjtë, liqenet dhe kënetat e vogla nga të cilët kanë ardhur prindërit e tyre, kështu, të gjitha rrjedhat kryesore të ujit gjithmonë janë të banuara me ngjala.

Asnjëherë ngjala amerikane nuk është kapur në Evropë, dhe as ngjala evropiane në ujërat amerikane. Natyra e ngjalës evropiane, për më tepër shtyn maturimin e saj një vit ose më shumë për t'i përgatitur për udhëtimin e tyre të gjatë. Prej ku buron ky impuls drejtimi?

Anza pasi e kap brumbullin, hap zgavrën në tokë, e thumbon atë mu në vend të saktë, kështu që ai nuk vdes, por humb vetëdijen dhe vazhdon të jetojë në formë të prodhimit të "mishit të konservuar". Pastaj, anza ngadalë do të shtrojë vezët e saj, kështu që larvat kur çelin, munden nga pak ta grimcojnë, e jo ta mbysin insektin me të cilin ushqehen. Mishi i ngordhur do të ishte fatal për to. Nëna pastaj do të fluturojë dhe do të vdesë, ajo asnjëherë nuk do t'i shohë të vegjlit e saj.

Me siguri, anza të gjitha këto duhet t'i bëjë drejtë



qysh herën e parë dhe për çdo herë tjetër, përndryshe nuk do të ishte anzë. Këto teknika të fshehta nuk mund të shpjegohen me evoluim, këto janë dhuratë.

E katërta: Njeriu është më shumë se kafshë instinktive, ai zotëron fuqinë e mendjes. Asnjëherë nuk është gjetur asnjë provë për ndonjë gjallesë tjetër mbi tokë me aftësinë e saj për të numëruar deri në dhjetë ose së paku të kuptojë rëndësinë e numrit dhjetë.

Përderisa instinkti është si një notë flauti, e bukur, por e kufizuar, truri i njeriut përfshin të gjitha notat e të gjitha instrumenteve si në një orkestër. Nuk ka nevojë që pika e katërt të shtjellohet. Duke falënderuar arsyen njerëzore ne jemi në gjendje të mendojmë për mundësinë se këta që jemi, jemi vetëm për arsyen se kemi pranuar shkëndijën e Inteligjencës Universale.

E pesta: Furnizimi për të gjitha gjallesat del në pah në fenomenin që ne sot e njohim, si mrekullia e gjeneve. Kaq të imëta janë këto gjene, sa sikur të gjithë ato gjene që janë përgjegjës sot për gjithë njerëzit e gjallë në botë, të mund të vendosen në një vend, ky vend do të ishte më i vogël se maja e gishtit.

Këto gjene ultramikroskopike dhe bashkudhëtarët e tyre, kromozomet, banojnë në çdo qelizë të gjallë dhe paraqesin një kod të kompletuar për gjitha karakteristikat njerëzore, shtazore dhe bimore. Maja e gishtit është hapësirë e vogël në të cilën mund të vendosen të gjitha karakteristikat individuale për dy miliard njerëz. Sidoqoftë, faktet mbesin të pakontestueshme.

Për këtë lind pyetja, se si këto gjene përfshijnë trashëgiminë e tërësishme nga paraardhësit e shumë dhe ruajnë psikologjinë e secilit individ në këtë hapësirë pakufi të vogël? Këtu evolucioni, fillon vërtet në qelizë, pra në njësinë që përmban gjeni. Si disa milion atome, të mbjella në formë të gjeneve ultramikroskopike munden në tërësi të mbizotërojnë me çdo gjë në tokë, p.sh. mendjempërhtësia, largpamësia, parashikimet dhe parapërcaktimet që mund të rrjedhin vetëm nga Inteligjenca Krijuese. Asnjë

hipotezë tjetër nuk është e qëndrueshme.

E gjashta: Duke vëzhguar harmoninë e natyrës jemi të detyruar të shohim që vetëm urtësia e pafund mund të parashikojë, rregullojë funksionimin dhe mbikqyrjen e saj me kaq mendjempërhtësi.

Para shumë vitesh një lloj kaktusi u mboll në Australi si pengesë mbrojtëse në rrugë. Pa insekte “armik” në këtë kontinent, kaktusi filloi të zgjerohet në mënyrë të stërmadhe. Alarmi u vu kur kaktusi mbuluoi një rajon të gjatë dhe të gjerë sa Anglia, duke i shtyrë banorët nga qytetet dhe fshatrat, dhe duke shkatërruar fermtat e tyre. Në kërkim të mbrojtjes, specialistët shëtitën tërë botën. Në fund u paraqitën me insektin, i cili ushqehet kryesisht me kaktus, dhe nuk ha asgjë tjetër. Gjithashtu, ky insekt mundi të shumëzohej pa vështirësi dhe nuk kishte armiq

në Australi. Pra, insekti shumë shpejt mbizotëroi kaktusin dhe dëmtuesi u tërhoq.

Ky kontroll dhe kjo barazpeshë në përgjithësi është e sigurt. Përse insektet, që shumëzohen me shpejtësi të madhe nuk dominojnë në Tokë? Për arsye se ata nuk kanë mushkëri si njerëzit, ato frymojnë nëpërmes gypave. Sepse, pasi rriten insektet, gypat e tyre nuk zhvillohen paralelisht me rritjen e trupit të tyre. Sikur ky kontroll mbi zhvillimin e tyre trupor nuk do të ishte i sigurt, njeriu nuk do të mund të ekzistonte. Imagjinoni takimin me një insekt të madh sa luani.

E shtata: Fakti që njeriu kultivon në vete idenë për Zotin është argument unikal.

Koncepti i Hyjnisë buron nga aftësia që Zoti i ka dhuruar njeriut, të cilën nuk e fitojmë nga bota jonë, këtë aftësi e quajmë imagjinatë. Me fuqinë e kësaj aftësie, njeriu dhe vetëm njeriu është në gjendje të gjejë argumente për gjërat që nuk i sheh. Panorama që kjo fuqi zbulon është e pakufishme. Gjithsesi, sa më shumë përsoset njeriu, aq më shumë imagjinata bëhet realitet shpirtëror.

Përktheu dhe përshtati:
Prim. dr. med. sc. Ali F. Iljazi





Si fitohen Zemrat

All Riza Temel

Orientalisti anglez, S. Thomas Arnold (1864-1930), në veprën e tij "Daveti Islam", përcjell një ndodhi shumë mësimdhënëse. Ndodhia ka lidhje me pranimin e Islamit nga ana e sulltanit të Kashgarit, Tulluk Timur Hanit.

Tulluk Timuri e pranoi Islamit kur ishte ende shehzade (princ), në sajë të Shejh Xhemaledinit, që kishte ardhur nga Buharaja. Shejh Xhemaledini së bashku me shokët e tij, pa e ditur, hyri në zonën ku shehzadja e kishte ndarë për gjueti. Kur shehzades i erdhi në vesh ky lajm, urdhëroi të kapeshin dhe të sillleshin para tij. Urdhri u zbatua dhe, kur i sollën, shehzadja filloi të bërtiste me zemërim:

- Si guxuat të hynit pa leje në pronën time?

Shejh Xhemaledini, i përgjigjet:

- Ne nuk e dinim se po ecnim në një zonë të ndaluar, sepse jemi të huaj.

Kur shehzadja e kuptoi se ata ishin prej Iranit, me një sjellje poshtëruese dhe tallëse, u tha:

- Edhe qentë tanë, janë më superiorë se irania-nët.

Shejh Xhemaledini, reagoi:

- Shejhzaadja ka të drejtë. Nëse Allahu nuk do të na kishte nderuar me fenë e vërtetë, ne do të ishim më të ulët se qentë. Shehzadja u habit nga këto fjalë, por megjithatë vazhdoi gjuetinë. Mirëpo, fjalët e shejhut sa vinin dhe po i oshëtinin gjithnjë e më shumë në mendjen e shehzades. Për këtë arsye, dha urdhër që pas gjuetisë t'ia sillnin përsëri të huajt. Kur mbeti vetëm për vetëm me shejhun, i tha:

- Çfarë deshe të thuash me ato që the, për cilën fe të vërtetë e ke fjalën?

Shejh Xhemaledini ia shpjegoi besimin me një metodë aq të bukur, saqë shehzades iu zbut zemra. Gjithashtu, edhe mohimin e tregoi aq të frikshëm, saqë shehzadja u dridh i tëri dhe e kuptoi që gjendej në humbje. Pasi u mendua një copë herë arsyetoi: nëse do të deklaroj Islamit, nuk do të kem aq forcë për ta futur popullin tim në Islam. Prandaj, i kërkoi shejhut pak kohë sa t'i bashkojë principatat e shpërndara. Pastaj i tha që ta vizitojë përsëri, pasi të ketë marrë fuqi dhe ta ketë përqendruar pushtetin e tij plotësisht. Si përfundim, Tulluk Timuri, i bashkoi principatat dhe formoi një shtet të madh.

Ndërkohë, shejh Xhemaledini u kthye në vendin e vet, ku e kapi një sëmundje e rëndë. Pak para se të vdiste, thirri djalit e tij, Reshidudin dhe i tha:

- Tulluk Timuri një ditë do të bëhet mbret i madh. Kur ta dëgjosh këtë lajm, shko tek ai dhe jepi selam prej meje. Pastaj thuaji që të kujtojë fjalën që më dha.

Dhe me të vërtetë, ashtu ndodhi. Tulluk Timuri zuri vendin në fronin të atit dhe të gjithë u bashkuan me të. Pasi e mori këtë lajm, Reshidudini shkoi te sulltani për të çuar në vend amanetin e babait. Mirëpo, megjithëse u mundua shumë, nuk arriti të takohej dot me sulltanin e ri. Për këtë arsye, në mes të natës shkoi pranë vendpushimit të Sulltanit dhe filloi të thërrasë ezanin me zë të lartë.

Sulltani u ngrit nga gjumi i nevrikosur dhe urdhëroi t'ia sjellin prishësin e qetësisë. Në këtë mënyrë, Re-

shidudini doli përpara sulltanit dhe, pasi i dha selamin e të atit, i kujtoi atij fjalën e dhënë. Në fakt, sulltani nuk e kishte harruar këtë çështje. Prandaj, Tulluk Timuri menjëherë dëshmoi shehadetin dhe feja islame u përhap në të gjitha vendet e zotëruara prej fëmijëve të Çatajit, djalit të Xhengiz Khanit.

Mongolët e Xhengizit, në shekullin e shtatë hixhri pushtuan botën islame si tufa karkalecësh. Ata shkatërruan dhe dogjën gjithçka, duke mos lënë dy gurë bashkë. Në botën islame nuk kishte mbetur më asnjë shpresë dhe të gjithë filluan të besonin se mongolët ishin të pathyeshëm. Për këtë arsye, jetën nën sundimin e tyre e kishin konsideruar si një farë kaderi (caktimi hyjnor). Mirëpo, në sajë të punës dhe përpjekjeve të sinqerta të Shejh Xhemaledinit dhe të të tjerëve si ai, mongolët që ishin armiq të më të egër të Islamit, u bënë myslimanë në një kohë të shkurtër, duke e mbrojtur Islamin dhe duke marrë në dorë flamurin e tij.

Tomas Arnold, i cili na e përcjell këtë ngjarje shumë mësimdhënëse, shprehet:

“Ftuesit islamë arritën t’i sillnin në rrugë të drejtë mongolët, të cilët përdorën çdo lloj tiranie dhe torture mbi myslimanët. Ata vuajtën shumë, sepse për t’i fituar mongolët, konkuronin edhe me dy fetë e tjera të mëdha, Budizmin dhe Krishtërimin. Askush nuk e besonte se në këtë luftë do të fitonte Islami dhe mongolët. Kjo, sepse qytetet që ishin djepi i dijes dhe artit islam, ishin shkatërruar prej tyre krejtësisht, ndërsa dijetarët dhe artistët ishin vrarë po prej tyre, ndërsa ata që kishin mbetur gjallë jetonin në robëri. Por, megjithë këto vështirësi, mongolët pranuan dhe i hapën krahët fesë së popullit, që kishin kaq kohë që shkellnin me këmbë.

Padyshim që ky sukses është arritur në sajë të ftuesve islamë modestë, të sinqertë, sakrifikues, të përkushtuar dhe që kanë marrë edukimin e mbi-zotërimit ndaj nefsit (egos).

Edhe sot është e njëjta gjendje. Edhe sot ka forca që simbolizojnë mongolët e asaj kohe. Edhe pse myslimanët nuk kanë mundësi materiale t’u kundërvihen këtyre forcave, ata kanë mundësinë të bëjnë për vete zotëruesit e këtyre forcave. Ata që nuk kanë mundësi të kenë armë, shumë mirë mund të kenë mundësinë t’ia fitojnë zemrat atyre që zotërojnë armët. Kështu që edhe çështja zgjidhet prej rrënjëve. Ata që ditën të hynin në zemrën e Tulluk Timurit, arritën të hynin në zemrën e gjithë popullit.

Ky mund të duket si një ideal i paarritshëm. Mirëpo, një gjë që ndodh njëherë, mund të ndodhë përsëri. Të zotërosh zemrat dhe mendjet, është më e rëndësi-

shme se të zotërosh hapësira të mëdha tokash.

Pejgamberi (a.s.), idhujt i shkatërroi me duart e vetë idhujtarëve. Kjo varet nga aftësia që ka dikush për të bindur të tjerët. Të kesh gjithmonë të drejtë dhe të gjendesh gjithmonë në pozicionin e drejtë, të mos biesh në gabimet e armiqve, sinqeriteti, qëllimi i mirë dhe përkushtimi, janë mënyrat më të sigurta të një suksesi të vazhdueshëm.

Gjendja e keqe e myslimanëve të sotëm, më tepër se prej dobësisë materiale, vjen nga dobësia e besimit dhe moralit. Siç thotë edhe Muhamed Ikbali:

“Safët



(rreshtat) të shtrembër e të shpërndarë. Zemrat bosh e të hutuara. Sexhdja e flohtë e pa jetë, pa zjarr e pa dëshirë. Shkëndija e zemrës është fikur, prushi i shpirtit është bërë hi.”

Kudo kemi shumë liderë dhe ligjërues, që mbajnë fjalime të bukura dhe bindëse, por gjendja është siç thotë poeti Murad Abadi: “Sa të shkëlqyeshme janë fjalët e ligjëruesit! Sa e bukur është shprehja e tij! Mirëpo, në sytë e tij nuk po e shoh dritën e dashurisë ndaj Allahut dhe në fytyrën e tij nuk po e shquaj shkëndijën e besimit dhe të dashurisë.”



Pikësëpari, pastri-
mi i myslimanëve prej dobë-
sive të tyre të brendshme dhe rifitimi i
fuqisë, varet nga përpjekjet e sinqerta
të njerëzve të fesë dhe të dijes. Mirëpo,
siç thotë edhe i ndjeri Ebu'l Hasen Nedvi:
"Për shkak se njerëzit e fesë janë dhënë
tepër pas dukjes e jetës së rehatshme
dhe frikësohen prej popullit dhe shtresës
së lartë, përpjekja e tyre mbetet e zbehtë
dhe ndikimi i tyre i dobët."

Çdo gjë fillon dhe mbaron në zemër. E gjithë
çështja është të hysh në zemër. Dhe rruga e kësaj
është dashuria dhe përkushtimi. Dashuria është
forca më e madhe. Një qerasje, qoftë edhe e vogël
dhe një selam me buzëqeshje, janë nga rrugët më të
lehta për të fituar miq të vërtetë. Kjo rrugë nuk ka as
mundim dhe as rrezik.

Le të japim një shembull të mrekullueshëm të mi-
rësive që sjell puna dhe shërbimi që bëhet pa asnjë
interes dhe vetëm për hir të Allahut:

Ahmed Shehidi, i cili është një nga njerëzit më të
rëndësishëm të tasavufit në Indi, doli për të shkuar në
haxh së bashku me një karvan të madh. Në një pjesë
të udhëtimit po kalonte me vapor mbi lumin Gang. Në

portin e Mirzapurit, rastisi një anije tregtare të ngar-
kuar me pambuk. Pronari i mallit ishte duke pritur
punëtorët për të shkarkuar pambukun nëpër depo.
Sapo e pa këtë, Ahmed Shehidi i urdhëroi udhëtarët
që ishin bashkë me të, të shkonin e të shkarkonin
të gjithë mallin në depo. Pas një kohe të shkurtër, i
gjithë malli që ndodhej në atë anije të madhe, ishte
boshatisur dhe stivuar në depo. Ata që e panë këtë
ngjarje, filluan të pëshpëritnin me njëri-tjetrin, duke
thënë:

"Nuk kemi parë kurrë si sot. Këta njerëz, as nuk e
kanë gjë dhe as nuk e njohin pronarin e mallit, por
megjithatë, e shkarkuan atë pa asnjë shpërblim, ve-
tëm për hir të Allahut. Padyshim që këta duhet të
jenë evlija."

Sipas atyre që tregojnë historianët, kur Ahmed
Shehidi po shkonte në Mekë, qëndroi për pak kohë në
Kalkutë. Aty mbajti ligjëratat dhe dha këshilla. Ndër-
sa njerëzit vinin turma- turma për ta takuar. Sjelljet
dhe këshillat e tij kishin ndikuar aq shumë, saqë në
Kalkutë, që është edhe një nga qytetet më të mëdha
të Indisë, tregtia e alkoolit ishte ndaluar dhe pijeto-
ret kishin falimentuar një nga një. Kurse pronarët e
pijetoreve të falimentuara, për arsye se puna kishte
ndaluar, nuk paguanin asnjë taksë¹.

Të shërbesh me cilësi dhe drejtësi, është detyrë,
ndërsa ta bësh atë vetëm për hir të Allahut, është
virtut. Shërbimi, që në pamje të parë duket si pa asnjë
shpërblim, sjell shumë më tepër fitime se pagesa që
merret zakonisht. Para së gjithash, fitohen zemrat
dhe miqësia. Kundrejt atij që shërben pa interes, lind
një respekt i veçantë, fjalës së tij i besohet dhe feja e
tij respektohet. Ata që shfaqin sjellje të tilla pozitive,
ndikojnë më shumë me qëndrimin e tyre se sa me
fjalët. Heshtja e tyre thërret më shumë se fjala.

Qëllimi i tasavufit është të edukojë më shumë nje-
rëz të shpirtit se të fjalës. Është morali i bukur. Edhe
Pejgamberi (a.s.), ishte dërguar për të plotësuar mo-
ralin e bukur. Dallimi më i rëndësishëm i myslimanëve
prej të tjerëve, duhet të jetë sakrifica dhe morali i
bukur. Ata që nuk e shfaqin këtë dallim me fjalë dhe
vepra, pretendimi për fetarinë e tyre nuk është edhe
aq i besueshëm. Ata, fjalët e të cilëve nuk përkojnë
me veprat e tyre, janë pengesat më të mëdha për-
para Islamit. Të bëhesh vetë pengesë, ndërkohë që
e ke për detyrë të heqësh pengesat, është një gjynah
shumë i madh.

Allahu na bëftë prej atyre, fjalët e të cilëve përkojnë
me veprat, njerëz të punës dhe të zemrës. Amin!

1. H. A. Nedvi, "Çfarë humbi bota me rënien e myslimanëve" fq. 240.

Edukimi është një sfidë e hapur ndaj qenies njerëzore. Ky proces që e shoqëron njeriun gjatë gjithë jetës, modelohet dhe lutohet në përputhje me sisteme të caktuara ideore, me të cilat qenia njerëzore është në kontakt qysh nga fëmijëria dhe rinia e tij. Edukimi është një proces që e shoqëron njeriun në të gjitha fazat jetësore, por ne përmendëm fëmijërinë dhe rininë, pasi përgjithësisht në këto dy faza njeriu mbushet me ide dhe krijon botëkuptimin e tij mbi jetën dhe statusin e tij në këtë botë. Këto janë vitet në të cilat ndodh jo vetëm grumbullimi i njohurive, por dhe sendërtimi i mendësive mbi mënyrën e të jetuarit. Edhe pse njeriu përpiqet vazhdimisht të edukojë veten e tij përgjatë jetës, sërish edukimi dhe formimi i hershëm nxjerr krye në situata dhe ngjarje të caktuara, duke dëshmuar rëndësinë e këtij procesi gjatë fëmijërisë dhe rinisë.

Përderisa çdo sistem ideor, përpiqet të shenjtërojë vetveten tek masa e njerëzve që mëton të kontrollojë dhe sundojë, edhe sistemi totalitar komunist do të përpiqej me mish e me thonj që nëpërmjet procesit të edukimit të ndërtonte njeriun e ri, të edukuar sipas parimeve të vijës së drejtë marksiste-leniniste. Por në çfarë mënyre do të realizohej edukimi i njeriut të ri, si do të veprohej dhe cilët do të instrumentalizoheshin për këtë qëllim?

Sikundërse është e mirëpranuar, sistemi arsimor, është një nga levat kryesore të mbrujtjes me ide dhe mendime të caktuara të brezit të ri, aq më tepër që kontakti me këtë sistem nis qysh në moshën parashkollore. Pikërisht për këtë arsye, shkollat duhet të jenë vatrat e përhapjes dhe propagandës së vazhdueshme të ideve komuniste, prandaj për këtë çështje duhej treguar një kujdes i posaçëm dhe mbikëqyrje e vazhdueshme në të gjitha hallkat e sistemit arsimor. "Ai (*komsomoli*) duhet të mbikëqyrë, ai duhet të bëjë një punë të përditshme në shkollë, duke filluar nga më e ulëta gjer te më e larta. Ai duhet të ndihmojë për plotësimin e patundur të direktivave respektive të qeverisë dhe ta organizojë më mirë mësimin dhe jetën e nxënësve." (Kalinin², M.I faq. 26, Tiranë, 1967). Kjo mbikëqyrje dhe punë e vazhdueshme me shkollat, synonte të injektonte tek brezat e rinj bindjen se vetëm nëpërmjet pushtetit komunist do të ishin njerëz të denjë për të realizuar detyra të mëdha. Natyrisht, kjo do të thoshte se njohuritë që do të përftoheshin nga gjithësa u tha më sipër, do të uleshin në bankat e shkollës, do të përzgjidheshin në përputhje me politikën zyrtare. Kësisoj, i gjithë procesi i edukimit do të ishte tërësisht i politizuar dhe verdiktin për sasinë, masën, llojin dhe natyrën e njohurive që do të grumbullonte nxënësi apo studenti, do ta vendoste përdhunshëm nomenklatura zyrtare. "Tek ne ndërjegjia

MBI NA E EDUKIMIT



politike e njerëzve luan një rol shumë të rëndësishëm dhe ne synojmë që çdo njeri të jetë politikisht i ndërgjegjshëm." (Kalinin:187). Politizimi i sistemit arsimor synonte që të prodhonte individë të kualifikuar ideologjikisht, të rrahur dhe kalitur në kudhrën marksiste-leniniste, të gatshëm për të sakrifikuar gjithçka nga jeta personale në dobi të interesit shoqëror, si më i larti që duhej realizuar. Vetëm duke realizuar interesin shoqëror, jeta e njeriut merrte kuptim dhe lumturia ishte e garantuar. "Ta çojmë deri në fund çështjen e Leninit dhe Stalinit. Në qoftë se ju do të forcoheni në një drejtim të tillë dhe do t'ia nënshtrohi kësaj ideje të gjitha të tjerat, atëherë...shokë, lumturia dhe gëzimi i jetës janë të siguruara." (Kalinin:114). E natyrisht, modeli që duhet të frymëzojë këtë mënyrë të jetuari është modeli i udhëheqësit, që shndrit si yll polar në konstelacionin e shoqërisë socialiste. "Kështu pra, jeta e ngjeshur me interesa shoqërore, jeta me një qëllim të caktuar, është jeta më e mirë, më interesante në tokë. Po ashtu model i një jete të tillë është pikërisht jeta e shokut Stalin." (Kalinin:102-103). Në këtë kontekst, rinia duhet të jetë e përgatitur, e fortë, rezistente, aktive në jetë, në mënyrë që të çojë përpara misionin e ngarkuar nga historia. "Shokë, historia na ka ngarkuar një detyrë me përgjegjësi dhe të ndershme – të çojmë luftën tonë klasore gjer në fitoren e plotë të komuniz-

1. Komsomoli, Unioni leninist i komunistëve të rinj.

2. Mihail Ivanoviç Kalinin, president i Presidiumit të Sovjetit Suprem të BRSS, fjalime të periudhës 1925-1945.

TYRËN KOMUNIST

mit.” (Kalinin:25). Dhe natyrisht që baza, themeli prej nga ku rinia do të frymëzohej për realizimin e të gjitha idealeve komuniste në dobi të interesit shoqëror ishte marksizëm-leninizmi, që mbrun rininë me armën e fortë të shkencës, kombinuar me veprimtarinë praktike, për një produktivitet të lartë në punë. Kjo klasë punëtore, që do të farkëtohej në sistemin shkollor, natyrisht që nuk do të duhej të ishte e pajisur vetëm me njohuritë teknike të profesionit, por ajo duhej të ishte e gatshme të përleshjej pamëshirshëm me armiqtë e komunizmit dhe atdheut socialist. Për të pasur këtë gatishmëri, nuk u lanë jashtë vëmendjes edhe njohuritë ushtarake, të cilat duhej t’i zotëronte çdo individ. “Ne përgatitim punëtorë të kualifikuar, por duhet që ata, në qoftë se do të kërkohet, të dinë edhe të luftojnë. Dhe, do të ishte një gabim i pafalshëm për ne, në qoftë se nuk do t’i armatosnim ata me njohuri ushtarake.” (Kalinin:175). Kjo klasë, më progresistja në historinë e njerëzimit, e armatosur me ideologjinë marksiste-leniniste, materializmin shkencor, përgatitjen ushtarake, qëndron në ballë të furtunave imperialiste dhe borgjezo-revizioniste si shkëmb graniti, për të mbrojtur interesat e gjithë njerëzimit punonjës. “Revolucioni ynë socialist, për herë të parë në histori, duke luftuar për interesat e klasës përparimtare, klasës më progresive në histori, proletariatit, lufton në të njëjtën kohë për interesat e

gjithë njerëzimit punonjës.” (Kalinin:29). Duke cilësuar proletariatin si klasën më progresiste në gjithë historinë e njerëzimit, propaganda komuniste, damkosi me vulën e stërmadhe të tradhëtisë elitën intelektuale, të cilën e akuzoi si të krimbur nga vemja feudale dhe për ta shkrimbur, e syrgjynosi nëpër gulçet e burgjeve dhe kampeve të detyruara të punës, që për një shumicë të konsiderueshme ishin memorialet e tyre për së gjalli. Ndërkohë, proletariati zjente nga një zjarrmi e papërmbajtur për të studiuar në mënyrë konstante rezultatet e kërkimeve shkencore. “Akademia e kuptoi se punëtorët dhe fshatarët e kanë të shtrenjtë shkencën, i ndjekin rezultatet shkencore. Ata tregojnë një vëmendje të jashtëzakonshme dhe simpati ndaj shkencës, shumë më tepër sesa shoqëria e privilegjuar e vjetër.” (Kalinin:163). Por kush do të ishte ai që do të edukonte brezin e ri me këtë frymë ideologjike, në mënyrë që shoqëria socialiste të konfigurohej plotësisht sipas ideologjisë marksiste-leniniste? Ky personazh do të ishte figura e mësuesit, detyra kryesore e të cilit do të ishte edukimi i njeriut të ri dhe qytetarit të shoqërisë socialiste. Që kjo detyrë të ishte e suksesshme dhe rezultative, mësuesit do të duhej të kishin përvetësuar dhe përthithur thellësisht më së pari marksizëm-leninizmin. Qëllimi themelor i edukimit komunist, ishte prodhimi i një mase punëtorësh dhe fshatarësh, që do të shfrytëzoheshin (skllavëroheshin) për ndërtimin e socializmit. Gjatë gjithë këtij procesi, duke qenë të indoktrinuara thellësisht deri në qelizën e fundme, këtë shfrytëzim nuk do ta shihnin si skllavëri, por si një sakrificë për të mirën e njerëzimit punonjës, që vuante nën thundrën e kapitalistëve barkanjozë. Dhe këtë dozë opiumi duhej ta injektonin reanimatorët besnikë deri në vdekje të marksizëm-leninizmit, mësuesit indoktrinuarë. “Sigurisht që kjo fuqi e njerëzve punëtorë dhe fshatarë të shfrytëzohet në maksimum në ndërtimin socialist, duhet që masa kryesore intelektuale- mësuesit, të jenë besnikë gjer në fund të kësaj ideje.” (Kalinin:133). Dhe për ta vendosur në binarët e duhur këtë çështje, tejet të rëndësishme për suksesin e ndërtimit të socializmit, ideologjia marksiste-leniniste shenjtërohej, duke u kthyer në sistem referimi për t’i gjetur zgjidhje problematikave të ndryshme jetësore, vetëm përbrenda kësaj ideologjie dhe jo jashtë saj. Vetëm në këtë mënyrë do të matej suksesi i indoktrinimit dhe marksizimit të njeriut të ri. “Të gjeshe një zgjidhje të drejtë në këto raste dhe t’i kuptosh drejt ato, të gjeshe ç’qëndrim të mbash ndaj tyre nga pikëpamja e marksizmit, ja, këtu provohet marksisti!” (Kalinin:136-137). Ky edukim emetoi njeriun e marksizuar, birin ideologjik të diktaturës së proletariatit dhe utopisë komuniste, që nuk njeh shenjtëri tjetër përveç boshtit ideologjik marksist-leninist, edhe atëherë kur faktet provojnë tërësisht të kundërtën.

Streha e besimtarit

Prof. dr. Hasan Kamil Jëllmaz

Lutja është një moment përgjërimit dhe strehimi i njeriut te Krijuesi i tij, është çasti kur njeriu përfshihet në një bisedë të singertë dhe të çiltër me Zotin e tij të mëshirshëm dhe të dashur. Momentet e lutjes janë njëkohësisht momentet, kur komunikimi i robit me Zotin ndodhet në nivelin më të lartë dhe më të dendur, si në planin fizik, ashtu edhe në planin shpirtëror. Në të njëjtën kohë lutja është shprehje e vetëdijes së njeriut për dobësinë dhe brishtësinë e tij.

Nevojën e tij për Allahun, njeriu e shpreh përmes lutjes dhe përgjërimit. Për të shprehur rëndësinë e madhe të lutjes, Allahu e ka barazuar vlerën e njeriut me lutjen: **“Thuaj: “Zoti im nuk do t’ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj...”** (Furkan, 77) Madje, Kurani na tregon se qëllimi i dërgimit të fatkeqësive dhe ndëshkimit te popujt e hershëm ka qenë ndërgjegjësimi i tyre për lutje dhe përgjërimit drejtuar Allahut, Krijuesit të gjithësisë. Pra, Allahu kërkon prej nesh t’i lutemi Atij për çdo gjë.

Në një këndvështrim, lutja është një dritare që Allahu i ka hapur njeriut, kurse në një këndvështrim tjetër është një shkallë që i shërben njeriut për të arritur në dritare. Pranimi i lutjes së besimtarit nga ana e Allahut përbën kornizën e lutjes: **“Kur robërit e Mi (besimtarë) të pyesin për Mua, (thuaju se) Unë jam afër, i përgjigjem lutjeve të lutësit, kur ai më lutet Mua. Prandaj, le t’i përgjigjen thirrjes Sime dhe le të më besojnë Mua, për të qenë në rrugë të drejtë.”** (Bekare, 186)

Lutja është komunikim me Krijuesin dhe përjetim i një gjendjeje shpirtërore të papërshkrueshme, e cila i kalon kufijtë e tokësore. Prandaj, ekzistenca e Allahut për syrin që shikon dhe zemrën që ndjen është po aq e pranishme sa drita e diellit dhe era e trëndafilut. Ashtu siç qëndrojnë lulet të freskta dhe të gjalla prej dritës që marrin prej diellit edhe besimtari është i fortë dhe dinamik falë energjisë shpirtërore që merr prej lutjes. Lutja është

një përqendrim, por një përqendrim i forcës së zemrës dhe dashurisë.

Në lutje, më tepër se mënyra e artikullimit të fjalëve, i rëndësishëm është vërshimi i entuziazmit në zemër. Lutja është komunikim me Allahun, prandaj Ai përmes ajeteve: **“Lutmuni Mua, se do t’ju përgjigjem! Me të vërtetë, ata që tregohen mendjemëdhenj e nuk duan të Më adhurojnë, do të hyjnë në Xhehenem të poshtëruar.”** (Gafir, 60), i fton robërit e Tij për komunikim dhe bisedë me Të. Madje, urdhëron që ky komunikim të jetë i çiltër dhe i singertë. **“Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë”** (Araf, 55)

Pejgamberi (a.s.), përmes Hadithit **“Lutja është ibadet”**, shpreh rëndësinë e lutjes në adhurim. Lutja është çelësi i nevojës. Përmes lutjes nevojtarët gjejnë zgjidhje, të sëmurët shërim, kurse të brengosurit qetësi. Ajeti kuranor: **“Ata janë dorështrënguar”** i qorton hipokritët që nuk i hapin duart për t’ju lutur Allahut të madhërishtëm.

Sipas sufive, lutja e bërë me gjuhën e gjendjes dhe zemrës është më afër plotësisht se lutja e bërë vetëm me gjuhën e gojës. Sufitë kanë diskutuar shumë, në lidhje me atë se cila është më e mirë: lutja për largimin e dertit apo pranimi i dertit si caktim i Allahut. Shumica e tyre kanë arritur në përfundimin se, meqenëse lutja është vetë ibadet, është më e mirë se pranimi i gjendjes me kënaqësi si caktim i Zotit. Këtu është e rëndësishme që besimtari të lutet dhe të pranojë me kënaqësi caktimin e Allahut pas lutjes.

Sipas një rrëfenje, një ditë, kur Salih Murri ishte pranë Rabies, tha: “Nëse një person i bie derës me ngulmim, shpresa që dera të hapet është e madhe.” Kur Rabia i tha: “Kur ka qenë e mbyllur ajo derë, që të hapet?” Salih Murri tha me vete: “Sa njeri injorant që jam dhe sa e urtë që është kjo grua!”

Lutja nuk ka kohë dhe vend të caktuar, ajo mund të realizohet në çdo kohë dhe vend. Megjithatë, ka kohë në të cilën mundësia për t’u pranuar dua është më e madhe, siç është Nata e Kadrit, dita e Xhuma, 1/3 e fundit e natës, po ashtu, ka edhe vende të caktuara si Qabja, Arafati, Xhamia



e Pejgamberit (a.s.), ku mundësia e pranimit të lutjes është më e madhe. Këto vende janë vende lutjeje dhe atmosfera shpirtërore është e lartë, mundësia për t'u furnizuar me energji pozitive është më e madhe. Por lutja asnjëherë nuk duhet kufizuar vetëm në këto vende.

Ndotja teknologjike e jetës dhe zhurma e jetës shoqërore nuk i jep mundësi njeriut t'i ndajë kohë vetes. Në fakt, njeriu e ka të domosdoshme të krijojë një mjedis që siguron një qetësi të brendshme dhe largon lodhjet fizike dhe shpirtërore. Me gjithë vështirësitë për të krijuar një mjedis të tillë, njeriu duhet të gjejë patjetër një kohë për lutje dhe komunikim me Krijuesin e gjithësisë. Kjo është e domosdoshme për të qetësuar zemrën dhe larguar stresin. Duke u nisur nga kjo veti e lutjes, Alexis Carrel, në librin e tij të famshëm "Lutja", thotë: "Lutja e rregullt dhe e vazhdueshme ndërton karakterin e njeriut, prandaj duhet të lutemi sa më shpesh dhe lutjen ta shndërrojmë në stil jete." Po sipas të njëjtit autor, njerëzimi sot po bën një jetë krejtësisht indiferente ndaj lutjes, kur dihen mjaft mirë dobritë dhe ndikimet e shumta psiko-fiziologjike të saj.

Lutja ndikon mbi trup dhe shpirt në raport të drejtë me cilësinë dhe vazhdimësinë e saj. Ndërsa vazhdimësia është e perceptueshme, cilësia e saj është e papercptueshme, sepse nuk ekziston asnjë mjet që ta masë atë, që zemra përmban në brendësinë e saj.

Por është fakt se midis njerëzve me nivel intelektual afërsisht të njëjtë, ata që luten, në krahasim me ata që nuk luten fare, qëndrojnë më lart për nga karakteri dhe morali. Kur lutja bëhet e vazhdueshme, ndikimi i saj rritet më shumë. Në këtë mënyrë, njeriu bëhet më durimtar dhe më i fortë përballë surprizave të hidhura që mund t'i përballë jeta. Qetësia që sjell lutja, është një faktor shumë i rëndësishëm për kurimin e një sërë sëmundjesh psiko-logjike dhe fizike. Në sajë të lutjes, njeriu fiton aftësi për t'i përdorur sa më mirë energjitë intelektuale dhe shpirtërore. Lehtësisht mund të themi se lutja zotëron një fuqi të jashtëzakonshme, duke e ngritur njeriun përtej nivelit ku e ka sjellë edukimi.

Në lidhje me kurimin e sëmundjeve përmes lutjes, Aleksis Carrel thotë: "Lutja ka një efekt të jashtëzakonshëm. Në sajë të lutjes është vërejtur një shërim i shpejtë i sëmundjeve të kancerit, ulçerës, infeksioneve të veshkave, tuberkulozit dhe shumë sëmundjeve të tjera të rënda.

Lutja nuk duhet të vlerësohet si vend strehimi vetëm në raste të vështira dhe gjendje paniku, përkundrazi ajo

duhet të jetë e gjallë në çdo rast dhe të shërbejë gjithmonë si burim energjie dhe force për besimtarin.

Shuarja e ndjenjave fetare dhe morale të një populli mund të çojë në rënien dhe humbjen e identitetit të tij. Një shoqëri që nuk e ndjen nevojën e lutjes, është e predispozuar të humbasë ndjenjën fetare, e cila nga ana e saj sjell humbjen e identitetit.

Lutja siguron lidhjen me botën qiellore. Përmes lutjes njeriu arrin të Krijuesi dhe Allahu gjen vend në zemrën e besimtarit. Lutja nuk duhet të shihet si një veprim i të dobhtëve dhe të pafuqishmëve. Njeriu, siç ka nevojë për oksigjen dhe ujë, ka nevojë edhe për Krijuesin. Duke qenë se lutja është shprehje e nevojës ndaj Allahut, nuk mund të imagjinohet një njeri pa lutje. Besimi në Zot, ndjenja fetare, dituria, intuita dhe intelijenca, të gjitha këto krijojnë personalitetin dhe identitetin e njeriut. Suksesi i njeriut është i lidhur ngushtë me harmonizimin e aftësive fiziologjike, intuitive dhe shpirtërore.

Lutja është arma më e fortë e besimtarit në luftën përballë armiqve dhe vështirësive. Njeriu ka nevojë për lutjen, veçanërisht për të triumfuar mbi egon dhe intrigat e saj.

Për rritjen e mundësisë së pranimit të lutjes, është i nevojshëm plotësimi i disa kushteve. Sipas sufive, kushti më i rëndësishëm për pranimin e lutjes është zemra entuziaste, sepse sipas tyre, Allahu nuk e pranon lutjen e personit indiferent. Një tjetër kusht themelor është fitimi i pastër dhe hallall. Përveç këtyre, Imam Gazaliu në librin e tij të famshëm "Ringjallja e diturive fetare" radhit një sërë kushtesh të tjera:

1. Gjetja e kohës së përshtashme. Megjithëse për pranimin e lutjes nuk ka një kohë të caktuar, ka momente dhe ditë ku mundësia për t'u pranuar është më e madhe, si dita e Arafatit, muaji i Ramazanit, dita e Xhuma dhe koha para agimit.

2. Përfitimi nga momente dhe gjendje të veçanta, si agjërimi, xhihadi etj.

3. Kthimi në drejtim të Qabes dhe ngritja e duarve, sepse Pejgamberi (a.s.), thotë: "Zotit i vjen turp ta kthejë duar-bosh besimtarin që i ngre duart për t'i kërkuar diçka Atij." (Tirmidhiu dhe Buhariu)

4. Lutja të bëhet në heshtje dhe qetësi. Allahu thotë në Kuran: **"Lutjuni Allahut përrulshëm dhe në heshtje!"** (el-A'raf, 55)

5. Qëndrimi larg fjalëve të shumta dhe boshe.

6. Realizimi i lutjes në gjendje përqendrimi dhe përgjërimi.

7. Vendosmëria dhe vazhdimësia në lutje. Siç thotë Pejgamberi (a.s.): "Do t'ju pranohet lutja, përderisa nuk nxito-heni duke thënë: "u luta, por nuk m'u pranua." (Tirmidhiu)

8. Fillimi i lutjes, duke përmendur emrin e Allahut.

9. Shprehja e ndjesës ndaj personave që u është bërë padrejtësi dhe pendimi i sinqertë për mëkatet e bëra.

Një lutje që plotëson këto kushte, me lejen e Allahut hap dyert e zemrave dhe dyert e qiellit.

Nëse dëshiron të jesh i lumtur, Bëhu! - Leon Tolstói -

Ma. Ejup Haziri

Brenda zemrës së çdo njeriu ekziston një dëshirë e madhe për arritjen e lumturisë. Secili individ ka ëndrrat, synimet dhe vizionet e tij për të qenë i lumtur. Por jo gjithçka që ëndërrohet, realizohet. Nga ti varet gjithçka dhe ti je orientuesi i vetvetes. Ndaj, ti mund të arrish të jetosh i lumtur. Leon Tolstói kishte plotësisht të drejtë, kur tha: “Nëse dëshiron të jesh i lumtur, bëhu!” Sigurisht që secili dëshiron të jetë i lumtur, por vetëm dëshira nuk mjafton dhe ajo si e vetme, nuk të shpie drejt lumturisë. Mes dëshirës dhe realitetit ekzistojnë perde të shumta, që duhen hapur dhe gjemba në rrugë që duhen kaluar. Shpesh idealet e larta janë të paarritshme dhe ata njerëz që bazohen vetëm në ideale, mashtrohen dhe shumë herë i kaplon zhgënjimi. Ndaj, duhet të jetosh si realist dhe të punosh si idealist. Ne mund të zgjedhim të jetojmë një jetë që e duam dhe ta duam jetën që jetojmë. Është zgjedhja jonë, ne mund ta shndërrojmë jetën në diçka madhështore dhe pa keqardhje.

Çdo njeri ka aftësi për lumturi të pafundme, nëse është i hapur dhe ndjek hapat e arritjes së lumturisë. Mos harro se dielli gjithmonë ndriçon me shkëlqimin e tij. Ai kurrë nuk ndalet. Ndriçon edhe atëherë kur retë e shumta e të dendura mbulojnë hapësirën e bukur të qiellit. Dielli udhëton edhe atëherë kur shiu lag tokën dhe bora e mbulon atë.

Secili njeri është unik dhe i veçantë në personalitetin e tij. Si i tillë, ai është plot vlera dhe mirësi të shumta, që

i janë dhuruar pa kompensim. Kjo veçanti krijon ndjenjë gëzimi e lumturie, të cilën ai e përjeton në brendësinë e tij. Më e rëndësishme është ana e brendshme, se sa ajo e jashtme. Ka njerëz që duken të lumtur, por po t’ua lexosh zemrat do të shpërthesh në vaj, sikurse ka njerëz që duken të pikëlluar e të përvuajtur, mirëpo, po t’ua lexosh zemrat, do të mallëngjehesh me lumturinë e tyre.

Vlerat e njeriut e bëjnë atë më të qëndrueshëm dhe më të përmbajtur, pa marrë parasysh vështirësitë dhe telashet me të cilat ballafaqohet. Shpesh në vështirësi fshihet e mira, por jo të gjithë e kuptojnë këtë.

Konstrukti yt flet për vlerën tënde. Po të duash t’i numërosh të mirat e tua, nuk besoj se mund t’ia gjeshe fundin. Sytë, gjuha, këmbët, duart, mendja, shpirti e zemra, të gjitha këto flasin dhe rrëfejnë në heshtjen për vlerat që ti zotëron. Po qe se je shëndosh, kujto se miliona njerëz janë të të sëmurë, nëse je i lirë, dije se shumë njerëz janë burgjeve. Po pate ushqim për të ngrënë dhe ujë për të pirë, ti je i lumtur, edhe nëse nuk e ndjen atë, prejse qindra mijëra njerëz vdesin nga uria dhe etja. Dikush vdes në kërkim të një gllënjeke uji apo një kafshate bukë, kurse ti ujin e derdh andej-këndeje, bukën e hedh nga teprimi. Ti, përderisa mund të ecësh dhe të vraposh si të duash, domethënë që të është dhuruar një mirësi e madhe, sepse ka njerëz të shumtë që s’mund të lëvizin fare. Ka njerëz të verbër, të shur-

dhër e memecë. A nuk mendon ti për shikimin, dëgjimin dhe të folurin tënd?

Poeti i madh, Rumi thoshte se ti ke lindur me potencial. Ke lindur me mirësi dhe besim. Me ideale dhe ëndrra. Je lindur me madhështi. Je lindur me krahë, jo për zvarritje, por për të mësuar t'i përdorësh ata dhe të fluturosh.

A dëshiron të të rrëfej një ngjarje, që ta kuptosh më mirë vlerën tënde? Autori i librit *Min Vesaja err-Rresul* rrëfen ngjarjen në fjalë për Dhenun el-Misri, që ky i fundit e ka përjetuar dhe e ka regjistruar, ndaj edhe shprehet: "Isha duke shkuar në një anë të Shamit, vëreja një kopsht të gjelbër, në mes të të cilit ishte një djalosh që qëndronte në këmbë duke u falur nën një pemë molle. Iu afrova dhe e përshëndeta, por ai nuk m'u përgjigj. E përshëndeta prapë, por ai nxitoi për në namaz e pastaj (pasi e mbaroi namazin) me gishtin e tij shkroi në tokë:

*"Gjuha më është prerë nga fjalët,
Prej saj burojnë belatë dhe rreziqet.
Sa flet kot, për këtë botë, bëj dhikër
Falëndero Atë që kurrë nuk do të fiket."*

Kur Dhennuni i lexoi këto fjalë, qau shumë e pastaj me gishtin e tij shkroi në tokë:

*"Çdo shkruer patjetër do të marrë fund
e koha do ta zhdukë atë që duart kanë shkruar.
Mos shkruaj me dorën tënde diçka tjetër,
veç asaj që të gëzon në Jetën e Amshuar."*

Pra, ti akoma nuk e di çfarë vlerash ke dhe në çfarë vlerash jeton. A duhet që këto gjëra të flasin dhe të rrëfej në njëra pas tjetrës për vlerat që ke ti apo ndoshta ti me kohë do t'i zbulosh? Ato flasin dhe të tregojnë në heshtje për të mirat që ti zotëron, por ti nuk mediton rreth tyre, ndaj edhe nuk i kujton ato!

A të ka ndodhur gjatë një pikëllimi a vuajtjeje t'i thuash vetes tënde: Sa i pafat që jam? A mundet një e keqe t'i hedhë në ujë njëqind të mira?

*Nuk meriton të jetosh i
zymtë, pa shpresë dhe me
plot trishtim. Nuk është me
rëndësi të jetosh vetëm në
bollëk dhe të kesh gjithçka
që dëshiron. Është me
rëndësi që shpirtit tënd t'i
sjellësh paqe e gëzim, t'ia
kujtosh vetes vlerat dhe
mirësitë e shumta.*

Pikëllimit tënd i gëzohet ziliqari, kundërshtari dhe armiku yt, vetëm ata e dëshirojnë një jetë të tillë për ty. Ata t'i mohojnë vlerat e tua, jo pse ti nuk ke vlera, por sepse ata janë ziliqarë.

Nuk meriton të jetosh i zymtë, pa shpresë dhe me plot trishtim. Nuk është me rëndësi të jetosh vetëm në bollëk dhe të kesh gjithçka që dëshiron. Është me rëndësi që shpirtit tënd t'i sjellësh paqe e gëzim, t'ia kujtosh vetes vlerat dhe mirësitë e shumta.

Duhet ta njohësh pagën e shpirtit në jetën tënde, në mënyrë që shqetësimet dhe problemet e akumuluar të zhduken apo së paku, të pakësohen. Nuk mund të jetosh i qetë nga jash-të, kur nga brenda jeta është e zymtë dhe atë e ka kapluar mër-zia dhe trishtimi.

Do të tregoj një detaj të shkurtër, në lidhje me këtë, për piktorin e njohur Vinsent Van Gog. Sigurisht, këtu nuk do të

tregoj për vuajtjet dhe sfidat e tij në rrugën e pikturës. Do të tregoj një detaj tjetër për të. Do të tregoj për ëndrrën e tij. Ai ka pasur një dëshirë të kahmotshme të pikturonte perëndimin e diellit. Më në fund, ai e pikturoi perëndimin e diellit. Atë ditë që përfundoi pikturën, shkroi këtë letër: "Unë e krevapunën time. Ndihem plot. E kam jetuar këtë jetë pafundësisht i lumtur." Pas kësaj ai kreu vetëvrasje. Ishte vetëm tridhjetë e shtatë vjeç. Piktura e perëndimit të diellit simbolizon përfundimin e jetës së tij. Për më pak se një dekadë, ai prodhoi më tepër se dymijë piktura, ku tetëqind prej tyre ishin në vaj. Sot, ai kujtohet si një ndër piktorët më të mëdhenj, por bota e mban mend edhe si një njeri të përvuajtur, që me skamje të mëdha dhe në kushte të vështira arriti të realizonte vizionin e tij unik në art. Jeta sociale e vështirë dhe sfidat e mëdha nuk e ndaluan atë të rendte drejt shtigjeve të suksesit, ndonëse ishte pa përkrahje dhe kur thuajse askush nuk e çmonte.

Në këtë jetë ti vjen i mbushur dhe i rrethuar me vlera, që nga lindja e deri në vdekjen tënde. Por ti mund t'i marginalizosh ato, mund t'i mohosh dhe nganjëherë mund të thuash se këto nuk janë vlera. Ndoshta nga një problem i vogël ti mohon njëqind vlera të mëdha! Kur je i lumtur, ti sigurisht nuk e mendon fare pikëllimin. Por as në pikëllim nuk e mendon lumturinë. Këto dy gjëra i japin vlerë dhe mësim jetës tënde. Pa këto të dyja, jeta nuk mund të kuptohet. Sfidat e jetës asnjëherë nuk i humbin vlerat e tua. Ato të japin forcë që të bëhesh i palëkundur ndaj tyre.

JERUZALEMI MYSLIMAN, SHEMBULL I BASHKËJETESËS SË FEVE QIELLORE!

Nexhat Ibrahimli

Duke lexuar librin e intelektualit të mirënjohur mysliman, shejh Imran N. Hosein, *Jeruzalemi në Kuran*, që e keni para vetes të përkthyer në mënyrë të shkëlqyer nga ish-nxënësi im dhe tash miku im, zotëri Daim Abazi, njeriu nuk mund të mos 'lundrojë' nëpër shekuj, duke e soditur këtë ngjarje, nga një anë me ankth nga 'bëmat' hebraike e diç më pak kristiane, por nga ana tjetër edhe me plot dashuri, duke kujtuar periudhën e Omer Ibn Hatabit dhe Salahudin Eju-bit etj. Libri nuk është as i lehtë si një leksion shkolle, e as një tregim fantastiko shkencor plot imagjinatë. Ai është një libër faktesh, provash, para të cilave të gjithë njerëzit do të duhej të meditonin thellë. Në rast se nuk sodisim, e keqja mund të përsëritet, kurse të pafajshmit do ta pësonin si çdoherë. Pikërisht për këtë shkak, të motivuar nga ndërlikueshmëria e temës, vendosëm t'i themi disa fjalë të shkurtra më shumë për temën, se sa për librin, pasi libri flet vetë për veten.

Askush nuk mund ta mohojë faktin se Jeruzalemi është qytet i shenjtë për të tri fetë: Hebraizmin, Kristianizmin dhe Islamin, por gjithashtu askush nuk mund ta mohojë faktin se ekzistojnë dallime në konceptimin e arsyeve përse ai është i shenjtë për ta.¹

Jeruzalemi për hebrenjtë është para së gjithash 'shenjë' e së kaluarës së tyre nacionale dhe bindjes së tyre religjioze

se ata janë "populli i përzgjedhur nga Zoti", sepse kanë prejardhje nga Abrahami. Kjo lidhet me faktin se qysh herët, mbase mbi një mijë vjet para Isait (a.s.), gjatë aktiviteteve të tyre ushtarake, në fqinjësi të Palestinës patën themeluar një mbretëri të vogël. Pas afërsisht një pesëqind vjetësh kjo mbretëri e brishtë u mund nga romakët. Në kohën kur hebrenjtë kishin njëfarë pavarësie, ata luftonin kundër fqinjëve përreth me qëllim të mbrojtjes së trashëgimisë stërgjyshore. Në rast fitoreje, ata i asgjësonin kundërshtarët, pa marrë parasysh në ishin fëmijë, pleq, femra, apo botën shtazore dhe natyrën përreth. Kjo ndjenjë arriti atë shkallë, sa nisën t'i shikonin me sy dhe ndjenjë përcmimi, të gjithë johebrenjtë. E gjithë ekzistenca, e gjithë bota, sipas tyre, është në funksion të hebrenjve. Kjo bëri që ata, bijtë izraelitë, ta shikojnë Jeruzalemin si "të drejtë të trashëguar", deri në shkallën e narcizmit.²

Jeruzalemi ka kuptim edhe për kristianët. Ata mendojnë se Jezusi arriti pikën kulmore pikërisht në Jeruzalem. Aty Jezusi, sipas tyre, u kryqëzua dhe u varros. Edhe kristianët, sikurse hebrenjtë, Jeruzalemin e shikojnë me sy historik dhe shpirtëror, por jo me atë racor apo nacional. Në dallim nga hebrenjtë, ata nuk e shohin Jeruzalemin si trashëgimi stërgjyshore, por si vend i shenjtë që duhet vizituar dhe adhruar. Por kjo dashuri në histori është shprehur duke poshtëruar popujt që gjendeshin aty, gjatë Kryqëzatave,

1. The HarperCollins Dictionary of Religion, San Francisco, 1995, fq. 567-568.

2. D. W. O'Connor, Jerusalem, në: Enciklopedija zivih religija, Beograd, 1990, fq. 326; <http://www.dzemat-oberhausen.de/index.php/tekstovi/politika-i-drustvo/339-pogled-na-Jeruzalem-muhammed-asad>.



pasi u pushtua Jeruzalemi.³

Edhe myslimanët ndaj Jeruzalemit kanë ndjeshmëritë e tyre, me frymë teologjike dhe historike. Lidhja teologjike bazohet në Kuran, kurse ajo historike në vazhdimësinë historike të përvojës fetare të njerëzve që banojnë aty. Shumë pejgamberë lindën, u rritën, vdiqën dhe misionin e tyre pejgamberik e zhvilluan në tokën e Palestinës, kurse Jeruzalemi ishte pika kulmore e aktivitetit të tyre.

Kurani thotë:

"I lavdëruar qoftë Ai që e mbarti robin e Tij (Muhamedit) natën nga Xhamia e Shenjtë (në Mekë) në Xhaminë e Largët (të Jeruzalemit), rrethinën e së cilës e kemi bërë, për t'i treguar atij disa nga mrekullitë Tona. Ai, me të vërtetë, dëgjon çdo gjë dhe sheh çdo gjë." (El-Isra', 1).

Israja e Muhamedit (a.s.), (udhëtimi i natës) deri në Jeruzalem dhe Mi'raxhi i Muhamedit (a.s.), në qiell është manifestim i lidhjes së brendshme ndërmjet porosisë pejgamberike të Muhamedit (a.s.) dhe porosisë së të gjithë pejgamberëve të mëhershëm. Hebrejntë e shohin Solomonin (Sulejmanin, a.s.) si mbret të lavdishëm, por myslimanët atë dhe të atin, Dautin (a.s.), e shohin si një nga shumë pejgamberët e Zotit, varg i cili filloi me Ibrahimin (a.s.), dhe përfundoi me Isain (a.s.). Kjo ka bërë që myslimanët ta quajnë Jeruzalemin *El-Bejt'ul-Mukaddes*, që do të thotë fjalë për fjalë: *Shtëpia e Shenjtë*, qyteti i tretë i shenjtë pas Mekës dhe Medinës.⁴

Për dallim nga hebrejntë dhe krishterët, myslimanët nuk e shikojnë Jeruzalemin, as Palestinën si trashëgimi stërgjyshore, duke përjashtuar popujt e tjerë apo bashkësitë e tjera fetare që ndjekin traditën e Ibrahimit (a.s.). Myslimanët e respektojnë Sulejmanin (a.s.), maksimalisht, por nuk e përvetësojnë atë. Edhe Ibrahimin (a.s.), e respektojnë në kulm, por assesi nuk e përvetësojnë as atë për ta ngritur prejardhjen racore në pedestal. Ibrahim (a.s.), respektohet jo për prejardhjen e tij, por për detyrën dhe misionin e tij pejgamberik, shtyllë pejgamberike (ulu'l-azm), prototip i njeriut që lufton për të vërtetën vetvetiu, duke dëgjuar Zotin, shpirtin dhe zemrën e tij.

Kjo është një ndër arsytet përse Muhamedi (a.s.), në fillim të pejgamberisë së tij, gjatë namazit kthehej në drejtim të Jeruzalemit. Ky fakt është vërtetim i vazhdimësisë pejgamberike dhe prova më e mirë se Islami është i lashtë duke filluar me profetin dhe njeriun e parë Ademin (a.s.), dhe kulmi i tij vjen me përfundimin i ciklit profetik, që mbyllet me Muhamedin (a.s.).

Këtë e vërteton edhe çlirimi i Jeruzalemit në shekullin VII. Në atë kohë në qytet kishte vetëm të krishterë sepse hebrejntë, ishin dëbuar shumë herë nga romakët. Mys-

limanët u dhanë garanci të plotë të krishterëve në jetë, pasuri, lëvizje, shkollim, lutje e të tjera. Asnjë kishë nuk u tjetërsua nga myslimanët. *Xhamia El-Aksa* u ndërtua në vendin e shenjtë dhe të zbrazët, sepse më herët babilonasit patën rrënuar tempullin e Solomonit, kurse objektin tjetër të ndërtuar nga Herodi i madh në fillim të erës së re, e rrënuan ushtarët e Titusit në vitin 70 të erës së re.⁵

Me përjashtime të vogla, gjatë pushtimit kryqtar të Jeruzalemit dhe atij francez të Palestinës, parimi kuranor për vazhdimësinë fetare të banorëve të Jeruzalemit ishte themel i jetës shoqërore. Gjatë sundimit mysliman në Palestinë e Jeruzalem, vendi i shenjtë ishte i hapur për të gjitha fetë qiellore. Edhe hebrejntë, që ishin dëbuar qysh më herët, filluan të ktheheshin dhe të luteshin në mënyrën e tyre, para tempullit të ndërtuar nga Herodi, i quajtur *Muri i Vajtimit* (Wailing Wall), kurse të cilin myslimanët e ruajtën në tërësi. Pjesëtarët e të tri feve luteshin, ecnin nëpër rrugët e El-Aksasë, të lirë, të hareshëm, duke e respektuar njëri-tjetrin dhe duke ndërtuar të ardhmen.⁶

Së voni, në gjysmën e shekullit XX erdhi formimi i shtetit izraelit në dëm të Palestinës dhe myslimanëve. Dy dekada më vonë, më 1967, Izraeli e pushtoi qendrën e Jeruzalemit. Ndërkohë të krishterët i vizitonin vendet e tyre të shenjta, myslimanët e atyshëm vetëm pjesërisht mund ta bënin këtë, kurse myslimanët nga e gjithë bota nuk mund të bëjnë asnjë lloj vizite në këtë qendër fetare. Madje, shteti izraelit edhe me ligj e ka shpallur Jeruzalemin si kryeqendër hebreje dhe ka ndaluar që ai t'u kthehet myslimanëve, duke kthyer kështu idenë e tyre të vjetër, pra të drejtën ekskluzive që ata paskan, mbi këtë vend të shenjtë duke mos e parë si një qytet universal, të lirë për të tri fetë monoteiste: Hebraizmin, Krishtërimin dhe Islamin.

Le të shpresojmë se qyteti i Jeruzalemit një ditë, megjithatë, do të jetë i përbashkët për të tri fetë, për të gjithë popujt, sepse emri i tij *El-Kuds* (*I Shenjtë*), nuk mund të bëhet pronë e askujt. Na duket se Perëndimi, që për dekada e ka përkrahur këtë kryeneçësi izraelite, i takon ta marrë nismën për një Jeruzalem të lirë, të qetë, shembull për të gjithën botën.⁷

Në fund, mund të themi se autori ia ka arritur qëllimit me temën e shtruar. Libri është i qartë, i argumentuar me prova fetare, historike, por edhe logjike. Edhe përkthyesi e ka kryer punën e tij shkëlqyeshëm, duke arritur që të gjitha porositë e librit t'i përcjellë në mënyrë korrekte për të gjitha shtresat e lexuesve. Me këtë rast, e përgëzoj atë, botuesin dhe të gjithë stafin që mori pjesë në përgatitjen e librit.

5. Sipas: [http://en.wikipedia.org/wiki/Old_City_\(Jerusalem\)](http://en.wikipedia.org/wiki/Old_City_(Jerusalem)); <http://www.dzemat-oberhausen.de/index.php/tekstovi/politika-i-drustvo/339-pogled-na-Jeruzalem-muhammed-asad>.

6. http://en.wikipedia.org/wiki/Western_Wall.

7. Gjerësisht për Jeruzalemin: Nerkez Smailagic, Leksikon islama, Sarejevo, 1990, fq. 294-299.

3. D. W. O'Connor, po aty.

4. W. Denny, al-Kuds, në: Enciklopedija zivih religija, po aty, fq. 397-398; <http://www.dzemat-oberhausen.de/index.php/tekstovi/politika-i-drustvo/339-pogled-na-Jeruzalem-muhammed-asad>.

Kush është më me fat?

Nuredin Jëldëz

Le të shohim pak brezin e parë...

Ata jetuan si njerëz të atyre viteve të famshme që i di gjithkush. Klima ishte e egër, të digjte e të për-vëlonte. Ujë nuk kishte sa për t'u ngopur dhe çezma e ujit nuk ishte parë ndonjëherë. Veshja ishte sa për t'u mbuluar. Siguri nuk kishte dhe asnjë vrasësi nuk i kërkoheshin llogari. Të ishte besimtar, duhej të merrje parasysh gjithçka. Pa marrë parasysh torturat, emigrimin, urinë, xhihadin, martirizimin, sakatllëkun etj., nuk ishte e mundur të bëheshe besimtar. Puna ishte e rëndë, detyra e vështirë, mundësitë zero dhe armiku i fuqishëm. Nuk kishte as sexhade; çakulli dhe rëra konsideroheshin të tilla.

Kurani po zbritej, nuk kishte as letër dhe as laps që të shkruhej. Nuk kishte vend për të mësuar fëmijët. Ishte vetëm Sufja. Ata që duronin dhe qëndronin aty, mund të mësonin diçka. Nuk kishte mundësi as të mblidheshin të gjithë së bashku në një vend për të dëgjuar diçka prej Pejgamberit (a.s.) dhe për t'ua mësuar të tjerëve. Ai që e dëgjonte një hadith, nuk e dëgjonte hadithin tjetër. S'kishin as mundësinë të merrnin shënime dhe t'i përsërisnin të gjithë së bashku. Shumë prej tyre, edhe Kuranin nuk arritën ta shihnin të mble-

dhur
në një
mus'haf (libër) të vetëm.

E megjithatë, ai brez që besoi dhe jetoi si besimtar, pavarësisht vështirësive dhe mangësive që vinin për shkak se ishte brezi i parë, shfaqti një tablo besimi të mahnitshme.

A menduan ta linin përgjysmë dhe të hiqnin dorë për shkak të vështirësive që kishin? Apo korrën rastin e të qenit brezi i parë, për të qëndruar pranë Pejgamberit (a.s.)? A këta ishin me fat?

Të shohim njëherë edhe brezin e teknologjisë. Bota u është servitur përpara, duke u zvogëluar aq sa qëndron në majë të gishtave të tyre. Në dorë kanë mundësi aq të mëdha, saqë e gjithë dija e mbledhur ndër shekuj, u vjen përpara me një të shtypur të butonit. Kush dëshiron të mësojë, çdo gjë e ka gati para hundës, që nga librat e deri tek mjetet e dixhitalizuara të mësimit. Xhamitë janë me kondicionerë, tapetet të butë e të rehatshëm, dritaret me perde, vendet e abdesit si ujëvarë, sistemi i zërit i mrekullueshëm, ezani thirret e dëgjohet kudo, imami dhe muezini me rrogë, medresetë dhe kurset e fesë janë përhapur kudo.

Në haxh e umre shkohet me aeroplan, qëndrohet në hotele luksoze dhe lëvizet me mjete të rehatshme. Kush dëshiron të mbajë agjërim në Ramazan, është nën kontrollin e mjekut, e ka të lehtë të shkojë në Bedër, hurmat i ha vetëm në iftar, sa për t'i shijuar dhe agjëron me sofrat e mbushura plot e përplot, aq sa ato që nuk konsumohen janë më tepër se ato që kon-



su-
mohen.

Pothuajse çdo fshat ka xhami dhe hoxhë. Jetohet nëpër shtëpi të mbushura plot me libra, si biblioteka. Ka më tepër siguri dhe jeta është e qëndrueshme e jo endacake. Ndërsa ndërtesat e larta që ngrihen drejt qiellit, janë vendbanimi i tyre. Pra, të mirat e Allahut nuk numërohen.

Padyshim se edhe ky brez ka vështirësitë e veta. Natyra ka humbur virgjërinë e saj, ushqimet nuk janë të natyrshme, kriza shpirtërore është e thellë, marrëdhëniet ndërnjerëzore janë dëmtuar së tepërmi, familja është shkatërruar, xhemati është përçarë, kalifat nuk ka, ndërsa kamata dhe zinaja kanë marrë dhenë. Në këtë brez ka aq shumë vështirësi, sa ç'ka edhe lehtësi.

Por cila është përgjigja e pyetjes, se cili prej këtyre dy brezave është më me fat?

Përgjigja më e shkurtër dhe më e qartë, është:

Që prej Ademit (a.s.), asnjë brez dhe asnjë njeri nuk është më me fat apo më pa fat se tjetri. Kjo, sepse Allahu Teala, të gjithë njerëzit, që prej të parit e deri tek i fundit i thërret me të njëjtat kushte dhe në të njëjtin xhenet. Nëse një brezi nuk i jep të njëjtat mundësi me brezin tjetër, do të thotë se nuk i ka lënë robërit e Vet të garojnë me të njëjtat të drejta. Dhe kjo, nuk është punë prej Tij. Kur shohim prej së largu, themi: "Sa me fat ai sahabi që e ka parë Pejgamberin (a.s.)!". Mirëpo, ka shumë edhe prej atyre që e kanë parë Pejgamberin (a.s.) dhe do të jenë në

zjarrin e xhehenemit. Them, se ta shohësh Profetin (a.s.), është vetëm një pjesë e mundësisë. Është njësoj si sot, kur nuk mund të themi: "O sa mirë, të gjithë do të bëhen dijetarë, sepse kanë kompjuter". Por kompjuteri nuk e shtoi as forcën dhe as shpejtësinë e besimit dhe veprës. Çdo gjë vjen së bashku me të keqen e saj.

Asnjë kohë dhe asnjë vend nuk është një mundësi e pakufishme. Përkundrazi, të gjitha kohët dhe vendet, kanë vlerë aq sa arrihet të përfitohet prej tyre. Nëse je i aftë, është e mundur të bëhesh një Asije në pallatin e Faraonit dhe të lavdërohesh në Kuran. Njësoj si ç'është e mundur të bëhesh edhe një trung xhehenemi, si Ebu Xhehli në rrëzë të Qabesë.

Në vend që të vrasim mendjen për kohën dhe vendet, duhet të përparojmë duke shtuar entuziazmin dhe përpjekjet tona.

Nuk jemi as me fat dhe as pafat. Jemi vetëm në provë. Dhe prova gjithmonë është e njëjtë. Vetëm se vendi i pyetjeve dhe rendi i përgjigjeve ka ndryshuar. Por pyetja është po ajo: "Të bëhesh mik me Zotin apo shok me shejtanin?"



Të dashuruar pas Parajsës

Altin Torba

- pjesa e parë -

PËRKUFIZIMI I XHENETIT- PARAJSËS

Xheneti:

Është streha dhe vendbanimi i atyre që adhurojnë vetëm Allahun dhe nuk i shoqërojnë Atij asgjë dhe askënd; që kanë frikë vetëm Allahun dhe që i luten drejtpërsëdrejti vetëm Atij, sepse e dinë se Allahu i Plotfuqishëm që është Zotëruesi i cilësive të përsosura dhe absolute nuk ka nevojë për ndërmjetësues dhe as për ortak apo ndihmues.

Është vendbanimi i atyre që e besuan Kuranin, fjalën e Allahut dhe e besuan Muhamedin (a.s.), të Dërguarin e Allahut, e përqafuan Islamin, bindjen e vetme të pranueshme tek Allahu dhe duke iu nënshtruar Allahut me zemrën, gjuhën dhe gjymtyrët e tyre shpresuan në Xhenetin, shpërblimin kulmor të Allahut, Zotit të tyre.

Është vendqëndrimi i besimtarëve të vërtetë dhe të devotshëm, që zbatojnë urdhrat e Allahut dhe të Profetit të Tij, si dhe qëndrojnë larg ndalesave që ua ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij.

Është vendshpërblimi i robërve dhe adhuruesve të pastër dhe të singertë të Allahut.

Është streha e prehjes dhe e drejtësisë për ata që, duke qenë se kanë frikë drejtësinë e Allahut, u binden

urdhrave dhe kushtetutës së drejtë hyjnore të Allahut.

Është streha e denjë e shpërblimit për besnikët që iu betuan dhe ia dhanë besën Allahut, në rrugën e Tij dhe për të fituar kënaqësinë e Tij.

Është shpërblimi i garantuar për ata që sakrifkuan me pasurinë, jetën e tyre dhe gjithçka patën, që fjala Allah të zinte vendin e vet të merituar në botën e njerëzve, ashtu siç e ka zënë në mbarë universin.

Është vendprehja e atyre që pendohen dhe kthehen sinqerisht te Zoti i tyre pas gabimit.

Është vendshpërblimi për ata që me zemrat, gjuhët dhe veprat e tyre e falënderojnë Allahun e Lartësuar për mirësitë e panumërta, të cilat ia dedikojnë vetëm mëshirës së pakufi të Allahut, Zotit të tyre.

Është shpërblimi që iu premtua atyre që ballin e tyre fisnik dhe të ndershëm e përlulën në tokë duke madhëruar vetëm Allahun.

Është vendi për të cilin punuan dhe u shpërblyen ata që urdhëruan në të mirë dhe ndaluan nga e keqja.

Allahu i Lartësuar flet në mënyrë të hollësishtme në librin e Tij, në Kuranin Fisnik për Xhenetin, lumturinë në të, lumenjtë e tij, kopshtet dhe pemët plot fruta, ushqimin e tij, pijet, veshjet, banesat e mrekullueshme, stolitë e tij, vashat e tij dhe përmend se lumturia e ba-

norëve të Xhenetit as që mund të gjejë një shkallë sado të vogël krahasimi me lumturinë e më të pasurve dhe më të lumturve të kësaj bote.

Në lidhje me ligjësitë e mrekullueshme me të cilat Allahu i Lartësuar e ka pajisur Xhenetin, për të kënaqur dhe lumturuar në të robërit e Tij të singertë, ashtu siç i ka hije Krijuesit të Drejtë dhe të Plotfuqishëm, në lidhje me këtë Kurani, fjala e Allahut të Lartësuar, thotë:

“Askush nuk di (nuk imagjiron dot) për atë kënaqësi (të zemrës e shpirtit) që u është përgatitur atyre (banorëve të Xhenetit) në shpërblim të asaj çka ata punuan (në dynja).” (Sexhde,17).

Ndërsa i Dërguari i Allahut, Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, transmeton se Allahu i Lartësuar në një thënie të shenjtë thotë:

“Kam përgatitur (në Xhenet) për robërit e Mi të singertë çka syri nuk e ka parë, as veshi s’e ka dëgjuar dhe as zemra s’e ka ndjerë (imagjinuar dhe përjetuar prej mrekullive, bukurive, fjalëve dhe emocioneve të pashlyeshme)”. (Buhariu dhe Muslimi)

Të nderuarit e mi!

Njohja e përkufizimit të diçkaje është shumë e rëndësishme, pasi sa më shumë njohje të kemi për diçka, aq më tepër do të qartësohet ideja dhe vlerësimi për të...

E pra:

Le të përpiqemi ta njohim sa më mirë Xhenetin dhe të eksplorojmë sa më shumë rreth tij... të mendojmë sa më shumë për të dhe të jemi sa më në kontakt me informacionin e besueshëm që hedh dritë rreth çdo detaji lidhur me të... me qëllim që zemra jonë të lidhet sa më ngushtë me të, të ideojë dhe projektojë për të... dhe për të argumentuar dhe konkretizuar me vepra, aspiratën tonë që një ditë të jemi prej banorëve të tij...

TRYEZA PARAJSCORE

Profeti Muhamed, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, nëpërmjet ëndrrës profetike përcjell se është gjendur në mesin e një grupi engjëjsh, ndër të cilët Xhebrailin që i rrinte nga ana e kokës dhe Mikailin nga këmbët dhe njëri prej këtyre të dyve i ka thënë tjetrit: “Jepi atij një shembull!” Me këtë rast i është thënë:

“Shembulli yt dhe shembulli i kombit tënd është si shembulli i një mbreti që ka bërë të tijën një qendër, ku ka ndërtuar një rezidencë dhe në të ka shtruar një tryezë; ka nisur tek njerëzit edhe një lajmës. Pati prej

njerëzve që e pranuan ftesën, e pati që e lanë atë. Sa për mbretin, ai është Allahu; qendra është Islami; rezidenca është Parajsa ndërsa ti je Lajmësi. Kush të bindet ty, ka hyrë në Islam; kush hyn në Islam, hyn në Parajsë dhe kush hyn në Parajsë, ha nga çfarë ka në të... Kush i bindet Muhamedit, i është bindur Allahut dhe kush i kundërvihet Muhamedit i është kundërvënë Allahut... Kush të pason ty, hyn në Parajsë dhe kush nuk të pason ndëshkohet me një ndëshkim të rreptë...”

Të nderuar vëllezër dhe motra! Siç u pa qartë nga Zbulesa Hyjnore në fjalë, dynjaja është lënë jashtë suazave të këtij aforizmi dhe kjo, sepse njeriu nuk u krijua për dynjanë, por siç janë shprehur të parët tanë të singertë:

Dynjaja u krijua për njeriun, teksa njeriu u krijua për Amëshimin.

PRIORITETI SUPERIOR

Njeriu i mençur i vendos prioritetet e tij duke pasur parasysh realitetet dhe vlerat reale të synuara...

Kështu, njeriu midis dy punëve që i ofrohen, patjetër që zgjedh atë më të vlerësuarën dhe më të shpërblyerën, edhe nëse ajo do kërkojë mund më të madh; aq më tepër kur bëhet fjalë për realitete që janë vërtet në disproporcion dhe disvlerësim të pakrahasueshëm...

Prioriteti për të cilin po duam të bëjmë fjalë është ai **“dynja-amëshim”**;

dhe për të hedhur dritë mbi të, vëllezër dhe motra, le të reflektojmë së bashku.

REALITETI DHE VLERA E DYNJASË KARSHI BOTËS TJETËR XHENETIT:

Ky realitet vlerash na zbulohet nga më Eminentit dhe më i Predispozuarit për të folur mbi një gjë të tillë, nga i Dërguari i Allahut, Muhamedi, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, që pikërisht lidhur me këtë fakt thotë:

“Sillet në ditën e gjykimit njeriu që ka pasur më shumë mirësi në dynja e që është nga banorët e Zjarrit (të Xhehenemit). Zhytet tej e tej në Zjarr. Pastaj i thuhet: ‘O biri i Ademit! A ke parë ndonjëherë mirë? A të ka ndodhur ndonjë mirësi ndonjëherë prej herësh?’ Thotë: ‘Jo betohem për Allahun (betohem në Ty) o Zoti im.”

Dhe sillet njeriu që ka pasur më shumë vuajtje,



(mundime apo dhimbje) **në dynja e që është nga banorët e Xhenetit. E futet tej e tej në Xhenet. E i thuhet: 'O biri i Ademit! A ke parë ndonjë herë vuajtje, (mundime apo dhimbje)? A të ka ndodhur ndonjë fatkeqësi a vështirësi ndonjë herë prej herësh?' Thotë: 'Jo betohem për Allahun (betohem në Ty) o Zoti im. Nuk më kanë ndodhur vuajtje (mundime apo dhimbje) kurrë, dhe kurrë nuk kam parë fatkeqësi a vështirësi.'** (Muslimi)

Ky është Prioriteti Superior që na fton të mendojmë thellë...

Një moment, vetëm një moment, dhe mirësitë më të mëdha të dynjasë apo të këqijat më të skajshme të saj harrohen, për t'u lënë vendin atyre të Amëshimit...

RRUGËTIMI PËR NË PARAJSË

Të nderuarit e mi!

Të gjithë e dimë se që të duash diçka, nuk mjafton për ta arritur atë.

Për të arritur në destinacion, duhet zbatuar pikë për pikë udhëzimi i të Dërguarit...

Askush nuk është më kompetent se kurora e profetëve, Profeti Muhamed, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, për të na orientuar dhe treguar lidhur me Itinerarin madhështor që ka për destinacion Parajsën e Begatë...

Pikërisht mbi **Itinerarin për në Parajsë** Muadh ibn Xhebel e pyet Profetin Muhamed, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, duke i thënë:

- O i Dërguar i Allahut! Tregomë për një punë që më fut në Xhenet dhe më largon nga Zjarri?

I Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, iu përgjigj:

"Ke ardhur të pyesësh për një çështje madhore, porse që është vërtet e lehtë për kë ia lehtëson Allahu i Lartësuar."

Profeti (Paqja qoftë mbi të!) vijoi: *"Përgjigjja për pyetjen tënde është: Ta adhurosh Allahun duke mos i bërë shok, ta kryesh Namazin, ta japësh Zekatin, ta agjërosh Ramazanin dhe ta bësh Haxhin në Qabe."*

Profeti (Paqja qoftë mbi të!), vijoi: *"A do që të të orientoj për dyert e mirësisë? Agjërimi (vullnetar) është mburojë; lëmosha e shuan mëkatin ashtu si uji zjarrin; është edhe namazi i natës, - pastaj lexoi fjalën e Allahut të Madhëruar: **"Trupat e tyre i ngrenë nga shtratet** (për t'u falur gjatë natës), **duke e lutur Zotin e tyre me***

frikë dhe shpresë e nga ajo (pasuria) që Ne u kemi dhënë, ata japin. Askush nuk di për kënaqësinë pa-more (që mrekullon zemrën dhe shpirtin) e cila u është surprizuar atyre si shpërblim për atë që punuan." (Sexhde, 16-17)

Profeti (Paqja qoftë mbi të!), vijoi: *"A do të të tregoj mbi kreun e çështjes, themelin e saj dhe kulmin e ngrehinës së saj?"*

I thashë: *"Si jo, o i Dërguari i Allahut!"*

Tha: *"Kreu i çështjes është Islami, themeli i saj është namazi dhe kulmi i ngrehinës së saj është Xhihadi"*

Profeti (Paqja qoftë mbi të!), vijoi: *"A do të të tregoj se si arrihet e gjithë kjo?"*

I thashë: *"Si jo, o i Dërguari i Allahut!"*

Kapi gjuhën e tij dhe tha: *"Përmbaje këtë!"*

I thashë: *"O i Dërguari i Allahut, a do na merret për bazë ajo çfarë flasim?"*

Tha: *"Mjerë për nënën tënde kur të jetë në zi për ty! A ka për t'i përmbysur njerëzit në zjarr mbi fytyrat e mbi hundët e tyre gjithë tjetër veç të vjelave të gjuhëve të tyre."* (Tirmidhiu)

Itinerari për Parajsë është i qartë.

Rruga fillon me obligimet: adhurimi i kulluar e i distancuar nga çdo trajtë mikro dhe makro shok-bërje Allahut, falje e përqendruar, pasuri e pastruar me zekat, agjërim i përkushtuar, Qabja duhet vizituar jo vetëm nga trupi, por çështje më e rëndësishme nga shpirti yt.

Dhe vijon me: korsitë e mirësive, që të fusin në radhët e adhuresve vullnetarë, që jo vetëm agjërojnë Ramazanin, jo vetëm nga Zekati japin lëmoshë, por edhe që kur të tjerët flenë, ata Allahun e Madhëruar e kujtojnë me lot në sy e për mirësitë e tij nuk pushojnë së falënderuari e dëlirësuar Atë.

Kreu i këtij Itinerari mban emrin Islam, themeli i tij është namazi dhe kulmi i ngrehinës dhe finishit të tij është sakrifikimi i jetës në rrugë të Allahut.

Nga shenjat e të suksesshmit në këtë Itinerar është se ai e ka gjuhën e tij totalisht nën kontroll, pasi e di se fshehtësitë që gjenden thellë në zemër gjuha i reflektton.

Ky ishte Itinerari i Rrugëtimit për në Parajsë....

E lusim Allahun të jemi prej atyre që do e arrijmë Finishin e tij me sukses...



Dynjaja që i shërben së vërtetës, është fe

Muhamed El-Gazali

Çfarë do të thotë të preferosh ahiretin para dynjasë?

Me këtë pyetje tallen, materialistët dhe skllëvërit e jetës, të cilët zgjohen dhe ngrysen e nuk njohin vetëm ditën e tyre dhe të nesërmen që do të gdhijë. Kështu që, ata përgjigjen: "Nuk e ndërroj të prekshmen me imagjinatën, refuzoj meditimën, përveç ç'ka në tokë dhe mbi të."

Kjo përgjigje, për të urtët është e gabuar dhe nuk ka aspak sens, dhe e shpie në shkatërrim!

Por ka edhe një përgjigje tjetër, që i përket një pjese të besimtarëve: "Jeta e dynjasë është e kotë dhe duhet të largohemi prej saj!"

Dua të qëndroj gjatë te kjo përgjigje! Çfarë do të thotë ta kalosh jetën pa u lartësuar me diçka prej saj? Krijuesi i kësaj bote ka thënë: "Njihni Emrat e Mi të Bukur dhe Cilësitë e Mia të Larta në shfaqjen e vendit e të kohës, si dhe në rrugëtimin e jetës e të njerëzve! Ju nuk do ta njihni Madhësitinë Time, në qoftë se ecni nga djepi deri në varr, të verbër ndaj argumenteve të Mia në tokë e në qiell, po ashtu edhe ndaj fateve në njerëz dhe popuj!"

Allahu është betuar në diell dhe në hënë, në natë dhe në ditë, në agim dhe në muzg, në fëmijë dhe në prind. Bile është betuar në atë që shikojmë dhe në atë që nuk shikojmë, sepse shikimi në sipërfaqe nuk të bën dobi pa shikimin në thellësi. Është betuar në erërat e forta dhe të lehta, në kuajt luftarakë, që nxjerrin shkëndija nga patkonjtë e tyre në betejat e përvetshme mes së drejtës dhe së kotës. Është betuar në të gjitha këto, që ta njohim Atë dhe të jetojmë në krenari e të përfitojmë nga mësimet e Tij.

Si mund të thotë: "Unë jam njohës i Allahut", ai që është injorant i jetës, i të fshehtave, i fuqive dhe thellësive të saj?

Disa njerëz e kalojnë jetën ashtu siç kalon pastruesi

i rrugëve përpara dyqaneve të floririt, pa i hedhur sytë nga stolitë dhe bizhuteritë, sepse nuk i intereson ajo punë; ose siç kalon punëtori me mëditje nëpër arat e mbjella e të mbushura me prodhim dhe plot fruta, që nuk mendon, përveç se të marrë vetëm shpërblimin e tij!

Kur mohuesit e ringjalljes pyetën: "Si do të ndodhë ringjallja?", erdhi përgjigja e Kuranit famëlartë: Thuaj: **"Udhëtoni nëpër Tokë dhe shikoni se si Ai e ka zënë fill krijimin. Pastaj do të jetë Allahu Ai që do të bëjë krijimin tjetër (ringjalljen). Me të vërtetë, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.** (Ankebut, 20)

Ecja nëpër tokë për studimin e jetës është rruga e besimit në Allah dhe e takimit me Të. Patjetër duhet të notojmë në dallgët e jetës dhe njohjes me rrymat e saj, baticës e zbaticës, me brigjet dhe shkaqet e mbytjes e të shpëtimit ...

Trashësia nuk është besim dhe injoranca nuk është devotshmëri. Eksperienca në jetë, aftësia për ta zotëruar atë dhe nënshtrimi i saj në shërbim të Zotit, është besim dhe punë e devotshme.

Sa e ulët është mendja e mpirë, mendimi i ngushtë dhe kultura e cekët! Ka popuj, të cilët i përkasin Kuranit, dhe nuk e dinë se ai është libër jete, nuk përfitojnë prej universit, përveç ashtu siç përfiton i verbëri nga rrezet e diellit. Sa herë që njerëz të tillë i kam takuar në fushat e thirrjes, më ngushtohej fryma dhe më vinte keq për fenë dhe të ardhmen e saj, për shkak të injorancës së tyre të thellë, apo asketizmit të tyre të ftohtë!!

Thashë: "Do të ketë pasur një arsye që dëshmitarët e Njësimi të Allahut të jenë engjëjt dhe njerëzit e ditur."

Përktheu
Lavdrim Hamja

1. Shiko ajetin 18 të sures Ali Imran (L.H)



Mubamedi (a.s.), mësues i përbershëm

Ma. Orhan Bisilmaj

Allahu i Madhëruar në Kuran ka thënë: **“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”.** (Ahzab, 21). Ky ajet vjen si një mësim prej Allahut të Madhëruar se pasimi i shëmbëlltyrës së Muhamedit (a.s.), është rruga më e mirë e secilit besimtar.

Në të vërtetë, kjo fjalë e Allahut ka zbritur në kontekstin e luftës së Hendekut, e cila konsiderohet si njëra prej betejave që pati shkaktuar shumë ankth, se sa pasoja. Politesitët arabë, të bashkuar nga shumë fise: kurejshët, gatafanët etj., patën organizuar një ushtri prej më se dhjetë mijë forcash, për ta sulmuar bashkësinë myslimane në Medinë me në krye Pejgamberin (a.s.). Kur e rrethuan Medinën, atyre iu bashkuan edhe jahudinjtë e Medinës, me të cilët Pejgamberi (a.s.), kishte lidhur marrëveshjen e paqes. Ky fakt e bënte gjendjen akoma më të rëndë, sepse Pejgamberi (a.s.), rrezikohej në dy fronte, si nga brenda ashtu edhe nga jashtë. Ishte moment shumë i vështirë për Pejgamberin (a.s.) dhe sprovë për besimtarët, sepse armiku ishte shumë i madh në numër ndërsa ushtria myslimane numëronte jo më shumë se tri mijë forca. Allahu shprehet në lidhje me këtë ngjarje në Kuran: **“Aty besimtarët u vunë në provë dhe u tronditën si nga një tronditje e fuqishme.”** (Ahzab, 11). Pejgamberi (a.s.), brengosej shumë për ndonjë disfatë të mundshme në këtë betejë, për arsye se nuk mund ta imagjinonte që edhe një herë të bënte hixhret, kësaj radhe prej Medinës. Jo se u druhej vështirësive të hixhretit, por dilemave se ku mund të shkonte, ngase nuk shihte ndonjë vend më të përshtatshëm pas Mekës dhe Medinës. Në këtë gjendje të vështirë, Allahu i premtoi Pejgamberit (a.s.), se do ta ndihmonte edhe në këtë betejë. Këtë premtim Pejgamberi (a.s.), ua konfirmoi shokëve të tij. Por, ç’ë do që besimtarët e luhatur nuk i besuan lajmit të mirë që solli Pejgamberi (a.s.).

Këtu fillon shkaku i zbritjes së këtij ajeti. Besimtarët e sinqertë i besuan premtimit të Pejgamberit (a.s.), por

munafikët e humbën besimin në Pejgamberin (a.s.) dhe thoshin: **“Allahu dhe i Dërguari i Tij nuk na kanë premtuar asgjë, pos mashtrimit!”** (Ahzab, 12). Rrjedhimisht, ata filluan të kërkonin formalisht leje nga Pejgamberi (a.s.), që t’i lironte nga lufta. Pejgamberi (a.s.), i liroi, sepse e dinte që u dha apo s’u dha leje, ata nuk do të luftonin. Në lidhje me çështjen e munafikëve, Allahu e informoi Pejgamberin (a.s.), se ata më shumë do të dëshironin të ishin beduinë, e të jetonin nëpër shkretëtira dhe prej atje të pyesnin për çështjen e myslimanëve, se sa të ishin në Medinën e begatshme.

Por ideja e munafikëve se Pejgamberi (a.s.), do të humbiste në këtë luftë nuk doli e saktë, sepse premtimi i Allahut ishte i vërtetë. Me propozim të Selman Farisiut, dhe me caktimin të Zotit, Pejgamberi (a.s.), urdhëroi hapjen e Hendekut rreth e përçark Medinës. Pala armike qëndroi për disa ditë përreth qytetit, duke tentuar të depërtonte në brendësi. Çdo tentim ishte i kotë, sepse premtimi i Allahut për ta ndihmuar Pejgamberin (a.s.), ishte i padiskutueshëm. Allahu i ndihmoi me një ushtri, që thuhet se ishin engjëjt, të cilët i frikësuan ushtarët e armikut dhe ndihmuan ushtrinë myslimane. Kështu që në një natë, kur ishte errësirë e thellë, Allahu lëshoi një erë të madhe, të stuhishme e të ftohtë, ua shuan zjarret, ua rrënon çadrat, ua shtie frikën në shpirt, dhe idhujtarët e lëshojnë rrethimin e Medinës dhe largohen. Në anën tjetër, myslimanët shpëtojnë pa asnjë pasojë të theksuar.

PEJGAMBERI (A.S.), SHËMBËLLTYRË UNIKALE

Gjatë hapjes së hendekut, Pejgamberi (a.s.), ishte angazhuar maksimalisht dhe punonte më shumë se të tjerët. Përveç kësaj, ai asnjëherë nuk u lig kundrejt numrit të madh të armikut. Paragjykimet e munafikëve, kinse Pejgamberi (a.s.), i ka mashtruar kur u ka thënë se në këtë

betejë do të kishin ndihmën e Allahut, u shuan bashkë me përpjekjet e idhujtarëve mekas për ta pushtuar Medinën e ndritshme. Gjithçka doli në shesh. U vërtetua premtimi i Pejgamberit (a.s.), po ashtu u mor vesh munafikllëku i atyre që nuk donin të ishin pasues të rrugës së Resulullahut (s.a.v.s.). Dhe Allahu thotë: **“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut...”** (Ahzab, 21), duke ua bërë të qartë sidomos munafikëve se Pejgamberi (a.s.), është ai që e ka mbajtur fjalën e dhënë për ndihmën e Allahut. Por, ky shembull, thotë Allahu i Madhëruar, është për atë: **“...që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun”** (Ahzab, 21). E këta ishin sahabët (r.a.), besnikët e Resulullahut (a.s.), të cilët qenë në gjendje ta mbronin Medinën dhe rrugën e Islamit, pavarësisht çmimit që duhej paguar. Këta burra ishin nxënës të vërtetë të mësimave të Kuranit – Fjalës së Allahut dhe udhëzimeve të Resulullahut (a.s.). Nuk u dobësuan për asnjë moment dhe as nuk dyshuan në pejgamberinë e Muhamedit (a.s.).

Prandaj, kushdo që nuk dyshon në pejgamberinë e Muhamedit (a.s.), e merr atë për mësues, ndërsa veten e tij e konsideron nxënës të përgjeshëm të mësimave të tij. Jo pse këtë dëshirojmë ta themi ne, porse ka dashur Allahu që personaliteti i Muhamedit (a.s.), të mbetet model i secilit që dëshiron ta shohë veten e vet të edukuar, të arsimuar, punëtor dhe mbi të gjitha, një njeri me të cilin Allahu është i kënaqur. Sepse formimi i personalitetit të Pejgamberit (a.s.), ka ndodhur nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë të Allahut nga periudha para se të lindte Muhamedi (s.a.v.s.) dhe deri në fund të jetës së tij.

Nëse e vështrojmë jetën e Pejgamberit (a.s.), e shohim se ai ka kaluar pothuajse në të gjitha sfidat e jetës, me të cilat përballen shtresat e ndryshme të shoqërisë njerëzore. Së pari, ai mbeti jetim që në fëmijërinë e hershme dhe nga ky aspekt ai është model për të gjithë fëmijët jetimë. Pejgamberi (a.s.), ishte punëtor dhe ushtroi profesionin e tregtisë, ishte bashkëshort, prind, udhëheqës i shtetit dhe në të gjitha aspektet mbetet mësues i përgjeshëm i secilit që dëshiron të shkojë shtigjeve të tij. Personaliteti i tij karakterizohej me virtytet e moralit të përsosur. Zemërgjerësia, bujaria, sinqeriteti, besnikëria, burrëria, zgjuarsia, qëndrueshmëria, solidariteti, puna, trimëria, ndihma dhe çdo cilësi tjetër e mirë, ishin tipar i personalitetit të Muhamedit (a.s.). Këto tipare ia pranuan dhe ata që nuk e besuan pejgamberinë e tij. Në anën tjetër, cilësitë e këqija, siç janë koprracia, tradhtia, gënjeshtria, mashtrimi etj., jo vetëm nuk ishin pjesë e personalitetit shembullor të Pejgamberit (a.s.), por ai urdhëroi që çdo besimtar të largohej prej tyre. Nuk mund të mos e përmendim devotshmërinë e tij, e cila nuk mund të për-

shkruhet. Edhe pse ishte i Dërguar i Allahut dhe Allahu ia pati premtuar faljen e mëkateve të kaluara dhe të ardhme, sërisht, ibadeti i Pejgamberit (a.s.), ndaj Allahut ishte i jashtëzakonshëm.

Përveçse me shëmbëlltyrën e tij praktike, Pejgamberi (a.s.), ka këshilluar për çdo aspekt të jetës me udhëzime konkrete. Për shembull, ai na mëson se si ta adhurojmë Allahun, si ta duam Islamin, si ta duam Kuranin, si ta duam Pejgamberin, si t'i nderojmë prindërit, si të sillemi me veten tonë. Ai na udhëzon ta ruajmë jetën dhe shëndetin; të lexojmë dhe të mësojmë; të studiojmë dhe të punojmë. Ai i ka mësuar prindërit të kujdesen për fëmijët e tyre, t'i edukojnë ata me edukatë islame. E ka mësuar punëtorin të punojë me nder dhe me sinqeritet në punën e tij. E ka mësuar burrin si të sillet me bashkëshorten e tij dhe e ka mësuar bashkëshorten ta ruajë nderin dhe dinjitetin e burrit. E ka mësuar njeriun të jetë i sinqertë ndaj shokut; e ka mësuar tregtarin të bëjë tregti të ndershme dhe të fitojë me hallall; e ka mësuar udhëheqësin e shtetit të qeverisë me drejtësi dhe t'i frikësohet Allahut etj. Ky është Pejgamberi (a.s.), për të cilin Allahu ka thënë:


“Ju e kishit shembullin më të lartë në të Dërguarin e Allahut...” (Ahzab, 21).

PEJGAMBERI (A.S.), MËSUES I MËSUESVE

Pa dyshim, myslimani i sinqertë është nxënës i përgjeshëm i Resulullahut (a.s.).

Në të vërtetë, besimtari që e pason Pejgamberin (a.s.), është bërë nxënës i mësimave të Allahut. Sepse Allahu e ka mësuar Pejgamberin (a.s.), nga aspekti i fjalëve, sjelljeve, veprave, pëlqimeve të tij dhe nuk e ka lënë të gabojë.

Pejgamberi (a.s.), është shembull unikal, sepse ka jetuar nën vëzhgimin e drejtpërdrejtë të Allahut. Ai është i pazëvendësueshëm dhe mësuesi i vërtetë e i përgjithmonshëm i myslimanëve të sinqertë. Sukseset e Pejgamberit (a.s.), në predikimin e fesë islame, sukseset e tij në konsolidimin e bashkësisë së parë islame, transformimet pozitive shoqërore, formimi i shtetit islam, vendosja e rendit shoqëror, respektimi maksimal i të drejtave njerëzore etj., nuk kanë qenë një rastësi e zakonshme. Jo, ato kanë ndodhur falë urtësisë dhe mençurisë së Pejgamberit (a.s.), si rezultat reflektiv i udhëzimit të Allahut. Këto arritje dhe shumë e shumë të tjera, që konsiderohen themeltare për arritjet e përgjithshme të njerëzimit në përgjithësi, kanë qenë frymëzimi kryesor, që Majkëll Hart (Michael H. Hart), shkencëtar jomysliman, ta vendosë emrin e Pejgamberit (a.s.), të parin në librin e tij *“Njëqind personalitet më me ndikim në historinë e njerëzimit”*. Renditjen e njëqind personave nuk e ka bërë sipas parimit historik, por sipas parimit të ndikimit në shoqëri. Kështu, pas Muhamedit (a.s.),



pasojnë Isak Njutoni, Jezu Krishti (Isai a.s.), Buda, Konfuci dhe të tjerë me radhë.¹ Me këtë gjest, ky shkencëtar, në mënyrë të sinqertë dhe realiste ka pranuar se Muhamedi (a.s.), është *mësuesi më i rëndësishëm i njerëzimit*. Këtë e them, sepse Pejgamberi (a.s.), nuk është renditur i pari për shkak të një zbulimi të caktuar, siç kanë bërë shumë shkencëtarë të tjerë të njohur, p.sh. Isak Njutoni, Albert Ajnshtani, Galileo Galilei etj. Këta shkencëtarë dhe shumë e shumë të tjerë kanë dhënë kontribut konkret dhe kontributi i tyre është determinues për arritjet më të reja në shkencë. Kundrejt tyre, Pejgamberi (a.s.), nuk ka zbuluar asgjë në mënyrë konkrete dhe të veçantë, sa të themi se autor i kësaj apo asaj vepre është Muhamedi (a.s.). Atëherë, çfarë ishte ajo që zbuloi Muhamedi (a.s.) e që ishte motiv kryesor për këtë studiues, që ai ta vendoste emrin e tij të parin nga njëqind të tjerë, për kontribut të jashtëzakonshëm për shoqërinë njerëzore në përgjithësi? Ajo që zbuloi Muhamedi (a.s.), është *"sistemi mbi edukimin e mirëfilltë të njeriut"* e që bazohet në doktrinën e besimit islam. As më pak e as më shumë. Mbi këtë bazë, Muhamedi (a.s.), bëri kthesë të jashtëzakonshme në transformimin e shoqërisë. Ai nuk i ofroi shoqërisë ndonjë zbulim, siç i ofruan shkencëtarët pas tij, por ofroi një sistem të jetës së individit dhe shoqërisë, që bazohet në normat e moralit islam e që nuk ka të ngjasëm sot e kësaj dite.

Prandaj, myslimani i sinqertë është i bindur se modeli më i mirë i edukatës është vetëm shëmbëlltyra e Muhamedit (a.s.). Biografia e tij pejgamberike është një institut i llojit të vet, që jep leksione, mësim dhe dituri, por edhe kritika dhe vërejtje, jo vetëm për një kategori të shoqërisë njerëzore, por për të gjithë pa dallim, për myslimanin dhe jomyslimanin, dhe për të gjitha kategoritë dhe shtresat e shoqërisë. Këtë mund ta vërtetojë secili që dëshiron ta njohë jetëshkrimin e Pejgamberit (a.s.), ndërsa myslimanët e sinqertë, që janë ndjekës të rrugës së tij, veçse e kanë shijuar bereqetin e udhëzimeve të tij. Sa e sa dijetarë të mëdhenj islamë janë nxënës të Resulullahut (s.a.v.s.), duke filluar që nga koha e sahabëve dhe gjer më sot? Në çdo dije të tyre ata u referohen thënieve të Pejgamberit (a.s.) dhe myslimanët, falë kontributit shkencor të tyre, i pranojnë për dijetarë. Sahabët, shokët e Pejgamberit (a.s.), janë nxënësit e tij të parë. Ata i ka lavdëruar Allahu në Kuran dhe ka thënë se është i kënaqur me ta dhe ata janë të kënaqur me Allahun. (shih: Et-Tevbe, 100). Nuk i ka lavdëruar për ndonjë gjë, që ne nuk e dimë. Jo, të gjithë e dimë, i ka lavdëruar, sepse kanë qenë nxënës të shkëlqyeshëm të Pejgamberit (a.s.) dhe praktikues të devotshëm të udhëzimeve të tij. Dhe, meqë ishin të këtillë, ata u bënë shembull në sjellje, dije, kulturë, punë, moral, etj. Sot, ymeti islam i pason këta burra dhe ndjek shembullin e tyre.

Në këtë vijë të gjurmimit të rrugës së Resulullahit (s.a.v.s.), vijnë me radhë të gjithë dijetarët e mëdhenj brez pas brezi, Imam Ebu Hanife, Imam Maliku, Imam Shafi, Imam Hanbeli, kënaqësia e Allahut qoftë mbi të gjithë ata. Po ashtu, pas tyre vijnë me radhë dijetarët e mëvonshëm. Sa e sa prej dijetarëve islamë kanë kryer fakultete dhe kanë arritur gradat më të larta të dijes dhe shkencës, magjistraturë e doktoraturë. Por ata, kundrejt këtyre arritjeve akademike, e pranojnë se për nga aspekti i dijes mbeten gjithmonë nxënës të Resulullahut (s.a.v.s.). Asnjëherë nuk kam dëgjuar dikë të thotë se është më i ditur se Pejgamberi (a.s.). Absolutisht jo. Këtë nuk do ta thotë askush prej nesh asnjëherë. Nëse ata konsiderohen dijetarë të ymetit dhe janë të këtillë, ky nder për ta është në emër të të qenit të tyre nxënës të rrugës së Resulullahut (s.a.v.s.). Atëherë, a nuk është Pejgamberi (a.s.), mësues i mësuesve?

MYSLIMANI, NXËNËS I PEJGAMBERIT (A.S.)



Së këtejmi, besimtari i sinqertë, nëpërmjet shpjegimeve të dijetarëve të dëshmuar në dijen e tyre, i mëson dituritë fetare dhe i dëgjon këshillat e tyre. Ai shndërrohet në nxënës të dijetarëve islamë, përsëri për një arsye të vetme, sepse dijetarët në fjalë e kanë pike referimi rrugën e Resulullahut (s.a.v.s.), për të cilët Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve. Pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi, as dinarë e as dirhemë, por ata kanë lënë dijen, prandaj kush e merr atë, ka një fat të madh."* (Suneni i Tirmidhiut). E

sipas kësaj, edhe ky besimtar i sinqertë është nxënës i Resulullahut (s.a.v.s.).

Sot, kur po shkruajmë këto rreshta, na gëzon fakti se nxënës të Resulullahut (s.a.v.s.), në realitetin e botës islame janë brezi i ri. Kudo që shkojmë, në secilin institucion, pothuajse është e pamundur pa hasur në dikë që respekton me përpikmëri rrugën e Resulullahut (s.a.v.s.). Në mënyrë të vçantë, islami është sot imazh i studentëve në trojet tona shqiptare. Kjo është shpresëdhënëse dhe një lloj rilindjeje e re kombëtare. Jo në kuptim të afirmimit të Islamit, sepse Islami është tashmë i afirmuar dhe nuk ka nevojë për këtë, sidomos kur shohim depërtimin e tij në çdo cep të botës. Por në kuptim të afirmimit të vlerave të vërteta islame, për të cilat ka shumë nevojë kombi shqiptar në këto kohë, kur individ është në krizë të vlerave morale, ndërsa familja në krizë të zhbërjes përfundimtare të saj. Këta studentë, nxënës të udhëzimeve të Resulullahut (s.a.v.s.), në mos tjetër, me vetë shëmbëlltyrën e tyre prej individësh të edukuar dhe familjarë, do të jenë frymëzim për të gjithë. Dhe me të vërtetë janë, këtë e shohim çdo ditë.

*"Ata që i frikësohen Allahut,
kur u vjen ndonjë mendim i lig nga djalli,
i kujtojnë (urdhrat e Tij),
e atëherë e shohin rrugën e drejtë."*

(Araf, 201)

Lufta e vërtetë midis monoteizmit dhe politeizmit, së drejtës dhe së shtrembërës nuk ndodh jashtë, por në botën tonë të brendshme. Kurthet më të rrezikshme dhe dredhitë më dinake kurdisen në botën tonë të brendshme. Prandaj Pejgamberi (a.s.), mbas një beteje i këshilloi kështu: *"Mbaroi beteja e vogël, tani fillon beteja e madhe."* Ky transmetim aludon një të vërtetë të rëndësishme, që është lufta me vetveten. Nga ky këndvështrim, ndjeshmëria e brendshme e njeriut paraqet një rëndësi tepër të madhe, sepse triumfuesit e kësaj lufte janë të vetëdijshëm për një luftë të tillë.

Njeriu nuk duhet të harrojë asnjëherë që nefsi e nxit atë gjithmonë për keq. Është pikërisht nefsi që e zhyt njeriun në batakun e mosbindjes dhe kundërshtisë, duke e çuar drejt humbjes së plotë në këtë botë dhe tjetrën.

Nga ana tjetër, bota e brendshme e njeriut është vendi ku zhvillohen manifestimet që të çojnë tek e vërteta. Sepse Allahu na ka premtuar mbështetjen e Tij të plotë, duke na treguar shenjat e Tij brenda dhe jashtë nesh. Ky premtim realizohet kur ne i japim rëndësi botës së amëshuar dhe përpiqemi për krijimin e një atmosfere shpirtërore në brendësinë tonë. Prandaj ne duhet të përpiqemi të zbulojmë vetveten, për të nxjerrë prej aty thesaret e fshehura.

Ata që dëshirojnë të përhapin vlerat

hyjnore dhe të çrrënjosin intrigat dhe ngatërresat, duhet të fillojnë nga vetja e tyre. A nuk është kjo metoda profetike? Fatkeqësisht myslimanët shpesh janë indiferentë dhe neglizhentë ndaj asaj që ndodh në botën e tyre të brendshme. Nuk janë të vetëdijshëm që pjekuria shpirtërore kalon përmes një kontrolli të brendshëm. Fetë hyjnore i tërheqin vëmendjen njeriut për luftën e tij me nefsën dhe shejtanin. Në mënyrë që të mos bien në amulli dhe të mos tërhiqen zvarrë nga egoja dhe shejtani drejt xhehenemit, feja i kujton gjithmonë njeriut se kjo luftë do të vazhdojë deri Ditën e Kijametit.

Pejgamberët dhe ndjekësit e tyre janë shembujt e përkryer të vigjilencës ndaj këtij armiku të rrezikshëm. Kurani i urdhëron besimtarët të kenë të njëjtën vigjilencë, sepse ata që do të fitojnë Xhenetin janë pikërisht ata që frenojnë veten nga dëshirat dhe kënaqësitë e egos.

Njerëzit e devotshëm janë në gjendje vigjilence përballë çdo ngacmimi që vjen nga nefsi dhe shejtani. Në këtë mënyrë, ata e dallojnë menjëherë këtë armik tinzar. Ata vazhdimisht kontrollojnë pasqyrimin e zhvillimeve të jashtme në botën e brendshme të tyre, sepse e dinë se çdo lëvizje në botën e brendshme nuk është pa kuptim. Çdo zë dhe pëshpëritje që vjen nga brenda, përmban një mesazh që fton ose për mirë ose për keq.

Një Afet

Një Ajet

Ajeti kuranor që po trajtojmë na tregon se të devotshmit fitojnë një intuitë të mpreh-të për të njohur dhe dalluar të mirën nga e keqja. Pejgamberët, si në çdo çështje të jetës edhe në kontrollin e brendshëm kanë shërbyer si shembuj idealë. Vlen të përmendet rasti i Jusufit (a.s.), i cili gjeti strehim tek Allahu përballë kurtheve dhe joshjes së gruas së bukur të vezirit. Kur ajo e kërcënoi Jusufin (a.s.), me burgim, Jusufi (a.s.), megjithë kërcënimet e shumta gjeti mbështetje te lutja e sinqertë drejtuar Allahut: Ai tha: **“O Zoti im, më shumë e dua burgun se atë ku më shtynjë ato. Nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë do të prirem drejt tyre dhe do të bëhem nga ata që nuk (i) dinë (ligjet e Tua).”** (Jusuf, 31)

Jusufi (a.s.), e shpreh kështu luftën e tij me nefsën: **“Unë nuk e shfajësoj veten, sepse nefsi është fort i prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im. Me të vërtetë, Zoti im është Falës dhe Mëshirëplotë.”** (Jusuf, 53)

Në një vend tjetër, Kurani na prezanton Ejubin (a.s.), i cili me durimin që tregoi ndaj sëmundjeve u bë simbol i durimit. Ky profet, simbol i durimit, nga njëra anë duronte dhimbjet e sëmundjes, nga ana tjetër luftonte me shejtanin që përpiqej të mbillte tek ai farën e së keqes. Në këtë gjendje, iu drejtua Allahu me këto fjalë: **“Me të vërtetë, më ka goditur djalli me mundim dhe vuajtje!”** (Sad, 41)

Njeriu, ashtu siç mund të sprovohet me fatkeqësi, mund të sprovohet edhe me pasuri, shëndet, pozitë dhe famë. Sprova më tinëzare është sprova me pasuri dhe begati. Në lidhje me këtë sprovë, Kurani na jep dy shembuj, një pozitiv dhe një negativ.

Shembull i modelit negativ është Karuni, i cili me pasurinë e tij është bërë legjendë. Ai nuk i shikonte begatitë dhe pasurinë e madhe që zotëronte si një dhuratë të Allahut ndaj tij, por si produkt të aftësisë së tij individuale. Kurani e shpreh kështu, përmes gjuhës së Karunit këtë gjendje: **“Kjo më është dhënë vetëm prej diturisë sime”**. (Kasas, 78)

Kurse shembull pozitiv është Sulejmani (a.s.), i cili zotëronte mrekulli dhe pasuri, që nuk i kishte pasur asnjë Pejgamber. Kur Sulejmanit (a.s.), iu soll froni i mbretëreshës nga një vend i largët, sa e hap mbyll sytë reagimi i tij ishte ky: **“Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijtë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues.”** (Neml, 40)

Siç u vu re, Sulejmani (a.s.), e kuptoi me njëherë që pasuria është një sprovë. Allahu i Lartësuar mos na bëftë prej atyre që jepen vetëm mbas kësaj bote, duke harruar veten e tyre.

Pejgamberi (a.s.), ka thënë:

"Besimi është shtatëdhjetë e ca degë. Më e larta është fjala 'La ilahe il-lall-llah', ndërsa më e vogla është largimi i një pengese nga rruga; edhe turpi është një degë e besimit."

(Nesai, Iman, 16)

Ky hadith, i cili paraqet lidhjen e ngushtë midis besimit dhe veprimit, luan rolin e shpejgimit të ajetit kuranor: "Vërtet mendojnë njerëzit se do të lihen të thonë: 'Ne besojmë', pa u vënë në provë?" (Ankebut, 2). Kurani e thekson fort marrëdhënien e ngushtë bisim-vepër. Allahu thekson se ka krijuar jetën dhe vdekjen për të provuar cili është më vepërmirë. "Ai i ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë; Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh." (Mulk, 2)

Allahu e ka përmendur besimin bashkëngjitur me veprën, afërsisht në njëqind ajete. Kjo tregon se vepra e mirë është pasojë natyrale e besimit. Thënë ndryshe, besimi bie sjelljen e mirë dhe pengon nga sjellja e keqe. Pothuajse të gjithë ajetet, që fillojnë me "O besimtarë...", mbarojnë ose duke urdhëruar një të mirë ose duke ndaluar një të keqe. Besimi pa vepër, është si pema pa fruta, kurse vepra e keqe është si insektet që kanë pushtuar pemën, duke sjellë tharjen e saj. Besimi për të ruajtur gjallërinë dhe freskinë ka nevojë për vepra të mira.

Trazirat dhe çrregullimet social-politike, që shpërthyen në shekullin e parë të Islamit, sollën me vete diskutime serioze edhe mbi marrëdhënien e besimit me veprimin. Një pjesë mendonte se mëkati e nxjerr personin nga Islami, kurse grupi tjetër mbronte mendimin diametralisht të kundërt, ku vepra e njeriut nuk kishte asnjë ndikim mbi besimin. Mendimi i saktë, të cilin e mbron pjesa më e madhe e dijetarëve, është se mëkati nuk e nxjerr personin nga Islami, por ai ndikon në dobësimin e besimit. Edhe shumë ajete kuranore, të cilët u kërkojnë besimtarëve të pendohen në raste kur bëjnë mëkate, mbështesin këtë mendim. Çdo veprim që fetarisht konsiderohet mëkat, ndikon në dobësimin e imanit. Duhet të theksojmë faktin se besimi ka marrëdhënie me çdo sjellje tonën dhe jo vetëm me adhurimet, sepse është përhapur ideja se vetëm

pjesa e adhurimeve ndikon pozitivisht apo negativisht mbi besimin. Në këtë mënyrë, shpjegohet dukuria e përhapjes së mashtrimit, gënjeshtërsë, korrupsionit, padrejtësive, papastërtisë dhe mungesa e sigurisë sociale në botën islame. Është shumë e vështirë t'i tregosh një besimtari, që mendon se detyrimet fetare mbarojnë me plotësimin e pesë kushteve të Islamit, se shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor ka lidhje me besimin. Por nuk duhet reshtur së shpjeguari personave të tillë se Pejgamberi (a.s.), e ka konsideruar degë të besimit largimin e një sendi apo pengese që nuk lejon kalimin e njerëzve. Besimtari duhet të jetë shumë i kujdesshëm në veprimet që kryen sepse çdo veprim i tij ka lidhje me besimin e tij. Besimtari duhet të jetë gjithmonë në gjendje Ihsani (të adhurojë Allahun sikur e shikon Atë). Imani na mëson se çfarë duhet të besojmë, Islami çfarë duhet të bëjmë dhe Ihsani se si duhet ta bëjmë. Islami kërkon prej nesh që të manifestojmë veprime dhe sjellje në harmoni të plotë me parimet fetare. Asnjëherë nuk duhet ta kufizojmë ibadetin me një grup ritualesh, sepse atëherë do të lëmë jashtë një hapësirë të madhe dhe të rëndësishme të fesë. Duke marrë parasysh këtë hadith dhe shumë hadithe të tjerë që pastërtinë, besnikërinë, përsëritjen, tregtinë e ndershme etj., i konsiderojnë pjesë të besimit, mund të themi me plot bindje se çdo veprim dhe sjellje është pasqyrim i besimit tonë. Atëherë, idealja është që çdo veprim dhe sjellje ta kryejmë me ndjenjën se në çdo moment jemi nën vëzhgimin dhe mbikëqyrjen e Allahut. Çdo përpjekje sado e vogël për të arritur këtë ideal, do të japë e efekte të dukshme, si në veten tonë, ashtu edhe në mjedisin ku jetojmë. Besimtarët që besojnë një Zot që i vëzhgon në çdo moment, kanë me qindra çështje me të cilat mund ta testojnë besimin e tyre. Nuk ka mjet më të mirë se vetëkontrolli për të testuar pasqyrimin praktik të imanit.

Një Hadith



KUMTI ISLAM

Të ftosh njerëzit në besim, te e vërteta, sjelljet e mira dhe t'i ndihmosh të largohen nga të shëmtuarat, është një prej detyrave më fisnike, pasi kjo do të thotë t'i ftosh ata në shpëtimin e përhershëm.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

"Ai që fton në rrugë të drejtë, merr sevape, aq sa marrin të gjithë ata që e ndjekin atë. Kjo gjë nuk pakëson aspak sevapet e atyre që e ndjekin. Kurse ai që fton në rrugë të keqe, merr aq gjynahe sa të gjithë ata që e ndjekin. Kjo gjë nuk pakëson aspak gjynahet e të tjerëve!..." (Muslimi, Ilim, 16; Ebu Davud, Sunnet, 6; Tirmidhiu, Ilim, 15)

Ftesa që bëhet për të hyrë në Islam, e zbukuron ftuesin edhe në jetën e kësaj bote edhe në tjetrën, është manifestimi më i bukur i detyrimit tonë të të qenit mirënjohës ndaj Allahut. Për besimtarin nuk mund të imagjinohet ndonjë manifestim më i mrekullueshëm se ky lavdërim që i bën atij, Allahu i Madhëruar në Kuran:

"E kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: 'Unë, me të vërtetë jam mysliman.'" (Fussilet, 33)

Resulullahu (a.s.), ka bërë një përpjekje të jash-

tëzakonshme, që ftesa që ai i bëri njerëzimit për shpëtimin e përhershëm të dëgjohej nga të gjithë. Edhe ne duhet të ndjejmë të njëjtën përgjegjësi në këtë rol, duke pasur parasysh nderimin dhe krenarinë që ka të qenit pjesë e ymetit të tij. Ndaj dhe Resulullahu (a.s.), kërkon nga ymeti që ta vazhdojë këtë detyrë. Në dy hadithe, i Dërguari i Zotit (a.s.), ka thënë:

"Përcillen te njerëzit, qoftë edhe një ajet nga unë." (Buhari, Enbija, 50)

"Allahu ia zbardhtë faqen atij që përcjell te të tjerët, fjalët që dëgjon prej nesh, ashtu siç i dëgjon. Sa e sa njerëz të cilëve u përcillet dija, e kuptojnë dhe praktikojnë atë më mirë se ai që e ka dëgjuar." (Tirmidhiu, Ilim, 7)

Zoti i Madhëruar ka premtuar se do ta përsosë Nurin e Tij, dhe Islami do të triumfojë. Edhe sikur të përpiqemi, edhe sikur të mos përpiqemi, Zoti i Madhëruar do ta mbajë premtimin. Një mysliman i mençur përpiqet ta bëjë kumtin islam, që të marrë pjesë në këtë triumf të garantuar.

Nëse diku vihet re se është zbehur jeta fetare, dhe shihet se njerëzit kanë devijuar, aty kumti islam bëhet detyrë parësore, pas imanit dhe farzeve. Atëherë, deri sa të kumtohet e vërteta, duhen lënë

mënjatë një sërë veprash të tjera të mira. Për shembull, sa akt i shenjtë dhe i begatë është dhënia gjë fëmijës. Por një nënë që shikon shtëpinë e saj duke u djegur dhe vazhdon ta ushqejë të birin, bën një gabim shumë të madh, sepse të bëjë diçka për të shuar zjarrin në ato çaste, është më emergjente sesa të ushqejë të birin.

Është shumë interesante që në Hutben e Lamtumurës, të pranishëm ishin 120.000 sahabë. Vetëm 20.000 prej tyre prehen në varrezat e Mekës së begatë dhe të Medinës së përndritur. Të tjerët janë përhapur në mbarë rruzullin tokësor, me qëllim që të ftonin njerëzit në Islam. Vendi më i largët që kanë mbërritur ka qenë vendi i tyre i varrit.

Përfitimi i atij që kryen si duhet kumtesën islame, është më i çmuar se të gjithë thesaret e kësaj bote. Enesi (r.a.), transmeton:

Një ditë, Resulullahu (a.s.), tha:

"Është një pjesë e njerëzve që nuk janë as profetë e as shehidë. Mirëpo, në Ditën e Kiametit,



***"E kush flet më bukur
se ai që i fton njerëzit
drejt Allahut, bën vepra
të mira dhe thotë:
"Unë, me të vërtetë jam
mysliman."***

(Fussilet, 33)

për arsye të statusit të tyre tek Allahu, ata do t'i kenë zili edhe profetët edhe shehidët.¹ Fytyrat i kanë plot nur, si dhe do të jenë të ulur në piedestale të ndritura. Ata do t'i njohin të gjithë."

Sahabët e nderuar e patën pyetur:

- Kush janë ata, o Resulullah?

- Ata të cilët janë përpjekur që njerëzit ta duan Allahun dhe që Allahu t'i dojë ata. Ata shëtisin në rruzullin tokësor duke këshilluar dhe duke shpjeguar Islamin. – tha i Dërguari i Allahut (a.s.).

Unë e pyeta:

- O i Dërguari i Allahut! E kuptuam se si mund t'i bësh njerëzit ta duan Allahun, por Allahun si mund ta bësh që t'i dojë njerëzit?

Dhe ai m'u përgjigj:

- Ata urdhërojnë njerëzit për gjërat që Allahu i pëlqen dhe i bëjnë ata të ruhen nga gjërat që nuk i pëlqen Ai. Kur njerëzit u

1. Qëllimi i kësaj shprehjeje është të tregojë vlerën që kanë njerëzit që gjenden në rrugë të kumtesës islame. Kjo nuk do të thotë se ata janë më lart se pejgamberët dhe shehidët, pasi edhe vetë pejgamberët dhe shehidët janë njerëz që kanë sakrifikuar jetën e tyre për kumtesën islame.

nënshtrohen këtyre, edhe Allahu i Madhëruar i do ata. (Ali el-Muttaki, III, 685-686; Bejhaki, Shuab, I, 367.)

Sufjan eth-Thevri –kuddise sirruhu- ka thënë:

“Të shkosh në Horasan për të shpjeguar Islamin, është për ty më me fitim sesa të rrish komshi me Qaben (pra të banosh në Mekë).”

Ndërsa neglizhenca që mund të bëhet me kumtesën islame, mund të shkaktojë pasoja të rrezikshme, aq sa të çojë në shkatërrim një popull të tërë. Duhet bërë kujdes ndaj qortimit të të Dërguarit të Allahut:

“Betohem në Allahun që më ka dhënë jetë, se ju ose do të urdhëroni të mirën dhe të ndaloni të keqen ose Allahu do të dërgojë mbi ju një dënim nga vetja e Tij, e atëherë do të bëni dua dhe lutjet nuk do t’ju pranohen.” (Tirmidhiu, Fiten, 9.)

Se sa detyrë me rëndësi është të ftosh të tjerët në të mirë dhe t’i largosh ata nga e keqja, e shpjegon më së miri kjo ngjarje:

Në bregun e Detit të Kuq, në qytezën Ejle, jetonte një bashkësi izraelite. Ndërkohë që të shtunave u duhej të linin punën dhe të bënin ibadet, ata shkelnin urdhrin hyjnor dhe peshkonin. Ndaj dhe ata u quajtën **As’habus-sebt** (populli i së shtunës).

Njerëzit aty ishin ndarë në dy pjesë:

1. Mëkatarët, që shkelnin ndalesat.
2. Besimtarët dhe bamirësit.

Ata që ishin të lidhur me fenë, shpjegonin të drejtën dhe të shtrembrën, por nuk mund t’u flisnin moskokçarësve. Edhe të mirët ndaheshin në dy grupe:

1. Ata që këshillonin shkelësit e ndalesave, por që pas një farë kohe u lodhën dhe ranë në pesimizëm. Këta, më pas, e braktisën detyrën e thirrjes.

2. Besimtarët që vazhduan të qortonin dhe këshillonin njerëzit, pa u dëshpëruar fare, duke u bërë ballë të gjitha vështirësive.

Në një ajetin fisnik, për grupin e qendrueshëm thuhet:

“Kur disa prej tyre thanë: ‘Përse këshilloni,



“Betohem në Allahun që më ka dhënë jetë, se ju ose do të urdhëroni të mirën dhe të ndaloni të keqen ose Allahu do të dërgojë mbi ju një dënim nga vetja e Tij, e atëherë do të bëni dua dhe lutjet nuk do t’ju pranohen.”

kur e dini se Allahu do të na zhdukë ose do të na ndëshkojë ashpër? Këshilltarët u përgjigjën: ‘Për t’u arsyetuar para Zotit tuaj dhe që ju të mund të ruheni nga gjynahet.’ (el- Araf, 164.)

Pas pak, ata që nuk iu bindën urdhreve hyjnorë, u shndërruan në majmunë, si dënim nga Zoti. Sipas disa komentuesve të Kuranit, në mesin e atyre që u dënuan ishin edhe ata që shpërfillën detyrën e kumtit.

Fatkeqët që u shndërruan në majmunë, për pak kohë i vizituan të dëshpëruar të afërmit që shpëtuuan prej dënimit. Të afërmit u thanë:

- A nuk ju porositëm të ruheshit nga gjynahet?

Ata kthenin përgjigje me lot në sy dhe duke luajtur kokën. Pas tre ditëve që kishin hyrë në trajtën e majmunëve, vdiqën të gjithë.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Allahu i Madhëruar nuk dënon të pafajshmit për



Ajo çfarë
është më me rëndësi
në misionin e ftesës
për të vërtetën, është dhënia
e të gjitha energjive që kemi
në këtë rrugë, me shpresën që
të meritojmë pëlqimin
e Allahut.

shkak të gjynaheve që bën shumica. Përveç atyre që nuk bëhen pengesë, kur kanë mundësi ta pengojnë tjetrin të bëjë gjynah.” (Ahmed, V, 192.)

Ajo çfarë është më me rëndësi në misionin e ftesës për të vërtetën, është dhënia e të gjitha energjive që kemi në këtë rrugë, me shpresën që të meritojmë pëlqimin e Allahut. Mundet që të mos merret ndonjë rezultat, sado që u referohemi mjeteve të duhura. Sidoqoftë, kjo gjë nuk duhet të shkaktojë dëshpërim e as demoralizim, pasi ai që do të dhurojë udhëzimin është Allahu. Ajo çfarë i takon njeriut është të vazhdojë kumtesën islame, pa u mërzhitur e pa u dëshpëruar. T’i mbështetet Allahut me besim të plotë (tevekkul).

Ebu Hurejre (r.a.), rrëfihen:

- Dëgjonim (nga mesi i sahabëve këtë të vërtetë): Në Ditën e Kiametit njeriun do ta kapë për fyti dikush që nuk e njihje më parë. Njeriu do të habitet dhe do ta pyesë:

- Çfarë do prej meje? Unë ty nuk të njoh!

Kurse i panjohuri, duke u ankuar, i thotë:

- Kur ishim në atë botë, më shihje se isha në gabim dhe gjynah, nuk më qortoje e as nuk më pengoje prej të këqijave. (Munziri, et-Tergib, III, 164/3506; Rudani, Xhemul-fevaid, V, 384.)

ELEMENTET QË DUHEN PASUR KUJDES GJATË KUMTESËS ISLAME

Ashtu sikurse ka një metodë dhe rregull për çdo punë, edhe për kumtimin islam ka parime shumë të rëndësishme që duhen ndjekur. Të bësh kumtimin islam si duhet, është po aq e rëndësishme sa vetë kumtesa islame. Nuk është e mundur të pritet ndonjë dobi nga një kumtesë që bëhet në një mënyrë të gabuar. Kjo gjë i jep njëkohësisht një përgjegjësi të madhe atij që e realizon, pasi kjo gjë më shumë ka rrezik të prishë punë sesa të rregullojë.

ELEMENTET KRYESORE QË DUHEN BËRË KUJDES NË KUMTIMIN ISLAM:

- Para se të kumtosh të drejtën dhe të mbarën, pikësëpari duhet ta njohësh dhe t’i jetosh ato, sepse kumtesa që bën injoranti është e mbushur me gabime, si nga ana e formës ashtu edhe e thelbit.

- Për një kumtesë të pranuar duhet një zemër e veçantë dhe fytyrë e buzëqeshur. Duhet të bësh një jetë shembullore, të flasësh me një gjuhë shpirtërore që përhap mëshirën, finesën dhe delikatesën. Kurrë nuk duhet neglizhuar fakti se njerëzit nuk i pëlqejnë kumtuesit kaba, të pagdheundur dhe të vrazhdë.

- Çfarëdo gjynahu dhe gabimi që të ketë bërë njeriu, nuk duhet privuar nga kumtesa dhe ftesa në Islam. Duke menduar se edhe nga një shkëmb, madje edhe nga një mur dalin sa e sa pemë e lule, nuk duhet përjashtuar askush, sepse mëshira e Allahut është e pakufishme.

Lidhur me këtë, Pejgamberi (a.s.), është shembulli më i mirë, pasi nuk ia mbylli derën e kumtesës islame as Hebbar bin Esved-it, i cili duke e rrëzuar qëllimisht nga deveja, u bë shkak që të vdiste e



*"Në sajë të mëshirës
së Allahut, u solle butësisht
me ta (o Muhamed).
Sikur të ishe i ashpër
dhe i vrazhdë, ata
do të largoheshin prej teje..."*
(Ali Imran, 159)

bija e Profetit, Hazreti Zejnepja.

Nuk ia përplasi derën as lkrime bin Ebu Xhehlit, i cili shfaqti të gjithë armiqësinë e mundshme ndaj Pejgamberit, deri në çlirimin e Mekës.

Po ashtu, as Vahshiut, i cili e martirizoi xhaxhanë e Pejgamberit, Hazreti Hamzain.

Madje, as së shoqes së Ebu Sufjanit, Hindit, e cila kafshoi me plot mllef mëlçinë e xhaxhait të Pejgamberit (a.s.).

Ndaj dhe Allahu i është drejtuar atij duke i thënë:

"Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ta dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme." (Ali Imran, 159.)

Pejgamberi (a.s.), kishte një fqinj hebre të ri në moshë. Ky djalosh nuk kishte edukatë të keqe. Një ditë ra i sëmurë. Resulullahu (a.s.), bashkë me sahabët shkuan ta vizitonin.

Ndërkohë, Resulullahu (a.s.), e pyeti atë:

- A dëshmon se nuk ka zot tjetër përveç Allahut dhe se unë jam i Dërguari i Tij?

Djaloshi e pa të atin. I ati heshti, edhe ai heshti. Zotëria ynë (a.s.), e përsëriti pyetjen për së dyti, pastaj për së treti. Pasi tha të tretën, i ati reagoi:

- Thuaje fjalën, që po të lusin ta thuash!

Më pas, djaloshi tha shahadetin. Pas pak, dha shpirt. Ndërkohë që hebrenjtë deshën t'i dilnin për zot, Resulullahu (a.s.), tha:

- Ne jemi më afër tij, sesa ju.

Më pas, Profeti i Nderuar (a.s.), e lau atë, e mbështolli me qefin, e leu me erë të mirë dhe ia fali namazin. (Abdurrezzak Musannef, VI, 34 – 35.)

Vetë Zoti i Madhëruar kërkoj nga Musai (a.s.), të komunikonte në mënyrë të butë me Faraonin, i cili ishte një vrasës foshnjesh dhe e pretendonte veten për Zot.

- Ai që jep këshilla, duhet të jetë thuajse si një mekanik i zoti. Nëse nuk do të prisheshin gjërat ose, nëse pjesët e këmbimit dhe sendet e prishura nuk do të vinin në oficinën e tij, ai nuk do të mundte ta ushtronte profesionin. Ndaj dhe në syrin e mekanikut, sendet e prishura janë si një dhuratë. Kësisoj, të nënçmosh apo të dëbosh gjynahqarët nuk është veprim i denjë. Një njeri i vërtetë i kumtesës, i sheh gjynahqarët si zogj të plagosur. Me duart e buta plot shërim dhe me zemër plot mëshirë i merr në sarajin e zemrës pa i trembur, pa i humbur dhe përpiqet t'i shërojë.

Asnjë mjek i denjë nuk nevrifikoset me të sëmurin, duke i thënë: "Përse je sëmurë?". Por, duke pasur parasysh dhimbjen dhe vuajtjen që ai ka, pa humbur kohë i drejtohet për ta shëruar me plot dashuri. E ndjen veten përgjegjës për këtë shërim. Kështu pra edhe një djalosh i ri duhet të jetojë në mesin e shoqërisë, me vetëdijen e një mjeku që shëtit repartet e spitalit. Kjo ndjenjë, kur kontrollon sjelljet, është si një jelek shpëtimi për ata që kanë devijuar nga rruga.

Të këshillosh për mirë të tjerët, t'i pengosh ata të shkojnë te e keqja, t'i ftosh t'i drejtohen Zotit dhe së drejtës, është gjëja më e mirë që mund t'u bësh atyre. Për të zbatuar Librin e Zotit dhe Sunetin profetik në jetën tonë, para së gjithash duhet që detyra e kumtesës islame dhe shërbimi që u bëhet njerëzve të ndihet në zemër ashtu si një dashuri...

Kumtuesi, po ashtu, duhet të gjejë një damar që të depërtojë në zemrën e bashkëbiseduesit. Pasi çdo njeri ka një stil të vetin. Mundet që jo çdokush të ndikohet nga i njëjti stil komunikimi.

Fjala më thelbësore që mund të thuhet për këtë temë, vjen nga i Dërguari i Allahut:

"Lehtësoni, mos vështirësoni! Përhapni lajme të mira, mos urreni!.." (Buhariu, Ilim, 11.)

Natyrisht, me kusht që të mos dëmtohet thelbi i fesë.

Dikur, një vëlla i yni që punonte në Austri, na pati thënë një ngjarje të tillë:

"Unë dikur isha një njeri i varur nga pija dhe bixhozi. Ndërkohë që në fakt çdo ditë po përkeqësohesha gjithnjë e më shumë, unë vetë mendoja sikur po dëfrehesha. Më pas, fillova të punoja si punëtor në Austri. As atje nuk arrita t'i braktisja këto vese të shëmtuara. Natyrisht, ndërkohë që isha në këtë gjendje, si në Turqi, po ashtu edhe aty njerëz zemërbardhë dhe dashamirës nga xhamati i xhamisë, përpiqeshin të më largonin nga këto vese. Mirëpo unë, sa herë që ata më jepnin këshilla, i kundërshtoja dhe u drejtohesha me fjalë të rënda.

Një ditë, duke ecur në rrugë, papritur m'u errësuan sytë dhe pa kuptuar rashë përdhe. Pastaj hapa sytë dhe u gjenda në spital. Kisha kaluar një hemorragji në stomak. Fqinjët më kishin sjellë në spital. Nuk kisha para të paguaja spitalin, për arsye të shpenzimeve që bëja për pijen dhe bixhozin, madje më ishin mbledhur shumë borxhe. Kur dëgjova se pas pak do të më vinin disa vizitorë, u habita. Ndërkohë që po mendoja se kush mund



*"Lehtësoni,
mos vështirësoni!
Përhapni lajme të mira,
mos urreni!.."*

(Buhariu, Ilim, 11.)

t'i vinte në vizitë një njeriu si unë, që kishte devijuar kaq shumë rrugën, u habita edhe më shumë, kur pashë ata që hynë në dhomë. Ata që po hynin brenda nuk ishin shokët e botës së shëmtuar, në të cilën kisha rënë, por ishin njerëzit e xhematit të xhamisë së lagjes në të cilën banoja. Fillimisht më uruan të shkuara, më dhuruan një buqetë me lule dhe më lanë një zarf me të holla, duke menduar se mund të më nevojiteshin. Ndërkohë që përballë kësaj bujarie, nga turpi nuk më dilnin dot fjalë nga goja, ata më thanë se kishin menduar edhe për familjen time dhe do ta ndihmonin, derisa unë të dilja nga spitali. Ajo çfarë mund të bëja unë përballë kësaj bujarie, mirësjelljeje dhe tolerance, ishte vetëm t'i falënderoja.

Sapo dola nga spitali, nisa të jetoja në mesin e xhematit të xhamisë, sepse ata më ishin gjendur në ditë të vështira. Hyra në xhami, dhe ashtu si një njeri i etur që pi ujë me nxitim, edhe unë para Zotit tim bëra *teube* dhe rashë në sexhdet e mirënjohjes. U luta që të bëhesha një besimtar i mirë, duke thënë: "Sa e bukur është kjo fe, që u ka dhënë kaq virtyte të larta këtyre njerëzve." Kështu nisa të mësoja dhe ta praktikojja fenë time."



DISPOZITAT E SUBJEKTIT TË SË DREJTËS NË SHERIATIN ISLAM

Ma. sci. Flamur Soflu

HYRJE

Bindja e prerë është se vetëm Allahut i përket sundimi dhe marrja e vendimeve. Ai është i pastër prej çdo të mete dhe vetëm Atij i përket të urdhërojë dhe të ndalojë. Ai është i Vetmi që përcakton se çfarë është hallall dhe haram: **“vendimi (në çështjen e adhurimit) nuk i takon askujt, veç Atij”, “Ja, vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi”¹; “Pra-ndaj, mos thoni me gjuhët tuaja të rreme: “Kjo është e lejueshme e kjo e ndaluar”, që kështu të trillojnë gënjesht- tra për Allahun. Me siguri, ata që trillojnë gënjesht- ra ndaj Allahut, nuk do të shpëtojnë”².**

Ne besojmë me besim të plotë se Legjislacioni i Allahut është i drejtë dhe nuk ka asnjë të metë: **“Ne me urtësi e zbritëm atë (Kuranin)...”³, “Pas së vërtetës nuk ka tjetër veç iluzione”⁴.**

Ne si myslimanë, kemi bindje të prerë se i vetmi legjila- cion, të cilit duhet t'i nënshtrohemi, është sheriat i Allahut, pavarësisht nëse kjo i pëlqen prijësit apo jo. Po ashtu, ne kemi bindje të prerë se i vetmi legjislacion që duhet të zbatohet, është sheriat i Allahut dhe çdo mysliman e ka obligim të prerë të veprojë vetëm sipas tij, me aq sa ka mundësi, pavarësisht se këtë sheriat prijësi e zbaton apo e ka braktisur atë: **“Kur Allahu ose i Dërguari i Tij ka vendosur për një çështje, nuk i takon (nuk i lejohet) asnjë besimtar i që të bëjë ndonjë zgjidhje tjetër. E kush e kundërshton Allahun dhe të Dërguarin e Tij, i është**

larguar shumë së vërtetës.”⁵.

Bindja jonë e prerë është se ne nuk guxojmë të lypim gjykim tjetër, veç gjykimit me sheriat dhe se vetëm sheriat i përcakton atë që është haram, atë që është hallall, atë që është obligim i prerë (*farz*), atë që është vepër e rekoma- nduar (*mendua*), atë që është vepër e papëlqyer (*mekruh*) dhe ajo që është vepër e lënë në dëshirën e myslimanit, sipas dëshirës e vepron ose e braktis (*mubah*): **“Për Zotin tënd. Jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty, as të asaj para teje), derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar konfliktin mes tyre e pastaj (pas gjykimit tënd), të mos ndajnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht”⁶.**

Ajo që ka lejuar Allahu, do të jetë e lejuar deri në Ditën e Kiametit dhe askush nuk ka të drejtë ta bëjë të ndaluar (*haram*). Ndërsa, ajo që ka ndaluar Allahu, do të jetë e nda- luar deri në Ditën e Kiametit dhe askush nuk ka të drejtë ta bëjë të lejuar (*hallall*). **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plo- tësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj.”⁷, “Të përkryera janë fjalët e Zotit tënd në vërtetësi dhe drejtësi; fjalët e Tij askush nuk mund t'i ndryshojë. Ai dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë.”⁸.**

Dispozitat e Allahut (xh.sh.), duhet t'i kryejë dikush. Ai që është i obliguar për t'i kryer ato, është njeriu. Pra, vetë njeriu është subjekt i së drejtës, ai ka mundësi, ai i plotëson kushtet të jetë i ngarkuar me obligime dhe ka mundësi t'i zbatojë ato.

1. Jusuf: 40

2. El-E'araf: 54

3. En-Nahl: 116

4. Isra: 105

5. Junus: 32

6. El-Ahzab: 36

7. En-Nisa: 65

8. El-Maide: 3

9. El-En'am: 115

Aftësia për kryerjen e kësaj të drejte është dy llojesh:

1. Zotësia e së drejtës në pikëpamje të detyrimeve. Kjo është aftësia e njeriut, që një detyrim juridik mund t'i përkasë atij, qoftë në leverdi të tij ose jo.

2. Zotësia e së drejtës në pikëpamje të detyrimit juridik për kryerjen e punëve, thënë shkurt, aftësia për punë.

Shumica e dijetarëve myslimanë e kanë ndarë jetën e njeriut në katër etapa. Sipas tyre, janë të vërtetuara të drejtat dhe detyrat e çdo njeriu. Këto etapa janë:

1. Periudha e jetës në barkun e nënës. Kur fëmija është në barkun e nënës, ka vetëm të drejta e jo detyrime. Ato të drejta janë e drejta e testamentit (*vasijjetit*) të fëmijës, e drejta për trashëgim e para së gjithash, e drejta për jetë. *Vasijeti* dhe trashëgimia janë të plotfuqishme vetëm atëherë, kur fëmija lind i gjallë. Edhe pse fëmija është i lidhur shumë me nënën, kur është në mitrën e saj, e drejta islame e konsideron atë të pavarur.

2. Kjo është periudha nga lindja deri në moshën shtatëvjeçare. Në këtë moshë fëmija ka të drejta dhe detyrime, por ato mund t'ia kryejë edhe dikush tjetër në vend të tij, si p.sh.: lidhja e kontratës, pagimi i zekatit, sadakatul-fitrit, kompensimi i gjërave të shkatërruara etj. Për fëmijën në këtë periudhë nuk mund të zbatohet kurrfarë dënimi fizik për veprimin e bërë, si: vjedhje, vrasje, etj.

3. Kjo periudhë është ajo në të cilën njeriu ka të drejta dhe detyrime. Etapa nga mosha shtatëvjeçare e deri në pjekuri është periudha kur fëmija mund të kryejë namazin, agjërimin dhe obligimet e tjera fetare dhe të pranojë dhuratë edhe atë nga e cila mund të ketë dobi. Megjithatë, anëtarësimi në vakf, dhënia e dhuratave e të ngjashme, është e padrejtë dhe nuk ka kurrfarë fuqie ligjore, edhe nëse kujdestari i tij e ka pranuar. Lidhja e kontratës, ku ekziston mundësia e fitimit, por edhe e humbjes, është e lejuar nëse me të pajtohet edhe kujdestari i tij.

4. Kjo është periudha e pjekurisë; ka të drejta, por edhe të gjitha detyrimet. Në fushën materiale dhe aftësinë për punë, ka zotësi për të vepruar dhe është i pavarur nga të tjerët, por me kusht që të jetë i aftë dhe i vetëdijshëm.

Krahas aftësive mendore dhe pjekurisë, që një person të jetë i ngarkuar me obligime, është e domosdoshme liria (fizike), si dhe e drejta e zgjedhjes dhe vullnetit të lirë.

Pengesat për moskryerjen e detyrimeve dhe obligimeve mund të jenë të karakterit natyror, por mund të paraqiten edhe nga vetë veprimet e njeriut.

a. Dukuritë natyrore, të cilat kufizojnë kryerjen e ob-

ligimeve dhe detyrave të sheriatit janë;

1. çmenduria,
2. vegjëlia,
3. matufepsja,
4. harresa,
5. gjumi,
6. alivanosja,
7. hajzi dhe nifasi,
8. sëmundja,
9. vdekja.

1. ÇMENDURIA

I çmenduri nuk konsiderohet si *mukel-lef* (juridikisht i përgjegjshëm, i aftë për të vepruar juridikisht). Nëse vjen plotësisht në vete, atëherë edhe ai konsiderohet *mukel-lef* dhe për ato obligime që i kanë kaluar pa i kryer, nuk është i obliguar t'i zëvendësojë (*kaza*), ngase ka qenë i pavetëdijshëm. Për këtë çështje, Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: *"Ngrihet lapsi (nuk shkruhen mëkatet) për tre veta: për atë që është në gjumë, derisa të zgjohet, për fëmijën, derisa të arrijë moshën madhore (bulug) dhe për të çmendurin, derisa të përmendet"*.

Përsa i përket dhënies së zekatit, sigurisë së pasurisë dhe furnizimit, i çmenduri nuk ka kurrfarë obligimi, mirëpo këtë obligim duhet ta kryejë kujdestari i tij.

2. VEGJËLIA

Ai që nuk ka hyrë ende në moshën madhore, nuk konsiderohet *mukel-lef*. Kjo bazohet në hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.), i cili u përmend pak më parë.


I mituri nuk konsiderohet *mukel-lef*, ngase nuk i plotëson kushtet për të qenë i tillë. Kushtet për të qenë *mukel-lef* janë dy:

- a. aftësia për ta kuptuar dispozitën obliguese,
- b. aftësia për ta zbatuar atë (dispozitën).

Sa i përket dhënies së zekatit, sigurisë së pasurisë dhe furnizimit, fëmija nuk ka kurrfarë obligimi, mirëpo këtë obligim duhet ta kryejë kujdestari i tij.

Nëse fëmija e kryen namazin, agjëron dhe largohet nga haramet meriton shpërblim, për shkak se ka vepruar vullnetarisht, e ky shpërblim nuk konsiderohet si shpërblim i atij personi që është *mukel-lef*, e që meriton shpërblimin për shkak të obligimit të kryer. Por mund të ndodhë që fëmija ta kryejë ndonjë vepër që është e ndaluar, mirëpo për të s'ka ndëshkim. Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë:

"Është ngritur lapsi (nuk shënon veprat) për fëmijën derisa të rritet".



3. MATUFEPSJA

I matufepsuri konsiderohet jo i obliguar, ngase me matufepsjen e mendjes mënjanohet obligimi, edhe nëse personi është i fuqishëm dhe i shëndoshë.

4. GJUMI

Në kohën kur gjendet në gjumë, njeriu nuk konsiderohet *mukel-lef*, mirëpo nëse i ka kaluar ndonjë ibadet pa kryer kur ka qenë në gjumë, ai është i obliguar ta bëjë kaza atë ibadet. Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: *"Kush ka qenë fjetur dhe i ka kaluar namazi pa e falur, ose ka harruar ta falë, le ta falë kur t'i kujtohet"*.

Pra, nuk konsiderohet mëkatar robi në momentin e gjumit, nëse kalon pa e kryer ndonjë ibadet të obligueshëm.

5. ALIVANOSJA

Në kohën kur gjendet i alivanosur, njeriu nuk konsiderohet *mukel-lef*. Nëse gjatë kohës së alivanosjes robti i kalon ndonjë obligim pa kryer, ai duhet ta bëjë kaza.

6. HARRESA

Nëse robi harron për ta kryer ndonjë obligim për arsye të harresës, nuk konsiderohet mëkatar, mirëpo atë obligim që i ka kaluar, duhet ta bëjë kaza. Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: *"Nuk konsiderohet mëkat për ymetin tim ajo vepër që bëhet pa qëllim dhe nga harresa"*.

7. HAJZI DHE NIFASI

Hajzi dhe *nifasi* janë dukuri që paraqiten vetëm te femrat. Gjatë kohës së hajzit dhe *nifasit*^{10*} femra konsiderohet jo e ngarkuar në disa obligime. Gjatë *hajzit* dhe *nifasit* femra nuk duhet të falë namaz, të agjërojë, të lexojë Kuran etj. Gruaja me *hajz* dhe *nifas* ka për detyrë ta bëjë kaza agjërimin, ndërsa namazin jo.

8. SËMUNDJA

I sëmuri nuk konsiderohet *mukel-lef* për disa obligime. Sëmundja është pengesë për robin që t'i kryejë disa obligime, si p.sh: i sëmuri nuk mund të agjërojë, mirëpo ato ditë që nuk i ka agjëruar, ka për obligim t'i agjërojë më vonë.

9. VDEKJA

I vdekuri nuk konsiderohet *mukel-lef* asnjëherë, ngase banorët e botës së amëshuar, xhenetlinjtë apo xhehnelinjtë, nuk konsiderohen *mukel-lef*-ë. Të gjithë të vdekurit besojnë, ngase besimi i tyre është i pashmangshëm. Mirëpo, edhe në agoni të vdekjes njeriu nuk konsiderohet *mukel-lef*, sepse, edhe nëse beson në ato momente, besimi i tij është i pavlefshëm. Për këtë çështje, si shembull mund të marrim rastin e Faraonit, i cili në momentin kur po mbytej, besoi, mirëpo besimin e tij Allahu (xh.sh.), nuk

e pranoi. Kurani tregon:

"...Por, kur po mbytej, (Faraoni) tha: "Besoj se s'ka zot tjetër përveç Atij që i besojnë bijtë e Izraelit; dhe unë jam ndër myslimanët, vallë, tani (po beson), ndërkohë që më parë ishe i padëgjueshëm dhe ngatërrestar?"" (Junus, 90- 91.)

Meqë në momentet e vdekjes njeriu nuk konsiderohet *mukel-lef*, atëherë edhe besimi i tij në këto momente nuk pranohet. Gjithashtu, robi nuk konsiderohet *mukel-lef* edhe në momentet kur paraqiten shenjat e mëdha të Kiametit, dhe besimi i tij nuk vlen në ato momente, nëse nuk ka besuar më parë. Allahu në Kuran thotë: **"Ditën kur të vijnë disa shenja të Zotit tënd, atëherë nuk do t'i bëjë dobi askujt besimi i tij, nëse nuk ka besuar më parë ose nuk ka bërë ndonjë të mirë me besimin e tij!"** (En'am, 158.)

Reathanat të cilat shkaktohen nga puna e njeriut, e të cilat ndikojnë në moskryerjen e obligimeve dhe detyrimeve fetare janë:

- a. injoranca
- b. dehja
- c. tallja
- ç. naiviteti
- d. udhëtimi
- e. gabimi pa qëllim
- ë. dhuna

INJORANCA

Injoranca i pamundëson njeriut njohjen e normave të sheriatit e, derisa t'i njohë ato norma, ai nuk konsiderohet i obliguar *mukel-lef*. Nëse injorantit i jepet mundësia t'i mësojë normat e sheriatit (se ç'është obligim për të), atëherë të gjitha obligimet e lëna nga injoranca, i ka për detyrë t'i bëjë kaza. Ai mysliman, që nga injoranca nuk e di se prostitucioni është i ndaluar, e kryen këtë akt, mbi të ekzekutohet dënimi sipas sheriatit; nëse nuk e ka falur namazin nga injoranca, ai duhet ta bëjë kaza. Ndërsa ai njeri, që nuk ka pasur mundësi t'i njohë ligjet e sheriatit, ai person nuk konsiderohet *mukel-lef* duke u bazuar në ajetin e Kuranit: **"Ne nuk dënojmë asnjë popull, para se të çojmë të dërguar!"** (Isra, 15.)

Ai njeri që e pranon Islamin në vendet joislame, nuk duhet ta bëjë kaza namazin, agjërimin dhe obligimet e tjera. Ose, nëse ai ka bërë zina, mbi të nuk ekzekutohet dënimi për zina.

DEHJA

Me shprehjen *dehje* nënkuptohet humbja e logjikës brenda një kohe të caktuar, për shkak të alkoolit, apo ndonjë produkti tjetër që e deh njeriun.

Dehja e personit mund të jetë dy llojesh:

1. Ndodh që njeriu të dehet prej nevojës së jashtëzakonshme (kur është i etur dhe nuk ka çfarë të pijë tjetër, përveç

10. *Hajzi është periudha e menstruacioneve, ndërsa nifasi është i ngjashëm me menstruacionet, por paraqitet pas lindjes së fëmijës.

alkoolit), ose dehet gjatë përdorimit të barnave. Norma e kësaj dehjeje është e njëjtë, sikurse e alivanosjes. Obligimet të cilat i kanë kaluar pa i kryer duhet t'i bëjë kaza.

2. Kur njeriu pi alkool (apo ndonjë produkt tjetër që të deh) nga dëshira (pa qenë i detyruar në asnjë mënyrë), konsiderohet si *mukel-lef* dhe ndaj tij duhet të kryhet çdo normë, si: nëse ai ka bërë ndonjë kontratë për shitblerje, për huamarrje etj. Norma e shariatit kryhet ndaj këtij personi, ngase logjika është prezente, por ajo nuk është në gjendje të kuptojë, sepse nuk u është përmbajtur ligjeve të Ligdhënesit. Ai person, i cili dehet në këtë mënyrë, konsiderohet mëkatar dhe është i obliguar që ibadetet t'i bëjë kaza.

Të gjithë juristët islamë janë të mendimit se deha e tillë nuk e bën njeriun të lirë nga obligimet, por ai konsiderohet *mukel-lef*.

TALLJA

Me fjalën tallje kuptohet shprehja që përdor dikush për të përçmuar, për t'u tallur. Tallja nuk e largon njeriun nga obligimet që duhet të kryejë.

Tallja është tri llojesh:

1. Tallja në çështjet e bashkëjetesës.
2. Tallja në çështjet e ndonjë lajmi.
3. Tallja në çështjet e besimit.

Si tallje në çështjet e bashkëjetesës mund të përmendet kjo: nëse dikush duke u tallur e shkurorezon gruan, sipas disa dijetarëve ai shkurorezim është i ligjshëm. Ose, nëse dy veta gjatë shitblerjes tallen duke bërë aktin e kontratës dhe ia vlerësojnë çmimin mallit dyfish më tepër ose më pak se sa e ka vlerën, sipas Ebu Hanifes ky akt konsiderohet i ligjshëm e sipas disa të tjerëve ky akt është jo i ligjshëm, ngase qëllimi nuk ka qenë shitblerja e vërtetë.

Tallja që ka të bëjë me çështjet e bashkëjetesës është dy llojesh:

- a. Tallja e cila mund të përmirësohet,
- b. Tallja e cila nuk mund të përmirësohet.

Tallja, e cila mund të përmirësohet, është ajo tallje që ka të bëjë me çështjet e shitblerjes dhe shpërblimit.

Tallja, e cila nuk mund të përmirësohet, është ajo e çështjeve të kurorëzimit, faljes së hakmarrjes, lirimit të robit, betimit, premtimit etj.

Tallja në çështjet e besimit është shumë e dëmshme, sepse, nëse dikush duke u tallur flet fjalë që e shtypnë njeriun në mosbesim (kufer), e sjellin atë në pozitë të palakmueshme.

NAIVITETI

Me fjalën naivitet nënkuptohet vepra e atij njeriu, që vepron nga mendjelehtësia, duke mos arsyetuar. Naiviteti nuk e liron njeriun nga obligimet dhe të drejtat që ka ndaj Allahut dhe njerëzve. Mirëpo, shariat islam ia ruan interesat, duke mos i lejuar naivit ta harxhojë pasurinë e tij si të dojë.

GABIMI PA QËLLIM

Me gabimin pa qëllim nënkuptohen ato gabime, që njeriu i bën pa dashje dhe pa qëllim. Nëse robi bën ndonjë mëkat pa qëllim, ai nuk ndëshkohet për të, ngase Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë: "*Nuk konsiderohet mëkat për umetin tim ajo që bëhet nga mosdashja dhe harresa...*", ose hadithi tjetër: "*Me të vërtetë, veprat vlerësohen sipas qëllimit (që ka njeriu)...*"

Si shembull të gabimit pa qëllim mund të përmendim këtë rast: nëse dikush gjuan me armë për ta mbytur gjahun, por godet njeriun ose agjiëruesi fut ujë në gojë për të shpëlarë gojën dhe uji i shkon brenda në organizëm.

Gabimet pa qëllim janë dy llojesh:

- a. Gabimet pa qëllim, që bëhen ndaj Allahut (xh.sh.)
- b. Gabimet pa qëllim, që bëhen ndaj njerëzve.

Për gabimet pa dashje në obligimet ndaj Allahut (xh.sh.), njeriu nuk do të jetë përgjegjës para Allahut dhe nuk do të ketë kurrfarë dënimi. Nëse *muxhtehidi* gabon dhe nuk ia qëllon shpjegimit të ndonjë çështjeje të shariatit, ai nuk do të konsiderohet përgjegjës para Allahut (xh.sh.).

Përsa u përket gabimeve pa dashje ndaj njerëzve, njeriu duhet t'i kompensojë. Si p.sh., nëse besimtari e mbyt besimtarin pa qëllim, duhet të bëjë kompensimin e jo të bëhet kisas (të vritet).

DHUNA

Me fjalën dhunë në këtë kontekst, nënkuptohen ato vepra apo fjalë, që njeriu ka qenë i detyruar t'i bëjë-thotë pa vullnetin e tij.

Hanefitët e ndajnë dhunën në dy lloje:

1. Dhuna, e cila ia rrezikon jetën njeriut e që domosdo duhet ta kryejë urdhrin e dhënë.
2. Dhuna, e cila nuk ia rrezikon jetën, por njeriu është i kërcënuar për burgosje ose rrache, nëse nuk e zbaton urdhrin e dhënë.

Në llojin e parë njeriu duhet t'i nënshtrohet urdhrit, përkundër dëshirës së tij, ndërsa dhunës së llojit të dytë njeriu nuk duhet t'i nënshtrohet.



Raportet brenda Familjes

Ma. Zymer Ramadani

"Ne e kemi obliguar njeriun të sillet mirë ndaj prindërve të vet..." (Ankebut, 8)

"Asnjë prind nuk mund t'i dhurojë fëmijës së tij diçka më të çmuar se edukata".¹

Familja është bashkësi e përbërë nga nëna, babai dhe fëmijët, por nuk është vetëm kaq pak. Ajo është bashkësia më e vogël sociale, në të cilën lind, rritet, dhe zhvillohet njeriu, ku merr shkollën dhe edukatën e parë. Sado e vogël të jetë ajo, rëndësia e saj në shoqëri është shumë e madhe. Bashkësia familjare është formuar qysh me ardhjen e parë të njeriut në këtë botë. Ajo është formuar si një dëshirë e Krijuesit, që njeriu i parë të ketë një familje e jo siç pretendojnë disa sociologë se është krijuar, si rezultat instinktiv dhe i rastësishëm, në këtë botë.² Kurani i ka kushtuar thelbit familjar një rëndësi të madhe, me qëllim që nderi dhe vlera e saj të mbrohet me çdo kusht. Allahu (xh.sh.), thotë: ***"Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë."*** (Rum, 21)

Ne e falënderojmë në mënyrën më të veçantë, Krijuesin tonë, për këtë botë plot mrekulli, që Ai e krijoi për ne, me shije e pamje të ndryshme, me stinët dhe larmitë e tyre.

Të gjithë njerëzit në këtë jetë kanë një program për të cilin punojnë. Si myslimanët, ashtu edhe të tjerët

– jo myslimanët – vrapojnë dhe përpiqen të krijojnë projekte të ndryshme, në mënyrë që t'i arrijnë qëllimet e tyre. Por shtrohet pyetja: deri kur dhe deri ku në këtë mënyrë? Në çfarë niveli i kemi raportet me Krijuesin, për të vazhduar dhe zbritur në familje, me rrethin e ngushtë e kështu me radhë? Si janë raportet tona në lidhje me ata që na lindën, prindërit tanë, që na rritën, na ushqyen me sakrificë, dhe ndërprenë gjumin e tyre të natës, braktisën shumë e shumë gjëra, vetëm e vetëm që fëmija i tyre të mos ndihet i vetmuar dhe të jetojë i lumtur...?

Mirësitë dhe zhvillimet që na rrethojnë, siç duket na e kanë zbehur dhe po vazhdojnë të dëmtojnë rrjetin dhe lidhjen tonë familjare. Gjithkush mundohet të arrijë diçka, por në anën tjetër është harruar se po shkatërron dashurinë shpirtërore dhe lidhjen prindërore. Sa shumë prindër vuajnë sot nga vetmia, ngaqë fëmija i tyre i braktisi, në mënyrë që të jetojë në një ambient "modern", pa e pasur barrën e prindërve. Ata i dërgojnë nëpër qendra të ndryshme rehabilitimi, i lënë në mbikëqyrjen e spitaleve apo organizatave që merren me mbikëqyrjen e të moshuarve. Ose, e kundërta e kësaj, sa e sa fëmijë sot jetojnë nëpër rrugë dhe jetimore, ku prindi i tyre i ka braktisur, me arsyen se ai fëmijë i lindur pa dëshirën e tyre, është i tepërt dhe pengon aktivitetin e nënës apo babait. Si rezultat i kësaj, në shumë vende të botës, e kohëve të fundit edhe tek ne, janë hapur qendra për mbikëqyrjen e këtyre dy kategorive njerëzore. E para: prindërit që braktisen nga fëmijët e tyre dhe e dyta: fëmijët që braktisen nga prindërit e tyre.

T'i qasemi kësaj problematike dhe dukurie negative nga këndvështrimi kuranor dhe porositi të të Dërguarit, Muhamed Mustafa (a.s.).

A) PRINDËRIT QË BRAKTISEN NGA FËMIJËT

I gjithë problemi qëndron se shumë fëmijë, pasi

1. Tirmidhi, el-Birru, 33.

2. Prof. Dr. Ahmet Yaman, İslam Aile Hukuku, f. 12.

arrijnë një moshë dhe krijojnë një shoqëri, i harrojnë të gjitha shërbimet që i kanë bërë prindërit, kështu që arrijnë deri te ajo pikë, sa t'i braktisin ata. Për këtë shërbim kaq preciz dhe të palodhshëm që prindërit bënë për fëmijët e tyre, Allahu (xh.sh.), në Kuranin Fisnik thotë: **“Njeriun e kemi porositur të jetë i sjellshëm ndaj prindërve të vet. Nëna e mbart atë me mund dhe me mund e lind. Ai mbartet dhe ushqehet me gji për tridhjetë muaj dhe, kur arrin në moshën e burrërisë e i mbush dyzet vjet, ai thotë: “O Zoti im! Më frymëzo që të të falënderoj për begatitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur! Më dhuro pasardhës të mirë! Tek Ty kthehem i penduar dhe Ty të dorëzohem!” (Ahkaf, 15)**

Si është e mundur që t'u kthejmë shpinën dhe të braktisim prindërit tanë në vetmi, kur me një mund të madh nëna na barti në barkun e saj për nëntë muaj me radhë, babai u kujdes në mënyrë maksimale për të qëndruar afër saj, që fëmija të zhvillohet sa më mirë dhe më lehtë. Nuk e lanë vetëm me kaq, por siç u vërejt edhe nga ajeti kuranor, shërbimi për fëmijën zgjati edhe dy vite të tëra në gjidhënie, e më pas, deri në moshën dhjetë vjeçare nëna pati detyrë parësore edukimin dhe zhvillimin e fëmijës së saj. Prindërit, nga këshilla dhe urdhri i Pejgamberit (a.s.), mundohen që deri në moshën shtatë vjeç ta mësojnë atë në praktikimin e namazit, që fëmija të mos jetë pa njohuri fetare. Nëse edhe pas këtij shërbimi dhe kujdesi që kanë obligim prindërit për fëmijët e tyre, djali apo vajza i braktis ata, i dërgon në qendra kujdesi për të moshuarit, paguan shërbëtorë që të merret me ta, atëherë ç'mund të themi, përveçse Allahu ua shtoftë dashurinë ndaj prindërve?

B) FËMIJËT QË BRAKTISEN NGA ANA E PRINDËRVE

Ekziston edhe aspekti tjetër i problemeve brenda në familje, ku në këtë rast viktimë janë fëmijët e gjorë. Siç duket, luksi dhe fitimi i pasurisë në mënyrë jo të lejuar, ka ndikuar që shumë nga çiftet e martuara të vendosin për të mos pasur fëmijë. Mirëpo, kur kjo ndodh pa dëshirën e tyre, atëherë kërkojnë zgjidhje të ndryshme që të lirohen nga kujdesi për fëmijët e tyre. Një pjesë e këtyre prindërve mundohet ta gjejë zgjidhjen te aborti, një pjesë tjetër në braktisjen e fëmijës. Që të gjitha këto metoda janë të ndaluara dhe haram. Por ekziston edhe një kategori tjetër që, pasi rritet fëmija, e dërgojnë nëpër çerdhe fëmijësh, që të mos e kenë obligim kujdesin ndaj tij. Kjo ndikon në shkëputjen e dashurisë së ndërsjelltë. As fëmija nuk rritet nën mëshirën dhe dashurinë e një nëne e as nëna nuk ka një ndjenjë e duhur ndaj fëmijës. A thua këto grupe njerëzish kanë frikë furnizimin e tyre? Jo, kjo nuk duhet të ndodhë. Për këtë, Allahu (xh.sh.), ka

thënë: **“Mos i vrisni fëmijët tuaj nga frika e varfërisë! Ne u sigurojmë ushqim atyre dhe juve. Vërtet, vrasja e tyre është gjynah i madh.”**³ Në anën tjetër, nëse një fëmijë rritet në larg vatrës familjare, as ai e as prindërit nuk mund të kenë dashuri ndaj njërit-tjetrit. Transmetohet nga Aishja (r.a.): “Erdhën disa njerëz tek i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) e i thanë: ‘A i puthni ju fëmijët tuaj?’ Ai iu përgjigj: ‘Po’. (Ata) Thanë: ‘Ne, pasha Allahun, nuk i puthim!’ I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) tha: “Çfarë t’ju bëj unë ju, nëse Allahu e ka shkukur mëshirën nga zemrat tuaja”.

LIDHJA FAMILJARE PRIND – FËMIJË

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe, që të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj atyre as “uh!”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti.” (Isra, 31)

Të gjitha punët dhe veprat e mira në Islam, kanë shpërblime nga më të ndryshmet e, po ashtu, kanë dënime edhe veprat e liga. Për të pasur shpërblime çdo vepër, kërkohet që në fillim të besohet Allahu (xh.sh.) dhe të kryhen urdhrat e Tij. Pa besim, asnjë punë nuk ka ndonjë shpërblim. Pas gjithë këtij kushti që ka vendosur Allahu (xh.sh.), menjëherë ka caktuar kusht të prerë respektimin e prindërve dhe bamirësitë e tjera, siç theksohen në ajete. Prandaj, respekti dhe mirësjellja ndaj prindërve janë domosdoshmëri për çdo person. E kur ata të ndërrojnë jetë, të bëjmë dua – lutje bamirësie që Allahu (xh.sh.), t'i mëshirojë. Feja jonë e bukur nuk ka lejuar asnjëherë kërcënimin e raporteve prind – fëmijë. Ata duhet t'i respektojmë në çdo cep të jetës, përveç rastit ku na ka ndaluar Allahu (xh.sh.): **“Ne e kemi urdhëruar njeriun, që të sillt mirë me prindërit e vet dhe: “Nëse ata të nxisin ty që të më shoqërosh Mua (në adhurim) atë, për të cilin ti nuk di asgjë, atëherë mos i dëgjo ata.”**⁴ Dhe më në fund, pas çdo respekti që u bëjmë prindërve, duhet bërë lutje bamirësie për ta, kur ata të jenë gjallë apo kur të ndërrojnë jetë. Të përkujtojmë se ata na mbështetën, kur ne ishim të pa aftë për asgjë, kur ne qanim ata ishin pranë nesh, na bartën në kraharor dhe na ofruan çdo mundësi që të na bëjnë të lumtur.

Të gjitha modelet e tjera familjare, që dalin jashtë kornizave dhe urdhrave kuranore, do të përballen me probleme të llojeve të ndryshme. Modeli familjar i shfaqur nëpër televizione, nuk mund të jetë model i myslimanëve. E huaja le të mbetet gjithmonë e huaj dhe asnjëherë të mos bëhet pronë e jona.

3. Isra, 31.

4. Ankebut, 8.



ARMIKU I VËRTETË I ISLAMIT DHE MYSLIMANËVE ËSHTË INJORANCA

Ma. Muhidin Ahmeti

"Kush dëshiron lavdi e pushtet, ta dijë se e gjithë lavdia e pushteti i takojnë Allahut. Tek Ai ngjiten fjalët e bukura, ndërsa veprën e mirë Ai e ngre Vetë. Sa i përket atyre që kurdisin të këqija, ata do të kenë dënim të rëndë dhe dredhitë e tyre do të dështojnë."
(Fatir, 10)

"Në kushtet e sotme të jetës zotëron ky ligj absolut: Ajo racë që nuk i vlerëson talentet e veta, është e dënuar me shkatërrim... Sot ne e çojmë përpara jetën tonë, por nesër shkenca do të shkojë edhe një hap më përpara e për fatin e njerëzve analfabetë nuk do të ketë mëshirë." (Alfred North Whitehead)

Në kohët e vështira të ditëve tona, në këto kohë kur vala e materializmit vrastar ka pushtuar shpirtat e dëshpëruar të njerëzve, te të cilët është zbehur dhe dobësuar besimi në Zotin dhe shpresa në mëshirën e Allahut (xh.sh.), në mënyrë të veçantë duhet bërë kujdes që kjo epidemi e rrezikshme të mos rrënojset në masë. Me kujdesin më të madh, nga ky rrezik duhet të ruajmë rininë tonë myslimane, shpresën e Kosovës, shpresën e Islamit në Kosovë dhe nuk duhet lejuar që kjo epidemi e rrezikshme që na ka kapluar ne më të vjetërve, të fillojë t'i shkatërrojë radhët e rinisë. Edhe pse mendoj se virusi i epidemisë së xhunglës ka filluar t'i prekë edhe ata, megjithatë besoj se ende ka kohë derisa nuk është bërë shumë vonë.

Për të pasur siguri dhe garanci për ruajtjen e identitetit të gjeneratës së ardhshme janë dy elemente të pandashme që njëkohësisht janë edhe alternativa e shpëtimit tonë dhe fëmijëve tanë. Ato janë besimi (edukata) dhe arsimimi (dituria).

Besimi paraqet ikje nga dimri i ftohtë dhe i errët i materializmit drejt dritës së diellit pranveror të besimtarit. Ai do të thotë jetë dhe shpresë për të ardhmen.

Njeriu pa shpresë është depresiv dhe i trishtuar. Bota bashkëkohore, që përpëlitet në vorbullën e mosbesimit e të nihilizmit është një botë e tjetërsuar nga Zoti dhe tekembramja e tjetërsuar edhe nga vetvetja. Jo vetëm që e ka humbur Zotin, por ka humbur edhe veten. Prandaj, sot si asnjëherë më parë, i duhet rinisë sonë besimi në Zotin e Madhërishëm për t'ia kthyer asaj besimin në vetvete, për t'i lidhur hallkat e ekuilibrit në jetën e individit dhe të shoqërisë. Ai është identiteti më madhështor i njeriut si vazhdimësi e mbamendjes së shpirtit, ndërsa dija është e drejta më e madhe e njeriut si kërkesë për liri.

Prandaj, të besosh sot, do të thotë të dish se gënjeshtria nuk është e vërtetë; se errësira nuk është dritë; që e keqja nuk është e mirë; që dhuna nuk është drejtësi; që paarsyeshmëria (marrëzia) nuk është urtësi. Të besosh, pra, është të kthjellohesh, të zgjohesh nga gjumi letargjik, të vetëdijësohesh dhe t'i shohësh gjërat me syrin e besimit, me syrin e shpirtit. Pejgamberi (a.s.), ka thënë: ***"Njerëzit janë në gjumë, kur vdesin zgjohen."*** Ndërsa ajetet vijuese përshkruajnë shumë qartë gjendjen e mësipërme: ***"Nuk janë, kurrësi, njësoj i verbëri dhe ai që sheh, as errësira dhe drita, as freskia (e hijes) dhe vapa. Po ashtu, nuk janë kurrë të barabartë të gjallët dhe të vdekurit."*** (Fatir, 19-22)

Të besosh, do të thotë të dish se besimi është çështje publike e mosbesimi çështje private. Nuk ka popull në histori, që nuk ka pasur besimin e vet, kulturën e vet dhe traditat e veta. Besimi nuk mund të imponohet me dhunë, për arsye të faktit se besimi i vërtetë në thelbin e vet është i natyrshëm. Mosbesimi imponohet me dhunë (siç e bëri komunizmi), sepse është i panatyrshëm.

Ndërsa të dish, do të thotë të besosh se Zoti i ndihmon ata që e ndihmojnë veten e tyre, që Zoti nuk do

ta ndryshojë gjendjen e një populli, përderisa ai vetë nuk përpiket.

Të dish, do të thotë të besosh se dituria është pasuri që s'mund të plaçkitet, se dituria është dhuratë e Zotit, e cila duhet ruajtur; se dituria është lumturi të cilën s'guxojmë ta humbasim; se dituria është siguri dhe investimi i jetës; se dituria është pushtet dhe fuqi, që sjell paqen dhe lirinë.

Nga kjo kuptojmë se nuk ka gjë më të fuqishme se dituria, mbretërit sundojnë popujt, por dijetarët sundojnë mbretërit. Një dijetar është më i fuqishëm kundër shejtanit se njëmijë njerëz të devotshëm. Dituria mund t'i lëvizë malet dhe asnjë forcë në botë nuk mund ta mposhtë atë.

Ndihem i paaftë t'i përmend të gjitha veçoritë e dijes. Dija, mësimi është dritë, që të ruan nga verbëria. Dituria është maja e malit, që ofron mbrojtje dhe kushdo që strehohet dhe ngryset në gjirin e saj, është i sigurt nga fatkeqësia. Dituria (të mësuarit) të shpëton, deri sa bota të përmbysset. Mbështetu tek ajo edhe kur shpirti është duke të dalë. Kush e dëshiron dhe e kërkon diturinë, do të plotësojë shumë dëshira. Në qoftë se e nxë, i ka realizuar të gjitha qëllimet. O mendje! Dituria është në pozitë të lartë e Zoti yt. Nëse e merr atë, nuk ka rëndësi pozita as pushteti i tokës.

Mbajeni në mend si myslimanë: armiku i Islamit nuk është as Perëndimi as Lindja. Armiku i vërtetë i Islamit është xhahilijeti, padituria, injoranca, është konfuzioni dhe topitja (letargjia), është mosinformimi dhe indiferentizmi i myslimanëve karshi dukurive dhe ngjarjeve që u përkasin vetë atyre e pastaj besimit të tyre, kulturës dhe politikës, etj.

Prandaj, armiku i vërtetë i Islamit është egoizmi, smira dhe përtacia e shpirtit të ulemasë, mospërdorimi i arsyes së intelektualëve dhe qëndrimi pasiv i studentëve ndaj së ardhmes së tyre vetjake.

Dituria zbulon pasurinë e besimit, ndërsa besimi nxit dëshirën për dije. Me shtimin, zgjerimin e horizontit të diturisë forcojmë besimin, fenë, dhe i zbulojmë sekretet e jetës kështu bëhemi të aftë të jetojmë në pajtim me urdhrat e Zotit (xh.sh.).

Por, që të jetojmë në pajtim me urdhrat e Zotit (xh.sh.), duhet të armatosemi me armën më të fuqishme që na e dhuroi Vetë Ai. Ajo është dituria, dituria për individin, familjen dhe kombin. Popujt, të cilët shpesh historia nuk i ka përkëdhelur, sikurse jemi ne shqiptarët, me kufijtë tanë të përgjakshëm, me shtetet fqinjë që nuk na e duan të mirën, duhet t'i mbledhim të gjitha forcat, që nga venat e këmbës deri te damarët e qafës, bashkë me të edhe fuqinë e kokës e të trurit, që të vijmë

te gjallëria, që me ndonjë gisht sekret të Zotit ripërtërihet. Para së gjithash, neve na duhet një ripërtëritje e mendimit, shpirtit dhe mentalitetit. Na duhet lindja e përgjegjësisë së mendimit, shpirtit dhe qëndrimit ndaj jetës. D.m.th. asgjë nuk do të ndryshojë në jetën tonë, po që se ne nuk fillojmë vetë ta çajmë detin e pastaj Allahu do të na hapë jo dymbëdhjetë, por dymbëdhjetë mijë rrugë dhe po aq mënyra për të na shpëtuar.

Jemi bindur se të dobët i duhet fuqia e jo mëshirimi e keqardhja. Kjo tregon se ripërtëritja jonë duhet të jetë në mendje e fuqi e jo në lot e vaj. Xhiahadi ynë nuk duhet të shkojë rrugëve të shkatërrimit, urrejtjes e vrasjes së njerëzve, por rrugëve të mësimi e të ndërtimit. Shpata e Islamit është penda (lapsi). Zoti është betuar në lapsin dhe atë që shkruhet me të. Shpallja e besimit islam filloi me fjalën "mëso (lexo)".

Islami nuk ka nevojë për shpatën. Shpata paraqitet atje ku nuk është e pranishme logjika. Mirëpo, karshi nesh nuk janë gjithmonë luftëtarët e logjikës. Për këtë arsye, kur është fjala për përdorimin e shpatës, Islami është realist e jo idealist. Ideale do të ishte të thyeshin të gjitha shpatat, mirëpo, a është e mundur diçka e tillë...?

Prandaj, neve na duhet dija, mësimi, zhvillimi, krijimi i kushteve dhe realizimi i fuqive të mëdha të dynjallëkut. Të kesh shumë dynjallëk, nuk do ta dëmtonte aspak vendin dhe pozitën tonë në Ahiret, vetëm nëse me atë dynjallëk do të dinim çfarë të bënim. Çështja e të gjitha çështjeve, jo vetëm për shqiptarët, por edhe për popujt e tjerë myslimanë, është se a do t'i bëjnë ata më në fund vetes një vend dinjitoz në botën bashkëkohore. Nuk është blasfemi (gjynah) të thuash që shkalla e tyre në atë botë do të varet nga shkalla e tyre e kësaj.

Dhe së fundi, o Zot i Mëshirshëm forcoje besimin në zemrat tona! Udhëzoji në rrugë të mbarë familjet tona! Forcoje unitetin në xhematet tona! Forcoje paqen në atdheun tonë! Shpejtoje lirinë e plotë dhe pavarësinë e shtetit të Kosovës! Jepi fuqi Umetit tonë! Zot i Mëshirshëm! Jepu të sëmureve shëndet! Fukarenjve furnizim! Të persekutuarve kthim në shtëpitë e tyre! Të burgosurve lirinë! Mbrojtësve tanë (ushtrisë sonë të ardhshme) ndihmë e forcë! Pasuroji të parët tanë (liderët) me urtësi dhe guxim! Ulematë tanë me dituri dhe sineritet! O Allah i Mëshirshëm! Fisnikëroji të gjithë njerëzit me dashuri e mëshirë! Pastroji zemrat e njerëzve nga smira, urrejtja dhe e keqja! O Zot, pashë mirësinë Tënde të pakufishme, dhuroji gjithë botës udhëzimin dhe mëshirën Tënde!

Amin!



“GJITHÇKA QË PRISH UNITETIN SHOQËROR, ËSHTË E PAVLERË.”



Zalm Lakti

Sa më tepër e kuptojmë realitetin e botës, aq më të mirëpërgatitur jemi të ballafaqohemi me të. Sa më qartë e vështrojmë botën si një vend të mbushur plot e përplot me propagandë, mashtrime, parashikime të gabuara e iluzione dashakeqe, aq më të gatshëm e të aftë do të jemi të përcaktojmë rrugët e drejta dhe të provojmë në mënyrë të prerë, të shëndoshë e të mençur. Në qoftë se futemi thellë në histori, do të gjejmë beteja të përgjakshme fetare, si në lashtësi ashtu dhe në dekadat e fundit, kryqëzatat në Mesjetë, nata e Shën Bartolomeut (lufta mizore mes katolikëve e protestanëve në Francë). Shembulli i fundit është lufta në Bosnje. Po ashtu dhe në pjesën tjetër të botës, lufta e Izraelit mbi Palestinën autoktone. Kjo e fundit po bëhet edhe në syrin e ndërkombëtarëve të civilizuar, të cilët nga ana e tyre po e mbyllin njërin sy, e për të vazhduar me Pranverën Arabe, e cila po përhapet me shpejtësi.

Po shoqëria shqiptare, a ka qenë e kërcënuar nga fenomene të tilla?

Dukuri të tilla kanë qenë shumë të pakta¹ në shoqërinë shqiptare, për të mos thënë se nuk ka pasur. Shqiptarët kurdoherë kanë shpalosur vlerat e bashkëjetesës e të tolerancës. Rasti i shqiptarëve është një shembull i mirë për të gjithë ata dhe duhet të shërbejë si një simbol i tolerancës fetare për të gjitha vendet e

tjera.² Këtu vlen të përmendet se në bibliotekën aktuale të Ministrisë së Drejtësisë gjenden vendime të dhëna në bazë të sheriatit dhe të së drejtës kanonike, të cilat arsyetimin e tyre e referonin në gjykatat Egjiptiane e ato të Vatikanit.

Duke e parë çështjen në këtë pikëpamje, vështirë të mendohet e të pranohet se ka pasur konflikte për motive fetare mes shqiptarëve. Edhe pse ka pasur një tendencë të vazhdueshme nga qarqet e ndryshme shoviniste (serbe, malazeze e greke).

“Islamizmi dhe Katolicizmi u bënë dy barriera shumë të fuqishme për të ruajtur individualitetin dhe vetëdijen kombëtare të shqiptarëve, që kombi ynë të mos pësonte fatin e vllahëve, të cilët janë asimiluar prej fundamentalizmit ortodoks ballkanik.”³ Feja në Shqipëri nuk ka shërbyer vetëm si mjet bashkëjetese e harmonie në shoqëri, por edhe si forcë kundër asimilimit të kulturës e traditës shqiptare.

Ndërsa rasti i qarqeve sunduese serbo-malazeze pas luftërave ballkanike për kthimin në masë të shqiptarëve myslimanë me dhunë në ortodoksë prosllovë nuk pati sukses. Është një fakt që diversiteti fetar luajti rol të rëndësishëm në ruajtjen e kufijve, kurse nga ana e shqiptarëve asnjëherë nuk pati rast të veprimeve të tilla mbi pakicat sllave apo greke në vendin tonë.⁴

Historia e Shqipërisë është bërë bashkarisht si nga

1. Është vetëm rasti, kur pas ardhjes së Princ Vedit në krye të Shqipërisë një pjesë e myslimanëve shqiptarë u ngritën kundër me pretekstin se ai ishte i krishterë e ata nuk e donin si udhëheqës. Edhe pse nuk pati ndonjë konflikt të hapur të armatosur, pjesa më e madhe e studiuesve nuk e marrin në konsideratë, sepse nuk dihet me siguri nëse këto ishin arsye të vërteta apo jo.

2. Ismail Kadare, “Identiteti evropian i shqiptarëve”, Tiranë, 2006, fq. 28

3. Kasem Bicoku, “Falangat që rrezikojnë kombin shqiptar”, Tiranë, 1999, fq. 71-72

4. Gazmend Shpuza, “Kuvendime për historinë kombëtare”, Tetovë, 2000, fq. 42

myslimanët ashtu edhe të krishterët, secili prej grupeve është munduar të luajë rolin e vet.” Ndryshe nga popujt e tjerë të Ballkanit, feja nuk identifikohet me kombin. Shumë lidhje, në një mënyrë ose në një tjetër, i kapërcenin kufijtë e fesë, për shembull, malësorët katolikë dhe myslimanë të Veriut jetonin në të njëjtën shoqëri fisnore dhe jeta e tyre rregullohej prej të njëjtave ligjeve.⁵

Pas ardhjes në pushtet të komunistëve, gjërat ndryshuan. Si në të gjithë botën dhe në Shqipëri filloi të cenohej bashkëjetesa, për shkak të ndikimit të një ideologjie njerëzore, e cila nuk pranonte të tjerë përveç vetes. Filloi prishja e tempujve të të dy feve të mëdha, Islamit e Krishtërimit.

Kjo solli një kataklizmë të vertetë, madje edhe regres për vlerat e shoqërisë sonë. Filloi të shfaqej haptas antipatia ndaj fesë, gjë e cila normalisht sillte destabilitet, mungesë të tolerancës fetare. Në termat e kohës kjo quhej intolerancë civile. Ata që bëjnë dallime mes intolerancës⁶ civile dhe intolerancës teologjike, gabohen. Kudo që është pranuar intoleranca teologjike, ka qenë e pamundur që ajo të mos ketë pasuar efekt civil dhe, sapo ka një efekt të tillë, sovranit nuk është më sovran, madje as në fushën laike.⁷

Tashmë nuk mund të dallohet kush është populli, sovranit apo Zoti sovran. Marrëdhënia mes të sunduarve dhe sunduesve kishte humbur plotësisht. Nuk respektohej asnjë limit i të drejtave themelore të njeriut⁸.

“E drejta që pakti social i jep sovranit mbi shtetasit, nuk i kalon kufijtë e dobisë publike. Pra shtetasit i japin llogari sovranit për opinionet e tyre vetëm në atë masë që këto opinione kanë rëndësi për besnikërinë. Mirëpo, për shtetin ka shumë rëndësi që çdo qytetar të ketë një fe, e cila ta bëjë të dojë detyrat e veta.”⁹ Sekretit i lumturisë nuk është të bësh gjithmonë atë që dëshiron, por, të duash gjithmonë atë që të takon të bësh.

Feja ndihmon vullnetin e përgjithshëm në një shoqëri, asnjëherë nuk e shkatërron atë. Për këtë arsye, ajo

duhet t’u lihet e lirë individëve, madje ajo shumë herë duhet dhe të mbrohet.¹⁰

Duke mos ekzistuar kjo, feja normalisht që do sillte mungesë të qëndrueshmërisë së sistemit. Një njeri mund ta gënjejë gjithë kohës, por këtë nuk mund ta bësh kurrë me një popull të tërë. Si çdo sistem tjetër totalitar edhe ky do ta kishte gurin e fundit. Rënia e tij do të mbyllte një kapitull të vjetër për të hapur një të ri në faqen e historisë së kombit shqiptar.

Tani që nuk ka dhunë, nuk mund të ketë më fe kombëtare ekskluzive, duhet të lejohen të gjitha ato fe që lejojnë fetë e tjera, për aq kohë, sa dogmat e tyre nuk kanë asgjë të kundërt me detyrat e qytetarit.”¹¹ Pikërisht kjo ndodhi në Shqipërinë e pas viteve ’90-të. Tashmë, shoqëria e kishte të qartë se: “Feja nuk mund të shërbejë kurrë si arsye për konflikt.”¹²

Ndërsa shteti u bë laik, por gjithnjë e vendosi lirinë e fesë në piedestalet më të larta kushtetuese. Ai tashmë e kishte të qartë rëndësinë e fesë dhe bashkëjetesës mes komuniteteve.



“Në radhë të parë, “bashkëjetesa fetare”, e cila ka qenë kurdoherë e pranishme në traditën shqiptare, është afirmuar përkrah disa parimeve të tjera të mëdha, të cilat Kushtetuta (1998) i përcakton si bazat e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë (neni 3). Kështu, ajo është renditur krahas parimeve të tjera të rëndësishme, si të drejtat dhe liritë e njeriut, pluralizmi, rendi kushtetues, bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat kombëtare. Fakti që kushtetuta aktuale nuk njihet zyrtare dhe nuk privilegjon asnjërin nga fetë, krijon mundësi për “barazi midis komuniteteve fetare.” (art 10/3)”¹³

Toleranca jonë duhet të vijë jo nga përbuzja apo shfaqja e fesë, tendencë që po shfaqet dita-ditës e më shumë, por ajo duhet të burojë nga vlerat e parimet që çdo fe ka për të respektuar besimtarët e feve të tjera. Vërtet, PAQJA nuk është paqe pa drejtësi, prandaj s’mund të mendohet e ndarë nga drejtësia dhe gjithmonë duhet të jetë e ushqyer me mëshirë dhe me dashuri, që janë vlerat e tri feve botërore universale monoteiste.¹⁴....Por a do mundemi vallë ta ruajmë këtë ekuilibër duke respektuar parimet fetare e duke mos cenuar paqen njëkohësisht?

5. Bernd J. Fischer, “Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri”, Tiranë, 1996 Fq.53

6. Intolerancë: Sektarizëm, tendenca për të mos lejuar, madje për të dënuar atë që nuk të pëlqen në mendimet dhe në qëndrimet e të tjerëve.

7. Ide e Zh. Rusoit

8. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 1998.

Neni 3: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë.”

9. “Zhan ZhakRuso, “Kontrata Sociale” Tiranë 2011, fq. 169

10. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998), neni 24

11. Zhan ZhakRuso, “Kontrata Sociale”-. Tiranë 2011, fq. 170

12. BardhylUkcamaj, “Qytetërimi kundër terrorizmit”. Neë York 2001, fq. 54

13. A. Omari, A.Anastasi, “E drejta kushtetuese”, Tiranë, 2010.Fq. 135

14. Fe hyjnore që besojnë vetëm në një Zot.

Ebu Rejhane El-Ezdi

njeriu i dijes, adhurimit dhe xhibadit

Mustafa Erish

Zemra e Ebu Rejhanes (r.a.), ishte e mbushur plot me dëshirën për xihad. Gjithashtu, ai ishte edhe një sahab i dashuruar me dijen! Kështu hyri në grupin e sahabëve të Sufes dhe mori dituri, urtësi dhe udhëzim prej Resulullahut (a.s.). Ishte shumë i përkushtuar ndaj adhurimit dhe njihej për devotshmërinë dhe besimin e tij të sinqertë.

Vinte prej fisit Ezd. Emri i tij i vërtetë ishte, Them'un Ibni Jezid el-Ezdi. Më vonë u bë i njohur me emrin Ebu Rejhane (babai i Rejhanës), për shkak se kishte një vajzë me këtë emër.

Në lidhje me çështjen se ku dhe si u bë mysliman Ebu Rejhane (r.a.), ka transmetime të ndryshme. Megjithatë, transmetohet se ai u nderua me Islam në qytetin e Medinës. Kur u ndërtua Mesxhidi i Profetit (a.s.), ai qëndroi në pjesën e quajtur Sufe dhe nuk u nda asnjëherë prej Resulullahut (a.s.). Prej tij mësoi dituri e urtësi dhe së bashku morën pjesë në shumë beteja. Në librat e hadithit, gjenden pesë hadithe të transmetuara prej tij.

Ebu Rejhane (r.a.), e kishte shumë pasion leximin e Kuranit. Edhe pse me vështirësi, ai mendohej të lexonte. Mirëpo, për shkak të një problemi në të folur, nuk mund të lexonte ashtu siç i dëshironte zemra. Kjo gjendje ia brente shumë shpirtin. Një ditë, shkoi tek Resulullahu (a.s.) dhe ia shfaqti problemin e vet me këto fjalë:

"O Resulullah! Kam shumë dëshirë ta lexoj Kuranin, por e kam të vështirë" - tha ai. Resulullahu (a.s.), i tha: "*O Ebu Rejhane! Mos e detyro veten tënde me gjëra për të cilat nuk ke fuqi! Ti vazhdo të bësh sexhde!*" (Isabe, III, 289-290.)

Ebu Rejhane (r.a.), ishte një trim, i cili në fushat e betejave luftonte si luan, ndërsa në kohë paqeje merrej gjithmonë me adhurim, dhikër, mësim diturie

dhe meditim. Netëve falte namaz për një kohë të gjatë. Kur ishte në kijam¹ lexonte sure të gjata dhe sa mbaronte një sure, kalonte te tjetra. Në këtë mënyrë i mbante gjallë netët e tij.

Ibën Mubarek, në librin e tij "Zuhd", shprehet kështu në lidhje me mënyrën e të jetesës së Ebu Rejhanes (r.a.):

"Një mbrëmje, erdhi në shtëpinë e tij pasi ishte kthyer nga një betejë. Pasi hëngri bukë, mori abdest dhe filloi të falte namaz në një qoshe të shtëpisë. Namazin e falte me sure të gjata. Pasi mbaronte një sure, kalonte tek tjetra. Në këtë mënyrë, i përqendruar dhe me shpirt të qetë, fali namaz deri në mëngjes. Kur u thirr ezani i sabahut, fali namazin dhe shkoi pranë gruas së tij.

Gruaja, e habitur jashtë mase me gjendjen e tij, e mërzhitur, i tha: "O Ebu Rejhane! Ti sapo erdhe nga lufta. Edhe lufta, edhe lodhja e rrugës, edhe ndarja!.. Po të drejtat e mia? A nuk kam unë vlerë për ty?"

Ebu Rejhane (r.a.), me shumë sinqeritet dhe me zemër të pastër, i tha: "Patjetër që ke të drejtat e tua dhe për mua ke vlerë të madhe. Mirëpo të betohem, se nuk më erdhe fare në mendje. Po të më kishe ardhur në mendje, nuk të kisha lënë kurrë pas dore".

Gruaja e tij u habit edhe më shumë prej përgjigjes së tij dhe e pyeti të shoqin: "O Ebu Rejhane! Ç'është ajo gjë që ta mori mendjen kaq fort?"

Ebu Rejhane, përsëri me mendim dhe ndjenja të pastra iu përgjigj me fjalë që i buronin prej zemrës: "Në ajetet që lexova gjatë namazit, përshkruhej xheneti. Mirësitë e tij, bukuritë dhe hijeshitë më morën dhe më shpunë në xhenet. Kjo gjendje kënaqësie vazhdoi deri sa dëgjova ezanin e sabahut". (Isabe, III, 289-290.)

1. Kijam: Qëndrimi në këmbë gjatë namazit.



Ebu Rejhane (r.a.), së bashku me Resulullahun (a.s.), mori pjesë në shumë beteja. Ai na i tregon kështu ato që i kishin ndodhur në njërën prej tyre:

“Bënte një i ftohtë shumë i madh. Për t’u mbrojtur nga të ftohtit, hapëm gropa dhe u futëm brenda tyre. Askush nuk mbeti jashtë. Kur Resulullahu (a.s.), kur e pa këtë gjendje, tha:

“Kush do bëjë roje sonte? Unë do t’i lutem Allahut që ta begatojë atë me cilësi të larta”. Dikush prej Ensarëve u hodh dhe tha: “Unë, o Resulullah!”. Resulullahu (a.s.), i tha: “Afrohu!” dhe e pyeti: “Kush je ti?” Pas kësaj bëri shumë dua për të.

Kur i dëgjova duatë që bëri Resulullahu (a.s.), dola nga gropa ku isha strukur dhe thirra:

“O Resulullah! Edhe unë do të bëj roje.” Resulullahu më tha: “Po ti kush je?” “Jam Ebu Rejhane!” - i thashë. Pastaj Resulullahu (a.s.), bëri dua për mua, edhe pse jo aq sa ç’bëri për Ensarin. Pas kësaj, Resulullahu (a.s.), tha: “Xhehenemi nuk mund ta djegë syrin që bën roje në rrugë të Allahut.” (Nesai, Xhihad 10; Musned, IV, 134.)

Në një transmetim tjetër, Ebu Rejhane (r.a.), dëshmon se e ka dëgjuar Resulullahun (a.s.), duke thënë:

“Zjarri i xhehnemit është haram për syrin që rri pa gjumë në rrugë të Allahut. Zjarri i xhehnemit është haram për syrin, i cili loton nga frika e Allahut. Zjarri i xhehnemit është haram për syrin, i cili u kthen shpinën harameve dhe nuk i sheh ato.” (Nesai, Xhihad 10; Musned, IV, 134.)

Në një tjetër prej haditheve që ka transmetuar Ebu Rejhane (r.a.), thuhet:

“Ai që qan prej ndjenjës së përgjegjësisë që ka para Allahut (prej frikës së Allahut), nuk do të hyjë në xhehnen, ashtu si qumështi i mjelë nuk kthehet

përsëri në gji. Pluhuri që bie mbi atë i cili punon e përpiqet për të forcuar fenë e Allahut në tokë, nuk do të bashkohet kurrë me tymin e xhehnemit.” (Nesai, Xhihad: 9; Ibën Maxhe: Xhihad: 64.)

Ebu Rejhane (r.a.), e kishte mbushur zemrën e tij me dije, adhurim dhe përpjekje të jashtëzakonshme. Në kohën e Omerit (r.a.), mori pjesë në çlirimin e Damaskut dhe për një farë kohe qëndroi aty. Më vonë, shkoi dhe u vendos në Bejtu’l Mukades (Kudus).

Për sa kohë qëndroi në Kudus, vazhdimisht mbante ligjëratat për popullin. Gjatë gjithë jetës, jetoi me devotshmëri të lartë. Ai nuk e braktisi kurrë xhihadin, thirrjen nw fe dhe udhëzimin për në rrugën e drejtë. Mori pjesë në çlirimin e Egjiptit dhe në luftërat që u zhvilluan në zonat kufitare, si Mejafarikini dhe Askalani. Njëherë, iu kujtua se nuk i kishte paguar paratë e kapistrës që kishte blerë në Mejafarikin. U kthye përsëri në atë qytet, që ishte 12 milje larg kalasë së Ristinit dhe pagoi borxhin që i kishte tregtarit. (Isabe, III, 291.)

I pëlqente të vishej pastër, bukur dhe me rroba të reja. Një ditë, dëgjoi se Resulullahu (a.s.), kishte thënë: “Kush ecën duke e tërhequr rrobën zvarrë, Allahu nuk do t’ia shohë fytyrën atij”.

Ebu Rejhanen (r.a.), nuk e mbajti vendi dhe e pyeti Resulullahun: “O Resulullah! Vallahi unë kam dëshirë të vishem bukur. A është kjo shenjë mendjemadhësie?” Resulullahu (a.s.), iu përgjigj:

“Allahu është i bukur dhe e do të bukurën. Ai dëshiron ta shohë mirësinë e Tij tek rob i Tij. Mendjemadhësi është nënvleftësimi dhe kthimi i shpinës ndaj së vërtetës. Gjithashtu, t’i tallësh njerëzit për ato që bëjnë, duke bërë shenja me sy e me vetulla.” (Ebu Daud, Libas 14; Tirmidhi, Edeb 45.)

Ebu Rejhane (r.a.), pjesën e fundit të jetës e kaloi në Kudus, ku edhe ndërroi jetë. Allahu qoftë i kënaqur prej tij dhe na e bëftë të mundur të përfitojmë prej jetës dhe moralit të tij të lartë.

Amin!..

Meditim dhe mall

pranë Malit Theur, Arafatit dhe Malit Nur...

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër



NË VIJIM TË KUJTIMEVE TË UMRES 1-7 MARS 2013...

Atë ditë, të gjithë ishim gati për të bërë një ndër vizitat më të bukura, që mund të zhvillohen gjatë një qëndrimi njëjavor në vendet e shenjta. Do të preknim nga afër vendet dhe hapësirat e kompleksit të haxhit. Natyrshëm, emocionet nuk do të ishin të njëjta për krejt pjesëtarët e grupit. Haxhilerët në mesin e tyre, ata që kohë më parë e kishin shkelur këtë tokë të veshur me ihramin e adhurimit, do të përjetonin nostalgji e kujtime nga ditët më të bukura të jetës së tyre, ato të haxhit. Umrexhitë, që shkelnin për herë të parë në këto vende, do të luteshin që Zoti t'ua bënte të mundur edhe kryerjen e haxhit dhe rikthimin në këtë vend, në një kohë e një realitet ndryshe nga i sotmi...

Udhërrëfyesi i grupit, vëlla Hamzai lajmëroi se fillimisht do të ndalonim për të parë nga afër një mal, në majë të të cilit shiheshin aty-këtu disa vizitorë. Ndërkohë, në sheshin përreth tij, grupe nga shtete të ndryshme, të tubuar afër njëri-tjetrit merrnin e jepnin me guidat e tyre dhe bënin me shenjë drejt majës së malit...

"Ky është Mali Theur, vendi ku u strehua profeti i Allahut, së bashku me mikun e tij besnik, Ebu Bek-

rin (r.a.), rrugës për në Medine, në ditët e hixhretit" – tha vëlla Hamzai, që vazhonte të shpjegonte me plot patos një ndër ngjarjet më të spikatura të besnikërisë dhe sakrificës në rrugën e mbrojtjes së Resulull-llahut (a.s.), që janë arkivuar në librat e historisë islame.

Në atë vend, të gjithë qëndronim në heshtje dhe sillnim nëpër mend ato momente të vështira për jetën e Pejgamberit tonë dhe mikut të tij besnik. Kujtonim gjithashtu besnikërinë dhe sakrificën e të riut Ali ibn Ebi Talib (r.a.), që kishte pranuar të flinte në shtratin e Profetit, teksa ai kishte dalë muhaxhir drejt Medines. Atë natë, Aliu (r.a.) edhe mund të vritej në vend të Zotërisë së bijve të Ademit, ashtu si Ebu Bekri në shpellën e Malit Theur... Dhe historia, me dëshmitë e veta fisnike, vinte e përplasej mu aty, para duarve tona, si një dallgë e lehtë, zhurma e së cilës të bën përherë të meditosh e të hysh në një botë mendimesh pafund...

Ndonëse ishte një ditë me diell, që qëndronte thuajse pingul mbi kokat tona, historia e Malit Theur dhe mbrojtja hyjnore ndaj personit të Hz. Muhamedit (a.s.) dhe mikut të tij besnik, na kishte shtangur, teksa dëgjonim a sillnim nëpër mend fragmente të dëshmuara të kësaj historie... Hera-herës ngrinim

kokën për të parë lart vendin e strehimit, por rrezet e diellit nuk na lejonin të shihnim si duhet. Sikur mbronin me xhelozitë dritën e asaj ngjarjeje dhe prej saj merrnin dritë, që e shpërndanin me butësi mbi fytyrat tona...

NË ARAFAT, VEND-TAKIMI I PRINDËVE TANË TË HERSHËM...

Jo shumë larg Malit Theur nis të dalë në pah hapësira pa fund e kompleksit të haxhit. Minaja, Arafati, Muzdelifeja, Xhemeratet, janë thujse aty, para syve tanë, në një hapësirë të madhe, që në ditët e haxhit numëron me miliona vizitorë që vijnë për të përmbushur ritet e një prej pesë shtyllave të fesë islame.

Pikësynimi i grupit është kodra e Arafatit, vendi ku, sipas transmetimeve të historisë islame, janë takuar prindërit e krejt njerëzimit, Hz. Ademi dhe Nëna e jonë Hz. Hava, pas dëbimit...

Si për dëshirën tonë, në këtë kohë maja e Arafatit është thujse e zbrazët nga vizitorët e haxhit. Normalisht, përveç nesh, aty kanë ardhur edhe grupe të tjera nga vende të ndryshme të botës, që sikurse ne kanë dëshirë të ngjiten në majë të kësaj kodre, ku qëndron edhe pika më e lartë e saj, ajo e takimit...

Pas shpjegimeve dhe udhëzimeve të radhës, ngjitemi njëri pas tjetrit, duke ndjekur rrugën më të përshtatshme, deri në majë, prej ku i gjithë kompleksi i haxhit duket se qëndron para duarve tona.

Është një emocion i madh, që të shoqëron në çdo hap. Teksa mendon vuajtjen dhe takimin e dy prindërve të hershëm, lutesh që Zoti të të japë mbarësi dhe kurajo në jetë, për t'u përballur me vështirësi e peripeci të ndryshme, gjithmonë me besim dhe dorëzim para vullnetit të Tij, Zotit Një, Krijuesit Fuqiplotë!

Aty, mbi Arafat, si pa kuptuar nis e mendon për jetën, për atë që ishte dhe si je e kush je. Mendon për dhuntitë pa fund, me të cilat Zoti ka zbukuruar jetën tënde dhe thua me vete: "Po unë, sa herë e kam shkelur deri më sot urdhrin e Zotit tim? Sa herë nuk më ka parë aty ku më ka kërkuar? Sa herë më ka dërguar aty ku më ka ndaluar? Sa herë më ka mbuluar, teksa në gabime e kam thyer fjalën e Tij? Sa herë më

ka falur e sa herë, sërish kam gabuar? Sa herë jam vonuar për t'u përgjigjur thirrjes së Tij? Sa herë kam ngurrar për ta bërë të mirën që më ka kërkuar? Sa herë...? Sa herë...?"

Dhe teksa vështron në heshtje majën e kodrës, lutesh me zemër që Allahu të t'i falë gjynahet dhe gabimet, ta udhëzojë zemrën tënde drejt Teuhidit absolut e të t'i udhëzojë gjymtyrët drejt veprimit sipas dashurisë së zemrës... Aty, si i strukur në një botë reflektimi e pendimi, përsërit me vete lutjen e Musait (a.s.): "Zoti im, me krejt të mirat që më ke zbritur, unë jam i varfër dhe nevojtar për Ty!" dhe zemërthyer kërkon falje në heshtje...

ME SY DHE ZEMËR NGA HIRAJA DHE MADHËSHTIA E SAJ...

Po ktheheshim nga zona e Arafatit, kur në horizont, një kreshtë mali më tërhoqi zemrën, si një forcë magnetike e padukshme e, ajo, si një fëmijë i vogël nisi të hidhej nga gëzimi... Sikur do të dilte vendit... Dhe kishte të drejtë...

Për herë të parë në jetë kisha shkelur mbi hapësirën, përballë së cilës qëndronte madhështore maja e Shpellës Hira, shpella e Dritës dhe vendi i bekimeve pafund, për botën, për njerëzimin, për të ardhmen e gjithësisë... Ishte vendi i preferuar i Resulull-llahut (a.s.), në prag të shpalljes së ajeteve të para të Kuranit...

Ishte vendi, ku falë Zotit, pas një periudhe mbi pesëshekullore nga dërgesa e një profeti (Hz. Isait (a.s.), tek beni israilët), do të vuloseshin të gjitha profecitë e mëparshme dhe do të mblidheshin në një vend e një kohë, si një kurorë mbi kokën e atij që u dëshmuar si "vulë e të gjithë peygamberëve"²... Ishte vendi, ku historia e Dritës së Udhëzimit, pas hirtësimit dhe errësimit nga duar injorante dhe ndërhyrje djallëzore, do të riniste nga aty ku e kishte lënë profeti Isa (a.s.): Dhe, kur Isai, biri i Merjemes tha: "O beni israilë, unë jam i Dërguar i Allahut te ju, jam vërtetues i Teuratit që ishte para meje dhe jam përgëzues për një të Dërguar që do të vijë pas meje, emri i të cilit

1. Kurani, El-Kasas: 24. (Përshtatja është bërë duke parë edhe shpjegimet dhe komentet e ajetit).

2. Kurani, El-Ahzabë: 40.



është Ahmed!" E kur ai u erdhi atyre me argumente të qarta, ata thanë: "Kjo është magji e hapët"³... Dhe Ahmedi, me Dritën e Kuranit vërtetues të shpalljeve të mëparshme, ERDHI!! Dhe Hiraja, sikurse mbarë bota, U NDRIÇUA..!

Në kontaktin e parë, Mali i Dritës dhe Hiraja ishin më të bukura se në foto. Ndonëse në një ambient të thatë e një mal shkëmbor, madhështia e kësaj kreshte bënte shenjë, zbukuronte krejt zonën dhe i jepte hije të rëndë...

Vështroja me vëmendje dhe thellësisht, brenda meje ndjeja një dashuri dhe respekt të papërshkrueshëm për Pejgamberin tim, për Hz. Muhamedin (a.s.), teksa e përfytyroja duke u ngjitur në heshtje e me dhembje drejt asaj maje të vështirë...

Më dukej se ndiqja me sy hapat e Zotërisë sim, teksa me madhësinë e personit të tij i ngjiste ditë pas dite, për të gjetur sadopak strehim nga një realitet i egër e injorant që dominonte asokohe në Mekë.

Sa e doja Profetin tim, teksa sytë e mi begatoheshin pa ndërprerje me pamjen e majës së Hirasë, aty ku ai, shekuj më parë kishte gjetur vend-adhurimin e tij... Aty ulej, meditonte, mendonte gjatë dhe bindej se kjo botë e ka një Krijues. Ky Zot nuk mund të ishte Hubeli, as Lati, as Uzzaja, as Esafi, as Naile, as Nesri, as..., por një Zot i vërtetë, Krijues i të gjithë kësaj saharaje pa fund, i qiellit dhe i tokës, i njeriut dhe i kafshës, i Diellit dhe i Hënës..., Zoti i gjithçkaje, Allahu i Madhëruar!

Dhe Zoti i Vetëm i gjithësisë, e kishte tërhequr Profetin drejt atij vendi, që ta lartësonte mbi të tjerët, të gjente prehje e paqe në atë vend, larg zhurmës e larg pluhurit, larg injorancës e larg idhujtarisë..., derisa një ditë...

E shikoja atë vend dhe qëndroja pa lëvizur. E ndjeja veten fatlum që kisha mbërritur në atë tokë, isha aty, me trup e shpirt. Po vështroja drejt e në zemër të vendit, që dikur mbante në duart e tij më të mirin e më të dashurin, më të pastrin e më të plotin, më të pranuarin e më të udhëzuarin, Hz. Muhamedin (a.s.) dhe natyrshëm isha / LUMTUR!


Vështroja dhe para syve më dukej se shihja atë grua të madhe, që në heshtje e me zemër të qetë ndiqte hapat e të shoqit, që shpinin deri në majë të atij mali të lartë. Herë pas here, edhe ajo ngjitej lart. Shkonte pranë tij. Qetësohej duke e parë, i çonte pak ujë e ushqim e, sërish kthehej e vetme, duke e lënë në botën e tij të adhurimit e meditimit pafund... Ishte shembulli i gruas së urtë dhe familjares së përkushtuar... Ishte Hatixhe Kubra!

Vështroja dhe imazhi i gruas besnike e fisnike zmadhohej pafundësisht në sytë e mi. Krenaria legjitime për këtë Nënë të Madhe dhe shembullin e saj, më kishte prekur shumë dhe teksa përmendja emrin e saj të bukur "HATIXHE", zemra më mbushej me një ndjesi të fortë përuljeje dhe dashurie të natyrshme. Doja të thërrisja me të madhe: "*Faleminderit Nënë për përkushtimin dhe shërbimin Tënd ndaj më të*

mirit e më të dashurit Profet! Faleminderit Nënë, për durimin Tënd, për sakrificën Tëndë, për dhembjet pafund në rrugën e Thirrjes islame! Faleminderit NËNË!"... Doja... me plot zemër doja, por rrëkezat e lotëve, teksa vështtrimet ishin fiksuar në drejtim të hapave të saj, sikur thoshin: "Ne ia përcjellim selamet e falënderimet e tua Nënës sonë! Ne jemi dëshmitarët e falënderimit tënd!"...

Atje lart, në një ditë të bukur, në më të bukurën ditë, një zë kumbues çau qiellin dhe drita e tij mbuloi gjithësinë...

Ai zë thërriste zemrën e Resulull-llahut! Me të madhe i thoshte: "*Lexo..! Lexo me emrin e Zotit tënd, i Cili krijoi çdo gjë..."* dhe nga ai moment bota nisi të ndryshonte...! Dielli nisi të rrezatonte plot shpresë e garanci për një të ardhme më të ndritshme për arabët dhe mbarë botën ... Atë ditë, mbi Shpellën Hira, kishte nisur të shkruhej verdikti i fundit hyjnor dhe botës i ishte paracaktuar Shpëtimi dhe Shpëtimtari... Atë ditë, mbi majën e Shpellës Hira, Muhamed Eminit kishte nisur t'i shpallej Fjala e Fundit Hyjnore... Atë ditë, nga Shpella Hira, Dielli i Kuranit nisi të rrezatonte Dritën e tij të pashuar... Dhe emri Muhamed, paqja dhe bekimet e Zotit qofshin mbi të, u skalit me shkronja të nurta në çdo horizont e Hiraja mbeti gjurmë Drite e mall Dashurie që përherë udhëzon...



3. Kurani, Es-Saf: 6.



Lulbe të zgjedhura

Ferid Piku

Shoqëria E MIRË

Profeti Muhamed (a.s.), ka thënë: “Njeriu është në fenë e shokut të tij, prandaj le të shikojë se kë ka për shok”¹

Sado i aftë të jetë njeriu, sado i pasur apo i zgjuar të jetë, ai ka nevojë për shokë, miq e shoqëri. Ai ka nevojë për shokë që e këshillojnë, për miq që e ndihmojnë, për shoqëri që i gjendet pranë kur ka nevojë. Njeriu nuk jeton dot i vetëm. Prandaj dhe dënimi më i madh që mund t'i bësh ndonjë njeriu, është ta izolosh atë.

Njeriu në gjuhën arabe quhet **INSAN** dhe kuptimi i kësaj fjale është i shoqërueshëm. Madje as shejtani nuk rri dot vetëm. Kur Allahu (xh.sh.), e mallkoi atë dhe e caktoi të ishte nga banorët e xhehnemit, ai tha: “O Zot, më lër të bëj shokë në dynja dhe në ahiret”. Allahu (xh.sh.), i tha: **“Në të vërtetë, ti nuk do të kesh pushtet mbi robërit e Mi, përveçse mbi të humburit, që të pasojnë ty.”** (Hixhr, 42) Që do të thotë se shejtani do të bëjë shumë shokë, përveç besimtarëve, sepse ata nuk mund t'i ketë shokë. Shejtani i devijon shokët e tij në këtë dynja dhe i ka bashkëvuajtës të tij në zjarrin e xhehnemit.

Ne nuk do të flasim për shoqërinë në përgjithësi, se askush nuk është i vetëm në këtë botë, por duam të flasim për shoqërinë e mirë, për ndikimin e saj, për këtë dhunti të Allahut (xh.xh.).

A e ndjejmë këtë dhuratë që na ka dhënë Zoti i gjithësisë? Flasin për këtë shoqëri, se për këtë u lut Ademi (a.s.), edhe pse Zoti e krijoi në mes të xhenetit. Thonë që Ademi e ndjeu veten të mangët, e ndjeu veten bosh dhe iu lut Allahut (xh.xh.), t'i bënte një bashkudhëtar, t'i bënte një shoqërues dhe Allahu krijoi bashkëshorten e tij, Havanë.

Për shoqërinë e mirë u lut Musai (a.s.), kur Zoti e dërgoi te faraoni. Musai (a.s.), tha: “O Zot, unë jam i vetëm, më mundëso që të kem një shok me vete”. Atëherë Allahu (xh.

sh.), i dha Harunin (a.s.).

Për shoqërinë e mirë u lut profeti Muhamed (a.s.) dhe Allahu (xh.sh.), i dha shumë shokë e, më të mirët prej tyre ishin Ebu Bekri (r.a.) dhe Umeri (r.a.). Ai i përqaftonte ata të dy, vinte njëren dorë mbi supin e njërit dhe dorën tjetër tek supi i tjetrit dhe thoshte: “Kështu siç na ka bashkuar Allahu në dynja, kështu do të ringjallemi në jetën tjetër”²

Për këtë shoqëri lutemi edhe ne, pavarësisht se ndoshta nuk e ndjejmë diçka të tillë, por për çdo namaz themi: **“Ihdinas Siratal mustekim – na udhëzo ne në rrugën e drejtë”**. Po kush është **“Ne”**, sepse ndodh që ti falesh i vetëm? Ata janë të gjithë myslimanët. Feja nuk shijohet pa shokë, dynjaja nuk shijohet pa shokë, madje edhe xheneti nuk shijohet pa shokë.

Shoqëria ndikon shumë te njeriu. Për këtë, mjafton të pyesim ata prindër, fëmijët e të cilëve kanë marrë rrugën e së keqes, rrugën e drogës, prostitucionit e alkoolit. Pjesa më e madhe e këtyre prindërve thonë: “Vallahi e kam pasur djalin shumë të mirë, por e prishi shoqëria”. Kjo është e vërtetë, pasi pjesën më të madhe të njerëzve i prish shoqëria e keqe. Nëse do të bësh mirë në një shoqëri të tillë, nuk të lënë shokët. Nëse do të ikësh, përsëri nuk të të lënë shokët e kështu me radhë.

Nga ana tjetër edhe shoqëria e mirë ndikon për mirë. Pyeti ata njerëz, që Zoti ua hapi zemrën, pasi e kishin të mbyllur, ua hapi sytë, pasi ishin të verbër, i nxori në jetë, pasi ishin drejt vdekjes. Do të shikosh se këta njerëz e falënderojnë Allahun (xh.sh.), që u ka dhënë shokë të mirë, të cilët e kanë mbajtur për krahu dhe nuk e kanë lënë të rrëzohet poshtë. Të gjithë kemi qenë gabimtarë, por Allahu (xh.sh.), na dha shokë të mirë, të cilët u bënë sebeb, që ne të afrohem i tek madhështia e Zotit dhe t'u largohemi gynaheve.

1. **Hadith i pranuar.** Ebu Daudi (4833) dhe Tirmidhiu (2378). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të pranuar.

2. **Hadith i dobët.** Tirmidhiu (3669) dhe Ibn Maxheh (99). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të dobët.



Një herë një njeri vrau 100 vetë, por u pendua dhe kërkoi këshillën e një njeriu të mirë. I urti i tha: "Mos rri në këtë vend. Këtu nuk mund të bëhesh njeri i mirë, sepse shoqëria është e keqe, por shko te ai fshati atje tej, se atje ka njerëz të mirë, të cilët do të të ndihmojnë". Kjo ishte këshilla më e vyer për këtë njeri. Ai u nis për te ai fshat, por rrugës i erdhi vdekja. Pati debat mes melekëve të mëshirës dhe të dënimit se kush do ta merrte dhe, pasi matën rrugën, ai shpëtoi, sepse kishte qenë më afër fshatit ku kishte njerëz të mirë.

Shoqëria e mirë është dhunti prej Zotit të gjithësisë. Për këtë, duhet ta falënderojmë Allahun natë e ditë. Ne e falënderojmë Zotin për shëndetin që na ka dhënë, për fëmijët, për pasurinë, për të mirat, por vetëm pak njerëz e falënderojnë Zotin për shoqërinë që u ka dhënë. Shoqëria e mirë është furnizim dhe begati prej Allahut (xh.sh.). Profeti (a.s.), ka thënë: "Atij njeriu që Zoti ia do të mirën, i jep një shok të mirë. Ai të kujton kur ti harron, ai të ngre, kur ti rrëzohesh, të drejton kur ti devijon".³ Shoku i mirë është si puna e pasqyrës. Ti qëndron para saj, rregullon veten tënde dhe i heq të metat nga fytyra jote. Kështu është edhe shoku i mirë. Ai është si dora, që ndihmon shoqen e saj e të dyja bashkë lajnë fytyrën. Ndërsa shoku i keq të shkatërron, edhe pse ti nuk e ndjen diçka të tillë.

Vëllezër! Vallahi duhet ta falënderojmë Allahun (xh.sh.), natë e ditë për shoqërinë që na ka dhënë, se është dhuratë e madhe, e cila nuk blihet me para.

Shoqëria mes myslimanëve është shoqëri pa interesa. Ne e ndihmojmë njëri – tjetrin vetëm për hir të Zotit. Është e habitshme kur shikon se si vëllai yt mysliman vjen e të ndihmon, atëherë kur nuk i ke kërkuar ndihmë, vjen e të rri pranë, atëherë kur s'ta pret mendja. Ai lodhet e punon për ty, sepse kështu fiton xhenetin.

A ka një shoqëri të tillë në botë? Sot nuk ka shoqëri

pa interesa, përveç asaj shoqërie që është ndërtuar mbi bekimin e Allahut (xh.sh.), sepse unë kërkoj xhenetin, kur të ndihmoj ty dhe anasjelltas. Kjo është shoqëri dhe rrugë për xhenet, jo vetëm për jetën tjetër, por edhe për këtë jetë. Sot janë të rrallë ata njerëz, që lidhen me njëri – tjetrin pa pasur asnjë interes. Ne myslimanët kemi vetëm një interes të përbashkët e ai është xheneti i Allahut (xh.sh.).

Profeti (a.s.), tregon: "Një njeri e donte shokun e tij pa pasur kurrfarë interesi. Një ditë ai u nis të shkojë për t'i bërë një vizitë atij. Rrugës takon një melek në formën e një njeriu, i cili e pyeti: 'Për ku po shkon o njeri?' 'Po shkoj të vizitoj vëllain tim për hir të Allahut' – u përgjigj burri. Meleku pyeti sërish: 'A mos ke ndonjë interes, tregti apo lidhje familjare me të?' Burri u përgjigj: 'Vallahi nuk kam asnjë interes, as ndonjë tregti e as nuk kam lidhje familjare me atë person, por po shkoj t'i bëj një vizitë vetëm për hir të Allahut (xh.sh.)'. Atëherë meleku i tha: 'Unë jam meleku i Zotit. Më ka dërguar Allahu (xh.sh.), të të them se Allahu (xh.sh.), të do ty, siç e deshe ti vëllain tënd'.⁴ Kjo është shoqëria për hir të Allahut (xh.sh.).

Madje edhe në xhenet nuk do të hyjmë të vetëm, por bashkë me vëllezërit tanë. Zoti nuk i fut besimtarët në xhenet tek e tek, por të gjithë bashkë të kapur për dore. A e imagjinon këtë kënaqësi, kur Allahu (xh.sh.), të thotë: "Futuni o besimtarë të lidhur të gjithë së bashku në xhenet". Allahu (xh.sh.), kënaqet kur i shikon robërit e Tij, që hyjnë në xhenet të lidhur me njëri – tjetrin, siç ishin të lidhur në dynja. Kjo lloj shoqërie të shoqëron deri në xhenet. Ajo shoqëri, që të lëshon që në këtë dynja, është shoqëri për interes apo për diçka tjetër, por nuk është shoqëri, të cilën e ka bekuar Allahu (xh.sh.).

Profeti (a.s.), ka thënë: "Ditën e Gjykimit do të ketë një njerëz, që janë ulur në frone prej drite rreth Arshit të Allahut (xh.sh.). Fytyrat e tyre do të jenë të nurta. Nuk janë as profetë e as dëshmorë, por profetët dhe dëshmorët do t'i kenë zili këta njerëz. Ata janë njerëz, që e kanë dashur njëri – tjetrin për hir të Allahut (xh.sh.)."⁵

Kurse shoqëria e keqe të shkatërron, duke të tërhequr çdo ditë nga e keqja dhe ti nuk mund të dalësh nga ai rreth i mbyllur, sepse nuk mund të largohesh nga shokët e këqinj. Shumë njerëz kanë qenë shumë afër së vërtetës, por është bërë shkak një shok i keq, që i ka tërhequr tek e keqja. Shumë të tjerë e duan të mirën. Nëse i pyet këta njerëz, ata thonë: "Vallahi e duam të mirën, por nuk mund të ndryshojmë dot." Ata e thonë këtë, sepse e keqja i ka rrethuar nga të katër anët.

Tregohet se, Ukbe Ibn Rebi'as iu ngroh zemra ndaj Islamit. Ai u nis për te Profeti (a.s.), që të dëshmonte shehade-tin. Nëse do të shkonte në Medinë tek Profeti (a.s.), ajo do të ishte dita me fatlume e jetës së tij, por për fat të keq ajo kishte qenë dita më e keqe e jetës së tij. Ai kishte një shok shumë të keq, Ebu Xhehlin, simbolin e armikut të Allahut

4. **Hadith i vërtetë.** Muslimi (2567).

5. **Hadith i vërtetë.** Hakimi (4/471). Hakimi e vlerëson vargun e hadithit të vërtetë dhe me të pajtohet edhe Dhehebiu.

3. **Hadith i vërtetë.** Ahmedi (6/70) dhe Ebu Daudi (2932). Shejh Albani dhe shejh Shuajbi e vlerësojnë hadithin të vërtetë.

dhe të Profetit të Tij. Ai u takua rrugës me Ebu Xhehlin, i cili e pyeti: "Për ku je nisur, o mik i vjetër?" Ukbe iu përgjigj: "Jam nisur për në Medinë të takoj Muhamedin (a.s.), sepse dua të bëhem mysliman." Ebu Xhehli ia ktheu: "Nëse shkon atje, mos fol kurrë më me mua dhe mos më dil më përpara." Ukbe Ibn Rebia mbeti keq. Ai ishte mes shoqërisë së vjetër të Ebu Xhehlit dhe shoqërisë së re të Muhamedit (a.s.). Zemra e tij anoi nga shoqëria e vjetër. Kështu, ai zgjodhi shoqërinë e Ebu Xhehlit dhe ashtu siç qëndroi me të në këtë dynja, ashtu do të jetë në shoqërinë e tij, në zjarrin e xhehenemit në Ahiret. Kjo është shoqëria e keqe.

Allahu (xh.sh.), tregon për një nga banorët e xhenetit, i cili kishte pasur një shok të ngushtë, por nuk e kishte besimin njësoj si shoku i tij. Këtë e futi Zoti në xhenet, ndërsa shokun e tij e futi në zjarr. Pasi u rihet mirë e mirë, i vajti mendja te shoku i tij dhe i kërkoi leje Allahut ta shikonte shokun e tij. Melekët e nxjerrin këtë person në ballkonet e xhenetit dhe ai shikon shokun e tij diku atje në mes të zjarrit të xhehenemit, që po vuan dënimin e tij. Ky njeri filloi të qajë dhe tha: "Ti ishe shoku im i ngushtë. A e shikon ku të kanë çuar këshillat e tua që më thoshe: "Lëre Zotin, lëre namazin, lëre të mirën, se nuk të duhet ajo punë". Më paska dashur shumë Allahu (xh.sh.), që nuk më bëri si ti. Po të mos ishte mëshira e Zotit dhe udhëzimi i tij, do të isha bashkë me ty në zjarrin e xhehenemit."

Me këtë që thamë, kemi dy qëllime:

1- Qëllimi i parë: A e kërkojmë shoqërinë e mirë, siç kërkojmë rrizkun tonë? Shoku i mirë është xhevahir, është dhuratë prej Allahut (xh.sh.), sidomos në këtë kohë, kur e keqja është shtuar në masë. Ky shok të ndihmon e të gjendet gjithmonë pranë. Falënderojë Allahun (xh.sh.), për këtë shoqëri. Bëhu shok i mirë dhe mbaje shoqërinë e mirë. Mos e prish shoqërinë tënde për pak e për shumë. Mos u bëj cinik e as egoist. Munde veten tënde, se këta njerëz nuk do t'i gjesh shumë kollaj.

2- Qëllimi i dytë: Të shikojmë se me kë shoqërohen fëmijët tanë. Nëse fëmija yt shoqërohet me njerëz të mirë, me fëmijë të mirë, do të të lehtësohet gjysma e punës. Por, nëse fëmija shoqërohet me shokë të këqinj, do të të dalë nga duart e do vijë një moment, që do mallkosh ditën që e le fëmijën tënd të rrijë me atë shok, sepse ai e çoi drejt humbjes fëmijën tënd. Sot e keqja është shtuar më shumë se kurrë më parë, prandaj le të kërkojmë shokë për fëmijët tanë. Për këtë qëllim, lidhi fëmijët e tu me fëmijët e besimtarëve. Le të bëhen si tullat e ndërtesës, që mbajnë njëra – tjetrën.

Pyesim veten, se ku janë shokët e mirë. Vallahi ka njerëz të mirë, edhe pse ndoshta nuk janë në xhami. Kërkoji këta njerëz. Bëhu shkak që këta njerëz të drejtohen, që t'i kesh shokë të mirë. Njerëz të mirë ka sa të duash, por duhen kërkuar.

Nga ana tjetër, nuk bëjmë thirrje që të shkëputemi nga shoqëria jonë, sepse qenka e keqe. Ne duhet të kemi marrëdhënie me ta, sepse Allahu (xh.sh.), të ka krijuar mes këtyre njerëzve. Duam apo nuk duam ne, nuk mund ta bëj-



më jetën të vetmuar. Përveç kësaj, nëse ti nuk u flet për të mirën, nuk i udhëzon tek e mira, kush do ta bëjë. Nëse e mira nuk bën përpjekje për ta ndryshuar të keqen, e keqja do të shtohet gjithnjë e më shumë. Le ta lusim Zotin që të na takojë me njerëzit e mirë ashtu siç lutej profeti (a.s.): "O Zot, më drejto tek njerëzit më të mirë".⁶ Allahu (xh.sh.), i tha: "**Mos e largo shikimin nga ata të mirët, edhe pse janë fukarenj...**" (Kehf, 28)

Në mbyllje po tregojmë një fjalë shumë të shkurtër të profetit (a.s.), që ia kalon çdo fjalimi sado të gjatë. Profeti (a.s.), ka thënë: "Shembulli i shokut të mirë është si puna e shitësit të parfumeve. Shitësi i parfumeve, dhe sikur të mos ta japë një parfum për dhuratë, ai nuk të bën keq dhe nuk i vjen erë e keqe. Më e pakta që mund të përfitosh prej tij do të jetë se edhe ty do të të vijë era parfum, erë e mirë. Ndërsa shembulli i shokut të keq është si puna e farkëtarit. Nëse nuk ta djeg rrobën me zjarr, ai të lë erën e keqe të tymit".

Le t'i mbajmë lidhjet me të gjithë njerëzit, por ama kurrë nuk duhet ta shesim shokun e mirë, por ta kërkojmë e kur ta gjejmë, duhet ta mbajmë fort atë, sepse është shok për dynja e për ahiret. Ditën e Gjykimit do të zhduken të gjitha shoqëritë e do të mbetet vetëm shoqëria e atyre, që janë dashur për hir të Allahut (xh.sh.).

E lusim Allahun (xh.sh.), të na japë një shoqëri të mirë e të na bëjë shokë të mirë. E lusim Allahun (xh.sh.), t'i ruajë fëmijët tanë nga shoqëria e keqe e t'i udhëzojë ata për mirë. Lusim Zotin t'i lidhë zemrat tona vetëm për hir të Madhështisë së Tij. Allahu (xh.sh.), na mundësoftë që të jemi të gjithë bashkë në xhenetet e Tij.

Amin!

6. **Hadith i pranuar për shkak të dëshmimeve përforcuese.** Ahmedi (5/191). Shejh Ahmed Zejati në verifikim e tij të musnedit të Ahmedit e vlerëson hadithin të pranuar, ndërsa shejh Shuajbi e vlerëson hadithin të dobët. Hadithin e shënon gjithashtu Hakimi (1/516) dhe Taberaniu në Dua (320, 321). Verifikuesi i librit "Dua" e vlerëson hadithin të pranuar për shkak të dëshmimeve përforcuese.

7. **Hadith i vertetë.** Buhariu (5534) dhe Muslimi (2628).

ÇKA ÂSHT BESIMI ISLAM?

Tashti do t'i a hyjmë tregimit të rregullavet e të parimevet të tija. Por më perpara të marrim vesht një herë se çka don me thanë "Islam".

Fjala "Islam" në fjalorin religjioz ka kuptimin e "bindjes"; por jo të të një bindjes absolute. Bindje ndaj të një vertetë, në Hyun. Asht në kundërshtim me fjalën e me shpirtin Islam bindja veç njaj Zoti, veç njaj të vertetë. Perse me i u bindë një të shtrembte është si me çue krye kundra të vertetës, kundra Hyut. Mbi këtë gjë flet Kurani në shumë vende. Prandë çdo mysliman, si mbas Besimit të tij do t'u përurjet atyne gjanavet që janë të verteta para Zotit edhe do të jetë gjithnjë në përpjekje me njerzë që janë n'udhë të drejtë, n'udhë të Perendisë e do t'i luftojë njerzët e dhanun mbas epshit e mbas punëve të këjja; një ndërgjegje formue kësajsojt na mund t'a quejnë në një adhurim i së vertetës.

Njaj që është bindun njaj Zoti që është një e vetë e verteta, njaj po tham, nuk i gjykon gjanat mbas pikpamjes të tij; por i u ep atyne vleften e meritueshme si mbas pikpamjes hyjnore, kshu që i vjen turp mandej me mohue gjanat që në vedvedi kanë atë vleftë. Ndër zëmbra që është rranjue dashtunija për të vertetën, aty s'ka vend fanatizmi Zoti thotë në Kuranin e vet:

"Zoti, mëshirëplotë dergoj Profetin e vet me predikue Besimin e vertetë".

"O ju, që ju besoni libravet të shënjtë, pse e veshni të drejten me të shtrëmbët, e mohoni të drejten tuej e ditë ju mirëfilli." "O ju besimtarë, mos e teproni në tjetër gjë në besim t'uej, veçse në ndjekje të vertetës". "Besimtarë! Në Besim mos e teproni, e mos thoni tjetër mbi Perendi veç të drejten". Me këto urdhna e porosina, Kur-ani i vertetë ka perbuzun teprin e fanatizmin e vetem në drejtë ka vuem leçi me ngulë kambë. Feja Islame të miren (hajrin) e gjenë vetëm në njoftje e n'adhurim të drejtës; e aty ku s'qindron e drejta nuk ka kundruem kurr një të mirë. Çdo dobi që nuk pëshitetet në të drejtë e në të mirë, feja Islame e ka konsideruem si dam. Qe, kuptimi i fjalës Islam është ky. Tashti të rrmojmë bazat e kësaj fe:

E para shtyllë e dogmës Islame është: Principi i naltë i të besuemit të Zotit e kulti njaj të vetmit Zot, i paqet prej çdo sendi.

Çdo mysliman më parë se çdo gjë beson se "rruzullimi është vepra e një krijuesit. Kenjet e pambarueme kanë një të vetmin krijues, një hartues i pagabueshëm të tyne. Të gjitha cilësit e plota gjinden në të e është i çveshun prej

çdo cilsije të mangët. Në kurr një send as në vehtje, as në cilsina e as nder veprime aj s'ka shoq e shembëlltyrë. Nieriu s'arrijnë kurr me njoftë realitetin hyunuer të tij. Gjithshkafja bunon prej tij e prap në të derdhet. Vullnesa e tij është një ligjë absolutë mbi krejt rruzullimin. Vetem se çdo send e ka vuem nen një shkak edhe të perbâmit e çdo sendi e ka rruzulluem me një ligjë.

Njeriu për me siguruem këndaqunin e vet ndër dy jetët, duhet t'i shtrohet pa tjetër ligjvet të tija hyjnore". Ky është Zoti i vërtetë, që cilson e provon feja islame. Të shqyrtojmë pra n'anë tjetër edhe vleften e natyrën e kundreshtimevet që parashtrajnë mohuesat *athe*. Zoti i madh tuej permendë kundërshtimet e mohuesavet në Kur-anin e vet shëjt thotë se:

"Kanë thanë disa që jeta është kjo që shofim na, e cila ka mbarrimin e vet. Po kështu jetojmë e kështu vdesim. Ajo që na shqymbë në s'është tjetër veçse kohës e natyrës. Ata që thonë kështu, mos kujtoni se pshteten në dijeni. Këto nuk janë fjalë dijenijet, veç fryt iluzionesh".

Poh, përnjimënd se njerzët e dijenis që kanë gjykuem me gjakftoftësi, të gjithë një gojet kanë dishmuem kënnen e një të vetmit Zot; gjithnjë edhe dishmojnë. Duhet dijtun se detyra kryesore e shkencavet është: provimi i çdo problemi. Negacioni a mohimi nuk kanë të bënë me shkencë; veç një kontrasti s'formojnë tjetër dobi.

Në çdo problemë shkencore një pozitiv është më i fuqishëm se një negativ, perse negacioni nuk ka një bazë, prandë as s'ka një vleftë: 0x0=0. Po të kemi me zhvilluem një problemë matematikët në ket veshtrim, perfundimi po ky kishte me kenë. Po të shtegtoni nepër botë edhe të pyetni, do të ndesheni nder miljona njerzësh që nuk dijnë, fjala vjen, sa planeta e Jupiterit ka satelitë e tij krejt sikuer hana edhe se ato satelira kanë eklipsin e tyne. Por këto miljona njerzësh para një astronomit kanë vleften e një zeros. Shi kështu, njerzë me vleftë të zeros, mohuesat të së vertetës, këndojnë në një anë fjalët e dijetarvet, por n'anë tjetër s'janë n'at gjendje zotsije sa me njoftë e me kuptue shpirtin e atyne këndimevet ose vijojnë n'udhën e tyne mohuese, tuej kë në se nuk i u bijnë për shtat të vertetat shkencore.

Pa dijtun kushtet e silogjizmës ata bëjnë me mija silogjizma. Këniën e gjykojnë për pakënie, e pa-keniën për kënie. S'i shofin apo s'dojnë me i pa argumentat e të vërtetës. Mbasi ka Zot, thonë ata, pse ky nuk flet me në? Pse nuk na ep një shëjt të këniës të tij? Kjo frrotë njerzësh që derdhë këtë jarg është ajo që as eren s'i a ka ndi

dijes e qi në trup të vet nuk ka atë zemër të thjështë, nepër të cilen të munden me depertue rrezet e saja. Çfaqja e idhevet të dijenis qi janë prej nurevet shpirtnore, mëvarret në kapacitetin e veçantë të një sekretit shpirtnuer qi thirret zemër; e kjo nuk është e njëjtë në kedo.

Ka shumë njerëz qi kapaciteti shkencuer i tyre nuk mundet t'a kalojë mehanizmin e dukshëm të lëvizjeve kolektive. Ata flasin mbi dijenië por as kanë fare njoftimi mbi ekzistencën e dijenive, idhevet, mëndjes e intelektit. Prej kësaj pra dalin pa kurrfarë vleftet gjykimet e këtyre njerëzve mbi ligjë të shkencave e mbi kushte t'intelektit, kuerse ata s'dijnë me dhanë një gjykim as mbi më të thjeshtin korp (trup).

Sikur në krijimin e tyre kanë ndryshim përshtypjet filozofike e qimike të sendeve, ashtu janë të ndryshme edhe vleftet e karakteret (hasais) jetsore të lëndëve organike. Prej një peshku s'lindet një kapruell e prej një hunde s'formohet një sy apo një bebe syni. Shi kjo ligjë shohim se mbretnon edhe në fushatën shpirtnore. Ndryshimi në mes dy shpirttrave a dy zemrave është më i madh se ndryshimi në mes dy organeve të gjalla. Pa dyshim se ndryshimi qi shihet ndër ndisina, ndër vullnete e ndër kuptimetë njerzvet lindet nga ndryshimi i shpirtnavet.

Ka shpirtna e zëmra qi arrijnë me kuptue të verteten me një herë; prej një incidenti më të vogël zbulojnë një ligjë më të madhe. Ka mandej njerëz qi rrokollisen nëpër fushatë t'eksperiencës të mija ndodhinavet edhe aspak nuk binden as marrin mësim prej tyre, për me formue një idhë të saktë. Për ata një gjë është e fikzue. Dyshimi e mohimi. Perse, ata kanë zemrat e prishuna e organet e kuptimit të zhgattrueme. Me një syzë të plasun s'mundet m'u pa qartas gjanat; gjithkshtu nepër një zemër të keqe s'mundet m'u vrojtë e verteta.

Prandë "me pa" asht tjetër "me shique" tjetër. Njerzitet e dijes mundohen me vjetë për mos me humbë një shkëndi më të vogël të së vertetës por ata qi s'e kanë pajuem vehten e tyre me dijeni, kapercenë përmbi mija të verteta pa kuptuem gjë prej tyre. Tuej e njëhë për një zotësi arrijtjen ndër qëllime epshore. Sikur tregon në librin e vet të quejtun "Mylehas" filozofi Fahredini Rezië, filozofi Arab Sabit-ibni-Kurre, zbritjen e korpnavet donte m'e shpjeguem me ligjen e atrakcionit e dijetarët e kohës qi këtë lëvizje i a detyroshin një theoris të tjetër, nuk dojshin m'e pranuem këtë tezë edhe bajshin një mij kundreshtime.

Po ç'solli kundreshtimi i tyre? Kurgja! Del një dit një Neëton edhe nepër të ramë poshtë të një gurri, shpjegon qartsisht ligjen e atrakcionit. Këtu na çfaqet një pikë randësi-plotë: Duhet çmuem se Neëtoni këtë ligjë s'e zbuloj nepër fuqi të teleskopit, por të një fuqie qi quhet gjeni. Mbas Neëtonit u çpiken sa e sa teleskope të mëdhaja. Por as një astronomi nuk u çue të kërkojë me këto teleskopa atë ligjë t'atracionit. Vetem u morrën me kërkuem livizjet e veprat qi fuqi-ploti Zot rregullon me këtë ligjë. E dijsin ata se shumë pak munden me pa në këtë rruzullim me sytë e tyre të ballit! Kurrkush s'mundet t'a

mohojë një gjë qi e ka ndigjuem me veshë, perse nuk e ka pamë me sytë e tij.

Kurrkush nuk e kerkon arrsyetimin (mëndjen) e kon-siences (shu-ur) me teleskop a mitroskop. Ata qi mohojnë themitë qi s'shifen me teleskop, mohojnë perpara mendjen e tyre. Atomët, etheret (këndë: eter, arab, ethirë) e fuqit elektrike s'shifen me sye. Deri më sot s'ka dalë një dijetarë qi me teleskop në dorë t'orvatet me gjetë mendien e fuqin terhejke. As një njeri me mendje në krye s'është pam kurr qi të ketë dalë me kerkuem Zotin me teleskop e mandej tuej mos e gjetë t'a ketë mohuem. Dijetarët e dinë se të kerkuemit e Perendis është bars, si prej qiellnavet, ashtu prej një thermije. Misteri i krijimit të një atomës është bazë për misterin e krijimit të korpnavet.

Misteri i lëvizjes së krejtë rruzullimit, mundet m'u zbuluem pak a shumë prej misterit të lëvizjes të një atomës. Në natyrë, qi mbretnon ligja e një peshimit të fuqivet (muvaazene'i kuvva) s'duhet t'eksistonte kurr një lëvizje simbas pikpamjes të shkencës edhe në gjithkafen lypsej të mbretnonte qetsija. E po t'ishte ashtu, rruzullimi do t'ishte ende sod në formë t'atomeve t'energjis (madde) edhe s'do të formohej as një lëndë a korp. Asht një fenomen shkencuer i madh me perbë një atomë ose m'e vuem këtë në veprim e me fuqin e sajë me shkaktuem lëvizjen e atomeve tjera.

Në është se për mbas shkencës lëvizja e atomevet është e amshueshme janë t'amshueme edhe një peshimet (muvaazene) e tyre; e po t'ishin edhe një peshimet e amshueme, s'do t'u krijonte gjë rishtas. Atëherë s'do t'u krijoshin korpnavet, nuk do të i u vinte rendi lëvizjeve mehanike e të perbashkta, të linduna prej lëvizjeve t'atomevet, s'do të ndodhte kurr një incident e jeta s'do t'ishte e vijueshme.

E prej kësaj ka rrjedhur qi materjalistat e natyralistat, të cilët kanë dashtë me zhvillue çdo lamsh mbas theorivet të tyre, ç'prej kohëve të lashta greke e deri më sot s'kanë bërë tjetër por tuej thanë se një atomë pa u shkaktue prej ndonji kavije të jashtme, ka bërë lëvizje e ka prishë ekuilibrin, që në këtë mënyrë kan shpartalluem ligjë e natyrës, në të cilat ata vetë pshteten.

E erdhi një ditë qi shkenca në dorë të tyre bëri ankim, pse ata kapersyen çdo kufi qi kishte caktuem ajo (është shkenca); nuk qenë të zotët kursesi me pranuem tezin e tyre për pa rrënuem theorit shkencore. Asajë frutë pseudo-dijetarësh i u gërthiten shkencat me ulurime të mëdha: "Na lëni në aty kë na merrin më bërë t'onen. Na lëni në cak t'onë e të mos kapercen më tek andej." Ata qi ndigjuen ulurimet në këtë mënyrë të shkencave, nuk nonuen me e nën-vuem natyrën në pushtetin e krijuesit. Filozofi klasik Aristoteli e mandej filozofi i kohëve të vona Descarte: ia këthyen shkencave atë dinjitetin e humbun një herë.

H. Ali Kraja

Marrë nga revista Zani i Nalte,
nr. 9, fq. 266, Prillë 1927.

SI TË LUFTOJMË ALERGIJË E STINËS SË PRANVERËS

Erdhi pranvera e shumëpritur. Shumica nga ne gëzohet, por për disa njerëz nis një problem i sikletshëm, sepse ata vuajnë nga alergjia ndaj polenit. Për ta pranvera nuk është aspak romantike e as e këndshme. Shumica e tyre tashmë janë me ilaçe e kura. Nëse jeni prej atyre që mendojnë se nuk ka shpëtim, mos i humbni shpresat. Sot ekzistojnë një numër i madh i alternativave për lehtësimin e simptomave të alergjisë. Ne do të përmendim vetëm disa prej tyre:

- Së pari, filloni me ushqimin. Edhe pse alergjenët janë faktor i jashtëm, problemi është se trupi ynë reagon ndaj tyre. Edhe pse trupi ynë është i mbushur me alergjenë klasikë nga ushqimi, sistemi juaj i imunitetit do të reagojë ndjeshëm edhe ndaj alergjenëve të jashtëm. Rralloni konsumin e produkteve të grurit, të qumështit dhe të sheqerit.

- Një lugë mjaltë. Zgjidhni mjaltin e bletëve që jetojnë në rajonin tuaj. Në teori, konsumimi i mjaltit është si imunoterapia. Njësoj si kura me doza të vogla të alergjenëve për të reduktuar ndjeshmërinë e tepërt në to. Kur bletët mbledhin nektarin nga lulet, mbledhin edhe grimcat e polenit që përfundojnë në mjaltë dhe në këtë mënyrë ju mundësojnë imunoterapinë homeopatike. Mjalti është i shkëlqyeshëm për parandalimin e reaksioneve alergjike.

- Vitamina C dhe kuercetina. Kjo vitaminë është një antioksidant shumë i fortë dhe stabilizator i mastociteve që lëshojnë histaminën kur vijnë në kontakt me alergjenët: histamina në qarkullim të gjakut është shkaktare e simptomave, si irritimi i syve, teshtima dhe rrjedhja e hundës. Vitamina C redukton reaktivitetin e mastociteve dhe në këtë mënyrë lehtëson simptomat e alergjisë, ndërsa kuercetina, flavonoidi i fuqishëm (gjendet në

fruta, perime, veçanërisht ato me gjethe), forcon veprimin e vitaminës C. Në shenjat e para të alergjisë merrni 1500 miligramë vitamina C dhe 500 miligramë kuercetin.

- Çaji nga kopra. Ky çaj është i shëndetshëm dhe shumë i dobishëm ndaj alergjive.

- Shpëlarja e hundës. Alergjitë sezonale janë shkaktuar me alergjenë në formë të polemit të bimëve që janë në lulëzim: ata alergjenë shpesh mbesin të bllokuar në hundë. Polemi atëherë nxit reaksionin inflamator, të cilin e quajmë alergji. Një nga mënyrat për të lehtësuar simptomat është edhe shpëlarja e hundës me ujë të njelmët.

- Avujt e vajrave eterike. Vendoseni ujin në enë dhe lëreni të nxehet deri në pikën e vlimit. Pastaj, në ujë hidhni katër pika vaj eukalipti, një deri në dy pika vaj të drurit të çajit dhe tri pika vaj rozmarinë. Afrojeni kokën në ujë, mbulojeni me një peshqir të madh dhe thitheni avullin pesë deri në dhjetë minuta.

- Akupunktura. Kur akupunktura aplikohet në mënyrë lokale, me të vërtetë lehtëson simptomat e inflamacionit nazal dhe sinusial, të cilat janë burim sikleti për çdokënd që është alergjik.



ÇFARË E SHKAKTON HUMBJEN E DËGJIMIT?

Është zhurma dhe jo mosha, faktori që na çon drejt humbjes së dëgjimit.

Miliarda persona kanë probleme me dëgjimin, të shkaktuara nga zhurmat e vazhdueshme që na rrethojnë. "E vërteta e hidhur është se shumë prej nesh janë vetë përgjegjës për humbjen e dëgjimit", shkruan Katerin Bouton në librin e saj "Të bërëtitur nuk të zgjidh punë". Shkaku janë zhurmat ndaj të cilave ne e ekspozojmë veten ditë pas dite. Në mjedise të zhurmshme pune zbatohen rregulla të caktuara, por jashtë tyre jemi plotësisht të pambrojtur. Muzika nga kufjet, koncertet e rokut, tharëset e flokëve, sirenat, fshesat me korent, boritë e makinave etj., të gjitha këto ndikojnë negativisht në veshët tanë. Jetojmë në një botë të zhurmshme, që duket se çdo vit bëhet edhe më shumë e zhurmshme.

Nëpër restorante, pas shërbimit të dobët, ndotja akustike renditete dyta, për të cilën njerëzit ankohen më shumë. Zhurmat e larta ose ekspozimi kronik ndaj një tingulli edhe kur ai nuk është shumë i lartë, mund të dëmtojë aparatin e dëgjimit duke i shkatërruar qelizat përgjegjëse. Në këtë rast, këto qeliza janë në një sasi të caktuar dhe nuk mund të zëvendësohen, prandaj ndjeshmëria ndaj tingujve humbet përkohësisht. Fillimisht bie ndjeshmëria ndaj tingujve me frekuencë të lartë, më pas humbet edhe aftësia për të dëgjuar frekuencat e fjalëve. Robert V. Harrison, një specialist në Universitetin e Torontos, shprehet se pasojat e ekspozimit ndaj zhurmës grumbullohen vazhdimisht. Edhe pse në fillim shkatërrohen vetëm disa qeliza, nëse ekspozohemi përditë ndaj zhurmës, atëherë dëgjimi ynë fillon të dobësohet derisa të humbasë. Kur qelizat e dëgjimit dëmtohen që në moshë shumë të re, siç ka ndodhur me shumë muzikantë roku apo edhe të pasionuar pas koncerteve të tyre, me arritjen e moshës së mesme këta persona e kanë shumë të vështirë të dëgjojnë dhe kuptojnë fjalët.

Tingulli matet me decibel (dB), niveli i zhurmës që shkakton humbje të përkohshme të dëgjimit është rreth 85 dB, i barabartë me zhurmën e tharësës së flokëve apo edhe miksuesit të frutave. Dr. Majkëll Seidman këshillon përdorimin e tapave të veshëve gjatë kohës kur kryejmë aktivitetet e mësipërme. Mbrojtja e veshëve është e detyrueshme për personat që përdorin armë, ngasin motoçikleta apo përdorin sharra elektrike. Nga ana tjetër, po kaq të dëmshme janë edhe aparatet që përdorim për të dëgjuar muzikë, sidomos kur ajo e tejkalon nivelin e duhur. Nëse muzikën e dëgjoni me zë shumë të lartë, atëherë jeni duke shkatërruar qelizat tuaja të dëgjimit që në moshë të re. Një studim nga Qendra Amerikane e Dëgjimit zbuloi se mes përdoruesve të pajisjeve muzikore, 35 për qind e të rriturve dhe 59



për qind e adoleshentëve pranojnë se dëgjojnë muzikë me zë të lartë.

Dr. Harrison shprehet se njerëzit akoma nuk e kuptojnë se çfarë dëmi po i shkaktojnë vetes. Ata shpesh e rrisin volumin e muzikës për të shmangur zhurmat përreth, por gjëja e duhur për t'u bërë është të vendoset një kufi dëgjimit të muzikës në një dhomë të qetë dhe ai të mbahet i pandryshueshëm gjatë gjithë kohës. Ekspertët shprehen se kufjet e celularëve janë më të rrezikshme sesa kufjet e kompjuterëve, pasi të parat janë të vogla dhe mund të futen më thellë në vesh duke shkaktuar një dëm më të madh për të njëjtin nivel muzike. Edhe lodrat e krijuara për fëmijë mund të shkaktojnë dëmtim të dëgjimit të tyre.

Qendra Amerikane e Dëgjimit liston një sërë produktesh, siç janë armët me kapsollë, kukullat që flasin, makinat me sirena dhe bori, instrumentet muzikore dhe lodrat me kurdisje. Specialistët shprehen se disa prej këtyre objekteve të përdorura nga fëmijët krijojnë një ndotje akustike deri në 90 dB. Për këtë arsye, doktorët këshillojnë prindërit të kenë kujdes në lidhje me lodrat që blenë për fëmijët e tyre.

Muzika nga kufjet, koncertet e rokut, tharëset e flokëve, sirenat, fshesat me korrent, boritë e makinave etj., të gjitha këto ndikojnë negativisht në veshët tanë

Qendra Amerikane e Dëgjimit zbuloi se mes përdoruesve të pajisjeve muzikore, 35 për qind e të rriturve dhe 59 % e adoleshentëve pranojnë se dëgjojnë muzikë me zë të lartë.

KOSOVA MERR PJESË NË SIMPOZIUMIN NDËRKOMBËTAR PËR POLITIKAT GLOBALE TË ALKOOLIT QË U ZHVILLUA NË TURQI

Pavarësisht çrregullimeve serioze shëndetësore dhe psiko-fiziko-sociale që shkakton abuzimi me alkoolin, për arsye ekonomike, tradicionale, sociale dhe lejimit me ligj të tij, përbën substancën varësidhënëse më të përhapur edhe në Kosovë.

Problematica e lidhur me alkoolin dhe politikat globale për këtë fenomen ishin në qendër të simpoziumit ndërkombëtar që u zhvillua në Stamboll, ku morën pjesë dhe ministri i Shëndetësisë së Kosovës, Halim Kosova.

Zyra e Shtypit e MSH njoftoi se ministri kosovar zhvillon një vizitë zyrtare në Turqi me ftesë të homologut të tij, gjatë së cilës do të marrë pjesë edhe në Simpoziumin Ndërkombëtar për Politikat Globale të Alkoolit. Objektivi kryesor i këtij simpoziumi të nivelit të lartë lidhet me shkëmbimin e informacionit ndërmjet

shteteve pjesëmarrëse mbi zhvillimet e politikave të alkoolit dhe pritet që gjatë punimeve të këtij simpoziumi të paraqiten rezultatet paraprake të Raportit Evropian (2013) mbi alkoolin dhe shëndetin që do të publikohet në Qershor të këtij viti.

Takimi organizohet nga Zyra e Organizatës Botërore të Shëndetësisë për Rajonin e Evropës dhe nga Shoqata e Gjysmëhënës së Gjelbër, nën kujdesin e veçantë të Kryeministrit turk, Rexhep Tajip Erdoan, i cili i ka përshëndetur të pranishmit në hapjen e këtij simpoziumi.

Ministri Kosova, ka qenë i pranishëm edhe në një tryezë të përbashkët pune me homologë të vendeve pjesëmarrëse, ku është folur mbi politikat që duhet të zbatohen për të kontrolluar abuzimin me alkoolin dhe parandalimin e dëmeve të tij.

ALARMI, 57% E GJIMNAZISTËVE JANË ANALFABETË

Një raport i Bankës Botërore tregon nivelin alarmant të situatës së arsimit të adoleshentëve shqiptarë. Sipas këtij raporti, rreth 57% e gjimnazistëve në vend nuk kuptojnë asgjë nga ato që lexojnë në tekstet shkollore.

Duke iu referuar raportit të BB-së, rezultojnë se 57% e 15-vjeçarëve nuk kanë aftësinë për të kuptuar leximin e jo më për të zbatuar në praktikë njohuritë e marra

gjatë viteve të shkollës së mesme, që konsiderohet me ligj si arsimi bazë.

Sipas studimit, kjo shifër tronditëse raporton se të rinjtë shqiptarë janë analfabetë funksionalë me plot kuptimin e fjalës. Nxënësit shqiptarë, në testime të standardizuara ndërkombëtare, arrijnë nivel të ulët të rezultateve për sa u takon aftësive dhe njohurive, kryesisht në matematikë, por edhe në shkencat e tjera.


OBAMA PARALAJMËROI ASHPËR UDHËHEQJEN E SIRISË

Presidenti Barak Obama dhe Mbreti i Jordanisë Abdullah i II-të, gjatë takimit në Shtëpinë e Bardhë, shqyrtuan pretendimet për përdorimin e armëve kimike në Siri. Pas pretendimeve se në Siri janë përdorur armë kimike, Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Barak Obama, paralajmëroi udhëheqjen e Damaskut me një gjuhë të ashpër.

"Me përdorimin e armëve për shkatërrim në masë ndaj civilëve do të jetë shkelur edhe një vijë tjetër në kontekstin e rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare. Kjo gjendje ndryshon tërësisht rregullat e lojës", u shpreh Obama.

Duke e bërë të ditur se aktualisht kanë në dorë prova se në Siri janë përdorur armë kimike, Obama tha se këto janë vlerësime paraprake të

bazuara në punimet e shërbimeve informative amerikane.



Obama tha se kjo çështje është duke u hetuar fuqimisht edhe nga ana e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por edhe nga ana e Kombeve të Bashkuara dhe se do të përpigjen që këto hetime t'i mbarojnë sa më shpejt të jetë e mundur.

Presidenti Obama gjithashtu tha se gjatë këtij procesi do të veprojnë me maturi dhe se nuk do të lejojnë dhe nuk do të presin që mbi njerëzit të përdoren armë kimike.

Ndërkaq nga Siria vazhdojnë të vijnë lajmet e dhunës. Mes forcave të Esadit dhe atyre opozitare në qytetin Halep zhvillohen përleshje intensive. Bëhet e ditur se këto përleshje janë përqendruar në afërsi të një baze ushtarake.

LËKURË E NDJESHME PËR ROBOTËT

Ka shumë proteza robotike që përdoren sot nga njerëzit. Po lëkura që i mbulon ato? Një lloj rrjete e re me transistorë mund të mbulojë krahët e robotëve. Ajo është e butë, e ndjeshme ashtu si lëkura e njeriut dhe është e mbuluar në mijëra qime të vogla mekanike.

Zhvilluar nga Georgia Tech, kjo lloj lëkure për robotët, mbështetet në një lloj të veçantë transistorësh. Mijëra komponentë të vegjël janë të përhapur në të gjithë sipërfaqen e "lëkurës" dhe gjenerojnë energji elektrike sa


herë që preken apo ekspozohen.

Përfundimisht, materiali mund të vihet në përdorim në robotë, duke u dhënë atyre një ndjenjë kontakti, që është të paktën disi e ngjashme me atë që kemi ne ose mund të përdoret për të mbuluar proteza dhe të kthejë ndjesinë për ata që kanë humbur gjymtyrët.

Hapi i ardhshëm është ndërtimi i lëkurës, me përgjigje më të sakta dhe më të shpejta. Nuk do të duhet shumë kohë, derisa robotët të ndjejnë më mirë se njeriu.



BËRTHAMA E TOKËS, MË E NXEHTË SE Ç'KEMI MENDUAR



Një seri e re matjesh ka zbuluar se bërthama e Tokës është në fakt 1.000 °C më e nxehtë nga ç'kemi menduar deri më sot. Kjo do të thotë se në të vërtetë, qendra e planetit tonë është e nxehtë të paktën sa sipërfaqja e Diellit.

Dihet se bërthama e planetit tonë, pavarësisht të qenit jashtëzakonisht e nxehtë, është prej hekuri kristalor si rezultat i presioneve të mëdha. Por një numër i ri eksperimentesh sugjerojnë se struktura e kristalizuar, në të vërtetë formon temperatura shumë më të larta nga sa ishte parashikuar më parë.

Testimet në fillim të viteve '90 sugjeruan se temperatura e bërthamës duhet të jetë përafërsisht 5,000 °C. Por tani, një ekip shkencëtarësh kanë përdorur rrezet-X, për të shqyrtuar mostrat e hekurit, të ruajtura në temperaturë jashtëzakonisht të lartë, për të kuptuar më mirë se si formohet struktura unike e kristalizuar e bërthamës.

Rezultatet e tyre, të botuara në revistën Shkenca, sugjeron se temperatura e bërthamës së Tokës është 6,000 °C.

JAPONEZË PO SJELLIN NJË DIMENSION TJETËR NË TV

Në sajë të një zbulimi të ri të shkencëtarëve japonezë, tashmë në televizionin tuaj, jo vetëm do të shihni, por do të merrni edhe erë.

Njerëzit, asnjëherë nuk janë mjaftuar vetëm me shikimin në ekran. Në fillim, ekranet me prekje, pastaj ekranet me ndjeshmëri lëvizjeje dhe tani po vijnë ekranet me aromë. Më herët, teknologjia quajtur "Smell-o-Vision", shpërndante erën nëpër sallonet e kinemave, por tashmë në sajë të një teknologjie më të avancuar dhe më të ndërlikuar, era do të shpërndahet nga një pikë në përputhje me pozicionin e figurës në ekran. Pra, nëse në mes të ekranit gjendet një figurë ku piqet mishi, era do të përhapet prej mesit të ekranit, por nëse figura lëviz në ndonjë qoshe tjetër, atëherë edhe era do të fillojë të përhapet prej atje.

Sipas informacioneve që u dhanë

në "Konferencën e realitetit virtual", Teknologjia e ekraneve me aromë,



është një teknologji e re e cila garanton përhapjen nga zona të ndryshme të një ekranit 2D.

Le të shohim parimin bazë të kësaj teknologjie. Katër fana (ventilatorë) të vendosur me kujdes, përbëjnë themelin e kësaj teknologjie. Avulli i erës dërgohet përpara ekranit dhe këto fana e fryjnë avullin atje ku duhet. Fanat, të cilët gjatë këtij procesi lëvizin shumë ngadalë, garantojnë që përdoruesi të mos e ndjejë aspak lëvizjen e ajrit dhe në të njëjtën kohë të ndjejë se era është duke ardhur me të vërtetë prej një pike të caktuar të ekranit.

Tani për tani, teknologjia e një ekranit të tillë, është ende në fazën eksperimentale dhe ende nuk është bërë ndonjë prononcim për datën që do të lëshohet për përdorim të gjerë.